

Valbona Nathanaili, Martha Nussbaum, Steve Fuller

EDUKIMI LIBERAL

Si qasje dhe praktikë

Me parathënie nga Konstantinos Giakoumis



Valbona Nathanaili, Martha Nussbaum, Steve Fuller

Edukimi liberal

Si qasje dhe praktikë

Me parathënie nga Konstantinos Giakoumis

Tiranë, maj 2021

Fondacioni “Henrietta Leavitt”

Fondacioni Shqiptar për Shkencë, Media dhe Demokraci

Titulli i librit: Edukimi liberal *Si qasje dhe praktikë*

Autorë: Valbona NATHANAILI, Martha NUSSBAUM, Steve FULLER

Parathënia: Konstantinos GIAKOURIS

Redaktor: Andrea NATHANAILI

ISBN 978-9928-4543-6-2

www.fhl.org.al / www.valbonanathanaili.com

Libri është kataloguar në datën e publikimit pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë

Botues: Fondacioni “Henrietta Leavitt”

Fondacioni Shqiptar për Shkencë, Media dhe Demokraci

Seria e librit shkencor (shkenca pranë publikut)

Nr. 3

Copyright © Fondacioni “Henrietta Leavitt”

Pjesa e Martha Nussbaum:

“Translated and reprinted from NOT FOR PROFIT Updated Edition: Why Democracy Needs the Humanities by Martha C. Nussbaum. Copyright © 2010 by Princeton University Press. Reprinted by permission.”

Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga Ligji i Shtetit Shqiptar “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të”, nuk mund të riprodhohet, rubet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet ueb apo sisteme të tjerë, pa lejen me shkrim të botuesit.

Të ardhurat nga libri shkojnë në llogari të fondacionit dhe përdoren në përputhje me misionin e synimet.

Edukimi liberal

Si qasje dhe praktikë

PËRMBAJTJA

Parathënia f. 7

Arsimi liberal dhe liberalizmi arsimor /Konstantinos Giakoumis **f. 5**

Pjesa I Emergjencia për edukim liberal /Edukimi liberal si qasje f. 9

Valbona Nathanaili dhe Martha Nussbaum

Edukimi liberal - karakteristika dhe koncepte /Valbona Nathanaili **f. 11**

Kultivimi i imagjinatës: Letërsia dhe artet /Martha Nussbaum **f. 25**

Pjesa II Edukimi liberal dhe teatri /Edukimi liberal si praktikë f. 51

Valbona Nathanaili dhe Steve Fuller

Teatri dhe edukimi /Valbona Nathanaili **f. 53**

Linkoln dhe Darwin. *Në një bashkëbisedim, vetëm për një natë* /Steve Fuller **f. 57**

Rrëfenjat e disa portokalleve që mund të fluturojnë /Valbona Nathanaili **f. 107**

Shënime f. 119

Valbona Nathanaili dhe Martha Nussbaum

Arsimi liberal dhe liberalizmi arsimor

Prof. Asoc. Konstantinos Giakoumis/Kolegji Universitar “Logos”

Pas një pushimi gjysmë ore, në orën 14.45, në mbarë shkollën fillon “ora e përrallave”. Në “orën e përrallës” të gjithë, pa përjashtim - nxënës, mësues dhe stafi i shërbimit - lexojnë në heshtje diçka! Ora e përrallës është e konsoliduar dhe ka një traditë që shtrihet në kohë. Është mundësia më e mirë për t’u qetësuar! Dhe argëtuar ndryshe! Fëmijë, përgjithësisht, zgjedhin të lexojnë librin e preferuar në vendin e preferuar! Çdo “qoshe” e klasës është në dispozicion të tyre. Një vizitor i pamësuar habitet me pamjen: katër-pesë fëmijë kanë zgjedhur të lexojnë në këndin e leximit, të tjerë janë shtrirë poshtë tavolinës apo u janë drejtuar karrigeve ku ulen zakonisht, por me këmbë të ngritura vertikalisht, mbështetur pas murit. Shkolla është kaq e qetë, sa me të drejtë mund të pyesësh nëse ka diçka që nuk shkon. Nuk mbetet prapa stafi! Sot qyteti ka qenë me zhvillime interesante dhe të gjithë, sekretarja dhe drejtori, personeli i shërbimit dhe mësuesit kanë marrë gazetën e ditës, në kërkim të lajmit që u intereson.

Ora 15.15! Fëmijët mbyllin librat me përralla, por jo argëtimin nga përrallat. Nga ora 15.15-15.30 përrallat tregohen! Edhe kjo pjesë është po kaq interesante. Në këtë çerek ore që mbetet, mësuesi lexon ndonjë tregim nga libra të mira dhe të ilustruar, ndërsa një mësues tjetër shëputet me një apo dy nxënës në një vend të qetë dhe i dëgjon duke lexuar një tjetër përrallë. Një herë në javë, në klasë ftohet një nga mamatë e fëmijëve. Pak rëndësi ka nëse është angleze apo jo! I vetmi kusht është që duhet të tregojë një përrallë nga vendi i saj. Fëmijët kënaqen dhe duan të dëgjojnë sa më shumë. Ky çerek ore klasifikohet në kurrikulat e respektit dhe barazisë që duhet të gëzojnë të gjithë njerëzit, pavarësisht racës apo ngjyrës, prejardhjes apo klasës ekonomike.

Në shkollat angleze studiojnë nxënës me përkatësi të ndryshme etnike! Fëmijët duhet të respektojnë kulturën e njëri-tjetrit, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të jetojnë në paqe e harmoni.

Ky çerek ore i rrëmben fëmijët... në magjinë e përrallave nga mbarë bota.*

Tregimi i mësipërm i përket marsit të vitit 1994. Në atë kohë kam qenë student me programet ERASMUS në “Shkollën Pedagogjike” të Universitetit të Leeds-it, në Clayton West. Ishin vitet e fundit, kur sistemi i arsimit fillor në Angli kishte ende fleksibilitetin që prindërit, së bashku me administratën e zgjedhur prej tyre nëpër shkolla, mund të përcaktojnë kurrikulat dhe orarin mësimor të nxënësve, si dhe të ftojnë njerëz të jashtëm sipas dëshirës, pa frikën e goditjeve terroriste.

Në shkollën fillore të fshatit Clayton West, afër Leeds, mund të pohoj se ka qenë kontakti im i parë, por i paharruar, me arsimin liberal dhe liberalizmin arsimor. Edhe pse një vlerësim i këtij liberalizmi në arsim del, sigurisht, përtej kufijve të një parathënie, gëzimi i fëmijëve prej rrëmbimit në botën e përrallave haset shumë rrallë sot, kur kurrikulat udhëhiqen nga ‘kërkesat e tregut’, duke sakrifikuar shumë nga lëndët humane që parashikoheshin më përpara në shkollë, siç vëren Valbona Nathanaili në kreun e parë të këtij libri. Synimi i kësaj parathënieje është, që duke reflektuar mbi konceptin dhe përmbajtjen e arsimit liberal dhe liberalizmit në arsim, të piketojë disa nga mësimet që mund të nxjerrim, si edhe vlerat e librit në këtë drejtim.

Qasja liberale në arsim buron nga bindja te vlera e lirisë individuale si vlerë madhore, e cila duhet të shërbejë si bazë për gjithë politikat arsimore. Qasja liberale e ka prejardhjen te humanizmi, pra te lëvizja që vë individualitetin e njeriut mbi kolektivizimin e komunitarizmit. Siç tregohet nga tregimi i mëparshëm, nga çfarë vijon, si edhe nga gjithë libri, këto dy qasje nuk janë të kundërta. Koncepti i termit ‘arsim liberal’ ka historinë e vetë, siç tregohet në kapitullin e parë të këtij libri; megjithatë, termi u trajtua në mënyrë sistematike për herë të parë nga Milton Friedman në një ese

*Giakoumis, Konstantinos & Lekati, Eleni. "Το «Ενεργόν» Σχολείο στην Πράξη. Μία Τυπική Σχολική Ημέρα στο Αγγλικό Δημοτικό Σχολείο." *Ελληνοχριστιανική Αγωγή* 48/424 (tetor 1995), ff. 242-9.

“mbi rolin e qeverisë në arsim”.* Friedman mbështet një minimum arsimimi për të gjithë, si element stabilizues të demokracisë, por ndërhyrjen e qeverisë në drejtimin e institucioneve arsimore e përfytyron vetëm aty ku tregu e ka të pamundur të mobilizohet. Friedman mbështet një sistem kuponësh në favor të nxënësve, në vend të financimit të drejtpërdrejtë të shkollave dhe nuk është në favor të subvencionit të arsimit profesional dhe të lartë.

Ndikimi i Friedman në zhvillimin e qasjes liberale në politikat arsimore është vendimtar. Friedman flet për ndërhyrje të qeverisë dhe jo për intervencionizëm shtetëror dhe beson, se “rezultatet e fqinjësisë” janë të rëndësishme, sepse sigurojnë lirinë e zgjedhjes, përforcimin e konkurrencës dhe reduktimin e shpenzimeve administrative. Qasja liberale argumenton se sundimi i elementit politik në arsim dhe ushtrimi i presioneve nga interesa të ndryshme e çojnë arsimin drejt burokratizimit dhe joefektshmërisë në përmbushjen e kërkesave të prindërve. Politika të tilla shtetërore – vazhdon Friedman - kanë kosto të lartë dhe karakter rishpërndarës, elemente jo të pranueshme nga teoria liberale politike. Sipas tij, politika liberale e propozuar asgjëson shkaqet e pabarazisë dhe krijon shanse të vërteta dhe të barabarta.

Një element tjetër i rëndësishëm është llogaridhënia. Kritika liberale, në bindjen e saj në fuqinë e familjes si qelizë e gjallë e shoqërisë, sugjeron se ç’burokratizimi i sistemeve arsimore të kohës mund të kalohet nga fuqizimi i prindërve për të kërkuar llogari nga shkollat. Që nga koha e Friedman-it, eksperimente liberale në sistemet arsimore nëpër botë kanë prodhuar rezultate si pozitive, ashtu edhe negative, duke detyruar kritikën liberale të krijojë variabël të tjerë për suksesin e sistemit liberal.

Megjithatë, liria e prindërve në pjesën më të madh të botës, që të përzgjedhin llojin e arsimit në të cilin fëmijët e tyre mund të ekspozohen është fryt i propozimeve liberale në qeverisjen e arsimit. Mirëpo, arsimi liberal dhe liberalizmi arsimor nuk kufizohen vetëm në sisteme arsimore, por shtrihen edhe në përmbajtjen e kurrikulave. Rolin e kurrikulave në kultivimin e individualitetit të nxënësve brenda një kornize të shëndoshë shoqërore, ku individualiteti i njërit nuk cenon individualitetin e tjetrit, e aludon tregimi në fillimi të kësaj parathënieje. Pikërisht këtë rol, me

* Friedman, M. 1955. "The Role of Government in Education" Në *Economics and the Public Interest*, redaktuar nga Robert A. Solo, 123-44. New Jersey: Rutgers College.

shembuj konkretë, synon që të tregojë edhe ky libër. Kam bindjen se kontributi i tij nuk do të kufizohet vetëm në pajisjen e mësuesve me disa aktivitete konkrete mësimore të arsimit liberal, por njëkohësisht do të shtrihet edhe në debatin mbi vlerat e arsimit liberal dhe liberalizmit arsimor në Shqipërinë paskomuniste dhe më tej.

Pjesa I

Emergjenca për edukim liberal / Edukimi liberal si qasje

Valbona Nathanaili dhe Martha Nussbaum

Edukimi liberal si filozofi

Valbona Nathanaili

Vizioni ynë është që një shkollim i mirë duhet të ndikojë pozitivisht në modernizimin dhe zhvillimin e shoqërisë, në reduktimin e papunësisë, në rritjen e të ardhurave personale të individit, në zgjerimin e lirive reale që gëzojnë njerëzit, në krijimin e një bote më të sigurt, më të shëndetshme e më të begatë. Mundësitë dhe perspektivat tona varen, përfundimisht, nga institucionet që kemi dhe nga mënyra si funksionojnë (*Sen, 2011*).

Shoqëria jonë mund të cilësohet si kuazi-demokratike – flasim për tolerancë, por përballemi më shumë me arrogancë, flasim për bashkim, por hierarkia dhe ndarja sociale janë institucionalizuar, bëjmë zgjedhje demokratike, por udhëheqësit nuk ndryshojnë. Diferencat vazhdojnë të jenë arsye për përjashtim. Raca, gjinia dhe diferencat kulturore e etnike po prodhojnë gjithnjë e më shumë dhunë dhe konflikt. Pandemia Covid-19 më shumë se globalizmin, theksoi aspektin tonë lokal. Arsyeja është e thjeshtë: asnjë shoqëri nuk mund të transmetojë aftësitë dhe informacionin nga njëri brez në tjetrin, pa transmetuar, në të njëjtën kohë, për mirë apo për keq, edhe besimet dhe paragjykimet e saj. Thënë ndryshe, si dhe duke përdorur një term disi abuzues, “ideologjitë” (Gless dhe Smith, 1992, f. 10). Në përpjekjet për të pasur një mjedis sa më të shëndetshëm për edukimin e fëmijëve, shkolla luan një rol të rëndësishëm.

Shkollat duhet të sigurojnë mësimin dhe edukimin me parimet e demokracisë. Për këtë, shkollat duhet të kultivojnë aftësi të ndryshme, si të menduarin kritik dhe aftësinë për të punuar në grup. Por si mund të sigurohemi se fëmijët po marrin edukimin e duhur në shkollë? Për shkak të kompleksitetit të shkollimit, debati është shumë i gjerë. Sa i takon mënyrës së shkollimit, për Lindeman (1926, f. 153), përgjigja më e saktë është e trefishtë: a) duke vendosur për natyrën e procesit b) duke i transformuar interesat konfliktuale të grupeve të ndryshme në mënyrë sa më kreative c) duke zhvilluar metoda që arrijnë t'i bëjnë fëmijët të funksionojnë nga

pikëpamja sociale, ndryshe që janë në gjendje të shndërrojnë përvojat jetësore në shkollore.

Sa i takon synimeve, shkolla si institucion duhet të tregojë të njëjtin kujdes për të gjithë fëmijët, pavarësisht faktorëve të ndryshëm, objektivë a subjektivë qofshin, sepse “qasja për një zhvillim human është qasja më e mirë që mund të na ofrohet”.* Për Brighouse (2009), “Perspektiva individuale e arritjeve të një fëmijë duhet të jetë funksion vetëm i përpjekjeve të individit dhe jo e talentit natyror, klasës apo grupit social ku bën pjesë”.

Por politikat shkollore janë ekskluzivitet i shtetit, veçanërisht kur bëhet fjalë për sistemin para-universitar. Politika është politike: është pushteti për të përcaktuar se çfarë do të bëhet! Politikat shtetërore, në shkallë kombëtare apo lokale ndikojnë në formësimin e asaj çfarë ndodh në shkolla, që do të thotë edhe në përvojat e atyre që studiojnë në këto institucione. Shkollimi formal organizohet dhe kontrollohet nga shteti dhe është ai që rregullon politikat e dijes zyrtare. Shumë studiues, si (Bell & Stivenson, 2006; Bourdieu, 1996; Bourdieu and Wacquant, 1992; Ritzer, 2011) e shohin shtetin si vendin e luftërave për të fituar monopolin e dhunës simbolike, ky i fundit një term i përkufizuar nga Bourdieu. Për Bourdieu, dhuna simbolike shfaqet në dy forma: “e butë” dhe “indirekte”: “Sistemi arsimor është institucioni kryesor ku dhuna simbolike ushtrohet mbi njerëzit”.

Faktorët janë të shumtë, por është e rëndësishme të theksojmë se shkolla është gjithnjë në trysinë për të përshtatur kurrikulën me nevojat e tregut. Jetojmë në një botë që udhëhiqet nga motivi i fitimit. Kërkesat e tregut kërkojnë që fokusi të jenë shkencat dhe aftësitë teknike. Rezultati është një kurrikulë e fragmentuar, që i nxit studentët të marrin ato kurse e të studiojnë në ato degë që sigurojnë punësim të menjëhershëm. Rreth njëqind vjet më parë, Lindeman[†] deklaroi se “Problemet më të rëndësishme me të cilat i duhet të përballet bota janë, në karakter, teknike, jo politike”.

Brezi i sotëm shqetësimin më të madh ka sigurinë financiare dhe karrierën, sikundër rrit gjithnjë e më shumë dozat e ambicies personale (Friedman, 2003). Apeli është për edukim liberal!

* Sen (1999).

† 1926, f. 120.

Një filozofi edukimi, në gjendje të na ndihmojë për të hartuar politikat e duhura arsimore, duhet të shtjellohet dhe të japë përgjigje në pesë dimensione:

- *Synime* (cilët synime janë më të përshtatshmit, si dhe idealet që duhet t'i udhëheqin; për shembull: Të synojmë nxitjen e të menduarit kritik, për të edukuar qytetarë, të aftë të mendojnë me mendjen e tyre, apo indoktrinim, për të edukuar bindje dhe ushqyer besim të verbër?);
- *Autoritet* (kush e ka autoritetin për të edukuar, përfshirë autoritetin e shtetit dhe të mësuesve, të drejtat e nxënësve dhe të prindërve);
- *Përgjegjësi* (kush është përgjegjës për të siguruar një shkollim të përshtatshëm dhe të barabartë);
- *Në çfarë mënyrash do edukojmë* (pedagogjia e mësimdhënies dhe nxënies);
- *Përmbytje* (kurrikula, ose pesha që duhet të zënë disiplina të ndryshme në të tërën).

Apeli është që edukimi liberal të konceptohet si një filozofi.

Edukimi liberal e ka zanafillën në Greqinë e lashtë, ndonëse parimet e kriteret e tij gjenden edhe në rajone të tjera të botës, por me emër tjetër. Duke qëndruar në Europë, edukimi liberal ka qenë një filozofi e përhapur deri në shekujt e tetëmbëdhjetë dhe të nëntëmbëdhjetë. Më pas, në përgjigje të kërkesave në rritje të Revolucionit Industrial, vendin e kësaj filozofie e zë një tjetër, që i kushton rëndësi të veçantë nevojave të tregut, duke pasur si synim aftësitë dhe vendin e punës, dhe duke e vënë theksin vetëm te shkencat e sakta dhe teknologjia.

Dija, intelijenca, të folurit në publik, të qenit qytetar dhe të vepruarit me etikë, po zënë gjithnjë e më pak vend në synimet e shkollës. Shqetësimi është që në kohën e mediave sociale dhe të '*fake news*', të populizmit në rritje dhe të komercializimit, të nevojës për të mbaruar sa më shpejt shkollën - dhe me sa më pak shpenzime - për të hyrë në tregun e punës, sistemi arsimor ka filluar të humbasë gjithnjë e më shumë integritetin e tij si institucion.

Edukimi liberal dhe synimet e tij

Së pari është e rëndësishme të theksojmë se edukimi liberal nuk ka asgjë të përbashkët me idetë neo-liberale për komercializimin e shkollimit. Përkundrazi!

Edukimi liberal, që e vë theksin pikërisht në shkenca humane dhe në arte, ka filluar të marrë përsëri vëmendje të konsiderueshme vitet e fundit. Një nga aspektet më të rëndësishme të këtij edukimi është kontributi i tij në ndërtimin e një demokracie të shëndetshme.

Edukimi liberal fuqizon kapacitetin e fëmijëve për t'u përballur me botën, duke u zgjeruar horizontin, duke u pasuruar intelektin dhe plotësuar shpirtërisht. Një lloj edukimi i tillë kërkon që fëmijët të pranojnë më shumë përgjegjësi për veprimet që kryejnë, po aq edhe përgjegjshmëri për të mirën e të tjerëve. Nussbaum (2009), kur adreson idetë e saj për nevojën e përfshirjes së parimeve të edukimit liberal në programet dhe kurrikulat e shkollës, frymëzohet nga dy studiues dhe filozofë: Rabindranath Tagore dhe John Dewey. Si Tagore, ashtu edhe Dewey, karakterizohen nga një indinjatë e thellë ndaj shkollimit konvencional, sepse nuk ka aftësinë të frymëzojë dhe kultivojë një karakteristikë të rëndësishme të fëmijët, empatinë; sepse stimulon kritikizmin; sepse ushqehet nga rregullat e rrepta të një pedagogjie imponuese.

Edukimi liberal e vë theksin në mësimin e arteve dhe shkencave humane në të gjitha nivelet e shkollimit, si dhe në përfshirjen e sa më shumë aktiviteteve jashtëshkollore në jetën e përditshme shkollore. Për Roth (2014), edukimi liberal është krijimi i zakoneve për veprim që frymëzohen nga një shpirt hulumtues. Edukimi liberal na mundëson të zbulojmë më mirë mungesat që kemi si qenie njerëzore, sikundër na inkurajon të përfshihemi sa më shumë në krijimin e një bote më të mirë. Në këtë mënyrë, fëmijët i kuptojnë më mirë lidhjet me të tjerët dhe vlerësojnë veprat që ka kryer njerëzimi në arte dhe shkencë, në muzikë dhe fe, sikundër gjykojnë edhe për vetë konceptin e të mësuarit.

Edukimi liberal është një qasje që e fuqizon individin dhe e përgatit të përballet me një botë komplekse, të ndryshme dhe në ndryshim. Edukimi liberal u siguron fëmijëve jo vetëm dije nga aspekte më të shumta të botës, por i ofron këto dije më në thellësi; i ndihmon të zhvillojnë një ndjenjë sociale përgjegjësie; të shkathtësohen në aftësi të tilla, si komunikimi dhe

zgjidhja e problemeve. Edukimi liberal na çliron nga prangat e injorancës, sektarizmit dhe miopisë. Në edukimin liberal kurioziteti shndërrohet në faktor dhe bëhet mundësi për zgjerimin e kufijve të dijes njerëzore. Nga natyra, edukimi liberal është global dhe pluralist; është materializimi i ideve dhe përvojave që karakterizojnë botën nga pikëpamja sociale, natyrale dhe intelektuale. Edukimi liberal është investimi më i mirë që shoqëria mund të bëjë për të ardhmen tonë të përbashkët.

Sipas Nussbaum (2009, f. 55-59), edukimi liberal na ndihmon të kultivojmë "tri aftësi kryesore, jashtëzakonisht të rëndësishme për formimin e qytetarëve, pjesë e një shoqërie demokratike dhe pluraliste, në një botë gjithnjë në lëvizje":

1. Aftësinë për të menduar në mënyrë kritike (*shih Nussbaum, në vijim*).
2. Aftësinë për të transhenduar frymën lokale dhe për t'i trajtuar problemet botërore si "qytetar i botës".
3. Aftësinë për të parë me simpati gjendjen e vështirë të një personi tjetër.

Akoma, Nussbaum thekson që këto vlera është e rëndësishme të kultivohen në mënyrën e duhur që në fillimet e shkollimit të fëmijëve.

Aftësia për të menduar në mënyrë kritike

Të menduarit kritik është thelbësor në lëmin e funksionimit të sistemit demokratik. Një shoqëri demokratike duhet të përpiqet të tejkalojë barrierat tradicionale të racës, grupit, klasës dhe pasurisë. Demokracia duhet të merret si me ligjet e maxhorancës, ashtu edhe me të drejtat e minoriteteve, edhe pse shpesh gjykohet krejtësisht vetëm në termat e votimeve. Në një kuptim më të gjerë, demokracia duhet të shihet si arsyetim publik që shkon përtej së drejtës së votës dhe mekanizmit të saj, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të krijojë hapësirën e duhur për grupet e vegjël dhe të drejtat e tyre. Pakica nuk mund të sakrifikohet për shumicën.

Një maxhorancë e pamëshirshme, të cilën nuk e bren ndërgjegjja për eliminimin e të drejtave të minoriteteve, ka tendencën ta ballafaqojë shoqërinë me zgjedhje të vështira.

Shumë çështje që lidhen me politikat janë të vështira për t'u kuptuar nga qytetarë të ndryshëm pikërisht sepse, jo vetëm që iu mungojnë dijet sesi funksionojnë institucionet, por edhe dijet për efektet anësore që shkaktojnë reformat e ndërmarra në institucione të tjera. Shkollat janë vendet natyrore për një edukim të tillë.*

“Të menduarit e shëndetshëm është një parakusht për të qenë qytetar i mirë, sepse të ndihmon të formosh një gjykim më intelektual për çështje të ndryshme, po aq sa edhe për gjetur zgjidhje demokratike për probleme sociale... për të dalluar gënjeshtërën nga e vërteta”†, ndërsa Sen thekson se ky lloj të menduari na ndihmon të “vëmë në diskutim paragjykime të betonizuara, interesa të kolateralizuara dhe tradita të padiskutuara (2009, f. 396). Për Brighouse, të menduarit kritik është një qasje e mirë “për të kuptuar se si funksionojnë institucionet dhe na aftëson të ushtrojmë trysni sociale, në synimin për të pasur një jetë më të mirë dhe dëshirën për të pasur siguri do e ruajmë atë” (2009).

Duhet thënë se pritshmëritë tona, që një edukim i tillë të bëhet nga institucionet e shoqërisë civile, tentojnë drejt zeros nëse bazat e këtij edukimi nuk janë marrë që në shkollë. Nga ana tjetër, për të qenë qytetarë efektivë në një shoqëri demokratike, është shndërruar në imperativ të ushqejmë te fëmijët pavarësinë e mendjes dhe t'i inkurajojmë të bëjnë pyetje. Shkolla duhet t'i aftësojë ata që të gjejnë e të sjellin argumente, nëpërmjet të cilave, duke arsyetuar, të arrijnë në besime racionale për çështjen në fjalë. Nuk është e mundur të synojmë të edukojmë, në të njëjtën kohë, edhe qytetarë që i binden shtetit në mënyrë të pakushtëzuar, edhe qytetarë të emancipuar, të aftë të vënë në 'kandar' çdo çështje me të cilën do të kenë të bëjnë.

Nussbaum, kur analizon lidhjen ndërmjet të menduarit kritik dhe demokracisë referon kryesisht John Dewey, një nga studiuesit që frymëzoi lëvizjen progresive në sistemin arsimor të SHBA. Sipas Nussbaum-it, në shumicën e shkollave ne kërkojmë të imponohemi me dije e informacion, shpesh në mënyrë vertikale e hierarkike, nga mësuesi te nxënësi. Një karakteristikë tjetër, që ndiqet në orën e mësimit, është kërkesa për memorizimin e fakteve, teorive e informacioneve të ndryshme, veçanërisht

* Sigel, H., 2009. *The Oxford handbook of philosophy of education*. Oxford University Press, f. 40

† Phillips (1997, f. 264)

në shkencat politike, histori e gjeografi. Pa nënvlerësuar rolin që ka ky lloj të mësuarit është e rëndësishme të theksojmë, se edukimi fillon me mendjen e fëmijës. Synimi ynë duhet të jetë rritja e lirisë së mendimit në përputhje me mjedisin social, pjesë e të cilit është. Artet dhe letërsia janë mënyra shumë të mira për të stimuluar kritikën ndaj atyre zakoneve e traditave që na mbajnë larg ndryshimit, që frenojnë iniciativën për të ecur përpara. Këto përpjekje duhet të fillojnë në moshë sa më të njomë. Shumë e rëndësishme në këtë drejtim është veçanërisht edukimi i femrës.

Edhe artet dhe shkencat humane ose, në përgjithësi, shkencat sociale, janë në gjendje të inkurajojnë të menduarin kritik të fëmijët, njësoj si shkencat e sakta. Autorë të ndryshëm nxjerrin në pah shumëllojshmërinë e ndikimit që kanë këto shkenca në të menduarin kritik. Sipas Lindeman, “Arti është një formë e rëndësishme për çlirimin e mendjes. Përmbajtja e tij vërtet ka lidhje me ndjenjat, por rezultati është pasurimi intelektual i personalitetit njerëzor” (1926, f. 108).

Aftësia për të transhenduar frymën lokale dhe për t’i trajtuar problemet botërore si “qytetar i botës”

Ne duhet t’i edukojmë të rinjtë ta shohin veten e tyre si anëtarë të një kombi dhe të një bote heterogjene, të kuptojnë historinë dhe grupet e ndryshme që jetojnë në të.

Sot, për shkak të natyrës së ndërvarësisë që ka globalizmi, si dhe faktit që shumë nga ndërveprimet tona si qytetarë globalë ndërmjetësohen nga norma të diktuar nga një treg shkëmbimi, më shumë se kurrë kemi nevojë për këtë aftësi. Sipas Martha Nussbaum-it* nxënësit duhet të mësojnë ngjarjet kryesore të historisë botërore pasi i pasurojnë akoma më shumë, i ndihmojnë të kenë një të kuptuar që shkon përtej stereotipave të së përditshmes, veçanërisht sa i takon besimeve kryesore. Ata duhet të studiojnë me thellësi të paktën një traditë jo-familjare, sepse aftësohen të fitojnë shprehje që u hyjnë në punë më vonë. Shkëmbimi i programeve të studimit me shkolla të vendeve të tjera, veçanërisht kur u përkasin kulturave krejtësisht të ndryshme, është një ide e mirë pasi të ndihmon ta shohësh botën nga një këndvështrim tjetër, ta pranosh e ta përpunosh dijen e re në një frymë më empatike.

* Siegel H., 2009. *The Oxford Handbook of Philosophy of Education*: Oxford University Press, f. 57.

Në nivel lokal, në shkollë, nxënës e studentë duhet të njohin e të studiojnë traditat kryesore të grupeve që janë pjesë e kombit të tyre, në maxhorancë a minorancë qofshin, të analizojnë sesi diferenca në fe, racë e gjini janë bërë gjithmonë burim për diferenca në mundësi për të jetuar. Një problem i përhershëm mbetet ai i dallimeve gjinore, manifestuar në kurrikula dhe tekste, me role të tilla ku vajzat bëjnë punët e shtëpisë dhe ëndërrojnë të krijojnë familje dhe të mobilojnë shtëpinë, ndërkohë që djemtë vazhdojnë universitetet dhe përgatiten për të marrë role drejtuese. Identitete të tilla kombëtare shpeshherë as nuk kalohen në filtrat e gjykimit të mësuesve dhe të hartuesve të teksteve e të kurrikulave, sepse konsiderohen si aksioma. Pra shkollat shpesh ndihmojnë në fiksimin e roleve sociale dhe bashkë me të, edhe në pritshmëritë dhe ambiciet për jetën. Në të kundërt, shkollat duhet të ndihmojnë në zgjedhjen dhe krijimin e identiteteve, gjë që sigurisht nuk është as e lehtë dhe as e thjeshtë.

Në periudha të ndryshme të jetës ne mund të zbulojmë aspekte të identitetit tonë ose të të tjerëve për të cilat nuk ishim më parë të ndërgjegjshëm. Këto identitete të reja mund të pranohen me pak ndërgjegjësim dhe pse vetë procesi i të kuptuarit të origjinës dhe domethënies së tyre mund të mos të jetë i vështirë... Kjo kërkon që kurrikula t'u mundësojë të studiojnë vendndodhjen e tyre në kohë e në hapësirë, si dhe të zhvillojë ndjenjën e “vetes” si pjesëmarrës në jetë me një mënyrë demokratike, e cila përfshin të kuptuarit dhe respektin për identitetin e tjetrit. Zhvillimi i ndjenjës së “vetes” mund të minohet nga promovimi i identitetit kombëtar në shkollë. Nëse iluzioni i kombit ... fsheh efektin e përjashtimit të disave nga pjesëmarrja me të drejta të plota si qytetar të një shoqërie demokratike, atëherë identitetit kombëtar duhet t'ia mohojmë vendin që ka në edukim.

Në ilustrim të kësaj ideje është dukuria e tmerrshme e vdekshmërisë së lartë femërore, e lidhur me abortin selektiv kundrejt fetuseve dhe bebeve femra në shumë pjesë të botës, që për Amartya Sen-in (2011, Tiranë) është një aspekt vulgar dhe i mprehtë i pabarazisë gjinore. Akoma, grupet në klasa dhe në shkolla formohen kryesisht sipas përkatësive etnike ose identiteteve përkatëse. Na duhet të edukojmë nxënës që njohin jetën e njerëzve të tjerë të ndryshëm nga ata, që janë në gjendje të dialogojnë me interes dhe dashuri për të ardhmen e njerëzimit. Në shkolla duhet të zhvillohen procese edukimi në përgjigje të ndikimeve që ushtrojnë familja, institucionet fetare, tradita, kultura, media dhe reklama të ndryshme.

Aftësia për të parë me simpati gjendjen e vështirë të një personi tjetër

Një aftësi e tillë do të thotë të jesh në gjendje ta vendosësh veten në vend të tjetrit, të dëgjosh me vëmendje e të lexosh me inteligjencë historinë e tij, të kuptosh emocionet e dëshirat që ka ose që ëndërron. Kultivimin e simpatisë e gjejmë edhe në tragjeditë e grekëve të lashtë, që do të thotë se edhe në demokracinë e asaj kohe nxitej kjo aftësi. Artet janë një mënyrë e mirë për të perceptuar në mënyrë inteligjente dhe për të përjetuar përvoja të pakrahasueshme. Ato luajnë një rol vendimtar në formimin qytetar. Konkretisht, teatri e transmeton dijen duke anashkaluar lidhjen asimetrike të pushtetit që strukturon marrëdhënien mësues-nxënës.

Mësimi i arteve dhe i letërsisë mund të kontribuojë në shumë mënyra në kultivimin e simpatisë. Sipas Nussbaum-it, në të gjitha shoqëritë dhe në të gjitha kohërat kanë ekzistuar gjithmonë grupe të lëna mënjanë, të stigmatizuara ose në pozita inferiore ndaj të tjerëve. Një ndihmesë në këtë drejtim jep edhe sfondi social ose paragjykimet që kemi, të cilat me ose pa dashje ndikojnë mënyrën tonë të të arsyetuarit rreth përkatësisë në grup, pavarësisht nëse jetojmë në qytet a në fshat, jemi të rinj a të vjetër. Gjykimi ynë për një grup të caktuar influencohet shumë nga faktorët e mësipërm. Ajo që perceptojmë varet nga pozicioni ku jemi dhe nga ajo që shpresojmë ose jemi të bindur se do të shohim. Kështu sa i takon edhe grupit rom, identifikuar gjithmonë si një grup që nuk pëlqen edukimin dhe rregullat, i paqëndrueshëm dhe me vese të shumta.

Në varietenë humoristike "Portokalli", aktori Florian Binaj, që luan rolin e Skrapit, përpiqet të evitojë këtë kulturë të përgjithshme negative që shoqërizon aftësinë për të ditur e për të komunikuar të këtij komuniteti. Duke na vënë në lëvizje imagjinatën, përmes lojës së tij, Binaj na mundëson të njohim përvojat aspak të këndshme të grupit rom, të cilat në jetën e përditshme ose i anashkalojmë, ose i marrim si të mirëqena. Personazhi i Skrapit është i ditur dhe i mençur, i komunikueshëm dhe i gatshëm të ndihmojë e të mbajë familjen e tij.

Pra, arti vë në lëvizje të menduarin ndryshe, nga këndvështrime të tjera, na ndihmon të kuptojmë sa e vështirë dhe diskriminuese është jeta e personave që u përkasin këtyre grupeve. Dhe të reflektojmë!

Artet janë një mënyrë shumë e mirë për të nxitur edhe lirinë dhe ndjenjën e komunitetit. Kur njerëzit luajnë së bashku, ata mësojnë të

shkojnë përtej traditës dhe autoritetit, mësojnë të shprehen më mirë dhe të shoqërizohen me njëri-tjetrin. Lloji i komunitetit që krijohet gjatë aktiviteteve të tilla nuk është hierarkik, vertikal, por horizontal, një karakteristikë që e bën komunikimin të barabartë, e shndërron tolerancën në vlerë, e bën demokracinë të mirë dhe gjen vend në proceset politike që e shoqërizojnë atë.

Së fundmi, artet janë një burim i mirë gëzimi jo vetëm për fëmijët, por edhe për të rriturit. Pjesëmarrja në lojë, këngë e vallëzim i mbush fëmijët me gëzim dhe këtë gëzim ata e pasqyrojnë edhe në pjesën tjetër të ditës shkollore. Fëmijëve nuk u pëlqen të qëndrojnë ulur gjithë ditën. Nga ana tjetër, shprehja nëpërmjet këtyre aktiviteteve kreative i jep hapësirë dëshirës së tyre për të qenë të lirë. Arti është po aq i rëndësishëm edhe për spektatorin, sepse gjeneron kënaqësi, i bën spektatorët të përjetojnë akte subversioni ose kritika kulturore pa frikë dhe pa masa vetëmbrojtëse, edhe kur dialogët që zhvillohen janë të mbushur me paragjykime të së shkuarës. Kujtoni komedinë “Diktatori” (2012) dhe batutën e Sacha Baron Cohen (njëri nga skenaristët dhe aktori kryesor), kur e dashura i thotë jam shtatzënë, ai përgjigjet: Çfarë do lindësh, djalë apo do të abortosh?

Zbavitja nëpërmjet artit ofron shpresë e perceptime më të mira për jetën. Detyra e arsimit është të mbajë gjallë këtë kuriozitet, në respekt të lirisë e të individualitetit të fëmijëve. Sigurisht, për demokracinë nuk është e rëndësishme vetëm argëtimi, por mënyra sesi performanca ofron një hapësirë për eksplorimin e çështjeve të vështira pa u zhytur në ankth dhe është një vlerë e shtuar e këtij aktiviteti.

Vështirësi

Edukimi për të qenë qytetar i mirë - dhe këtu kuptoj qytetar i përgjegjshëm - në përgjithësi, në shumë shkolla, kolegje e universitete lë shumë për të dëshiruar. Vështirësia kryesore qëndron në faktin se edukimi liberal kërkon para dhe përkrahjen e njerëzve që i kanë ato, pasi ka kosto të lartë financiare dhe pedagogjike. Një lloj mësimi i tillë kërkon klasa të vogla, ku nxënës e mësues, gjatë gjithë kohës, japin e marrin mendime dhe bëjnë vlerësime; kërkon investime në infrastrukturë, si dhe kohë për të përgatitur mësuesit dhe profesionistët për lëndë që janë jashtë strukturës konvencionale të përgatitjes shkollore.

Nga ana tjetër, kërkesat e tregut global kërkojnë nga të gjithë të fokusohen në aftësi teknike e shkencore, si aftësi kryesore, ndërkohë që aftësitë e tjera, ato që merren në shkenca humane e arte po trajtohen gjithmonë e më shumë si të padobishme dhe gjykohen që nuk ndihmojnë kombin të jetë konkurrues në tregun global. Edhe ato vende, që i kanë në fokus lëndë të tilla, përsëri i kanë standardizuar aq shumë, sa që aftësitë për të imagjinuar dhe menduar në mënyrë kritike, që gjenden në thelb të tyre, janë minimizuar jashtëzakonisht. Gjetja e balancës së duhur në kurrikulën shkollore, ndërmjet peshës që duhet të zënë, nga njëra anë, matematika dhe shkencat e sakta, si parakusht për shoqërinë e teknologjisë dhe, nga ana tjetër, shkencat humane, si parakusht për shoqërinë pluraliste dhe përgatitjen e qytetarëve të të gjithë botës, vazhdojnë të jenë në qendër të debatit. Këtij debati nuk i kanë shpëtuar edhe partizanët e edukimit liberal. Përcaktimi se çfarë dhe sa duhet mësuar vazhdon të jetë shqetësim.

Një vështirësi tjetër është që kjo lloj reforme arsimore kërkon ndryshime në dy dimensione: në thelb dhe në përmasë. Elmore (2007, f. 8), kur analizon sistemin arsimor në SHBA, arsyeton se reforma të kësaj natyre vështirë se depërtojnë në fraksione të vogla si shkolla dhe klasa dhe, për më tepër, nuk zgjasin më shumë se mandati i qeverisë që e ka iniciuar. Argumenti është se shpesh na mungon aftësia ta klonojmë suksesin nga një shkollë në tjetrën, ndërsa kur shkollat gjenden në komunitete të varfra apo larg hartës së zhvillimit, shanset ulen në mënyrë eksponenciale.

Edhe universitetet, në përgjithësi, veçanërisht në Europë, nuk janë të gatshme t'i zgjerojnë kurrikulat e tyre me disiplina të reja, në gjendje të luajnë një rol të rëndësishëm për një edukim të mirë qytetar si, për shembull, studime për gruan, fenë, islamizmin ose judaizmin. Për fat të keq, edhe kur këto disiplina bëhen pjesë e kurrikulës u ofrohen, kryesisht, vetëm studentëve që, ose dinë diçka për to, ose thjesht duan t'i fokusojnë studimet e tyre në këto disiplina. Pra, nuk kanë një vend të sigurt në strukturën kurrikulare. Në sistemin e edukimit liberal, përkundrazi, këto disiplina ofrohen për të gjithë studentët e ciklit të parë të studimeve. Universitetet vërtet kanë merita të mëdha në edukimin e studentëve, por po aq të mëdha i kanë edhe problemet.

Akoma, universitetet janë shumë të zënë me konkurrencën ndërmjet njëri-tjetrit: "Universitetet janë të ndërgjegjshëm për emergjencën për renditje të institucionit të tyre, në një mjedis tejet të centralizuar dhe të marginalizuar. Trysnia për punë të besueshme, nga e cila përfiton, në kohën

e tashme, institucioni, është kërkesë ekskluzive”*. Në këtë konkurrencë, pasqyruar dhe matur në numrin e përqindjen e studentëve të punësuar pas diplomimit, fokusi është ofrimi i atyre kurseve që e kanë të garantuar suksesin në terma afatshkurtër. Ndërsa lëndët dhe aktivitet e edukimit liberal ende nuk e kanë një status të tillë. Për këtë arsye edhe neglizhohen.

Nga ana tjetër, dimë se edukimi nuk është rezultat i vetëm një faktori, sikundër është shkolla. Në edukim ndikojnë një varg faktorësh, si familja, bashkëmoshatarët dhe “të tjerët”. Por nëse familja dhe bashkëmoshatarët janë shumë homogjenë dhe të parashikueshëm, “të tjerët” janë heterogjenë dhe të paparashikueshëm. Me “të tjerë” kuptoj faktorë indirektë, si për shembull mediat e ndryshme. Në media, është shndërruar në shqetësim gjuha që përdorin politikanët, që mendoj se ka peshë të madhe në ndikimin negativ që luan edukimi. Artikulimi populist, frymëzuar kryesisht nga politikat e ditës, që bëhet edhe më arrogant kur vendi është në trysinë e ndryshimeve të rëndësishme apo të krizave, ekonomike apo politike qofshin, është shumë larg asaj që shkolla kërkon të arrijë. Në një fjalim mbajtur më 5 tetor 2016, kryeministria britanike e kohës, Theresa May, shprehet: “Nëse besoni se jeni qytetar i botës, jeni qytetar i hiçit. Nuk e kuptoni se çfarë do të thotë vetë fjala qytetari”.

Edukimi demokratik bën apel për arsim liberal, promovuar që në kohën e Aristotelit, një edukim që u siguron nxënësve mundësinë të njihen me shumë disiplina e mënyra të menduari, që inkurajon debatin e diskutimet e gjalla, që kultivon kapacitetin për të kritikuar, që nxit një të kuptuar kompleks të botës dhe të njerëzve, që ushqen simpatinë. Me pak fjalë, kemi nevojë që shkolla jonë të nxjerrë qenie me ndjenja humane. Mësuesit duhet t’u mësojnë nxënësve jo vetëm si të komunikojnë dhe të bisedojnë, por edhe si të jenë të pavarur, demokratë të mirë.

Në kontekstin e vendeve në zhvillim, nevoja për iniciativa në politikat publike dhe për krijimin e mundësive sociale është shumë e rëndësishme. Aksionet publike, që lidhen me arsimimin e kujdesin shëndetësor, ndikojnë në rritjen e popullsisë së gatshme për të marrë pjesë po drejtpërdrejt në procesin e zgjerimit ekonomik. Suksesi që po përjetojnë shumë nga ekonomitë e Azisë Lindore (duke filluar me Japoninë disa dekada më parë) lidhen me rëndësinë që i kushtuan masivizimit të arsimit dhe, pak më vonë, edhe kujdesit shëndetësor (Sen, *po aty*).

* Smith dhe Wexler, 1995, f. 195

Zhvillimi njerëzor është aleati kryesor për të varfrit. Mundësitë sociale kontribuojnë drejtpërdrejt në zgjerimin e aftësive njerëzore dhe cilësisë së jetës. Arsimiti ndihmon në pjesëmarrjen e masave të popullsisë për të qenë pjesë aktive në procesin e zgjerimit ekonomik. Mundësitë që ofron tregtia globale vërtet janë të rëndësishme për zhvillim, por vështirë se mund të kapen e të përdoren nga një popullsi analfabete ose e paarsimuar.

Arritjet e demokracisë varen jo vetëm nga rregullat dhe procedurat që adoptohen e mbrohen, por edhe nga mënyra sesi shtetasit përdorin mundësitë që u ofrohen (A. Sen). Fidel Valdez Ramos, ish-presidenti i Filipineve, e shtroi çështjen shumë qartë në një fjalim të mbajtur në nëntor 1998 në Universitetin Kombëtar Australian:

Nën qeverisjen diktatoriale njerëzit nuk kanë nevojë të mendojnë, nuk kanë nevojë të zgjedhin, nuk kanë nevojë të diskutojnë ose të japin pëlqimin e tyre. Gjithçka që duhet të bëjnë është të binden. Ky është leksioni i hidhur që kam nxjerrë nga përvoja politike në Filipine jo shumë kohë më parë. Në kontrast, një demokraci nuk mund të mbijetojë pa virtytet civile... Sfida politike sot, për njerëzit në të gjithë botën, nuk është thjesht zëvendësimi i regjimeve totalitare me ato demokratike. Përtej kësaj, ajo që duhet të bëjmë është që demokracia të funksionojë edhe për njerëzit e thjeshtë.

Shënim

Tema të tjera, të përshtatshme për t'u shtjelluar në kuadër të “Edukimit Liberal” mund të jenë: Marrëdhënia ndërmjet edukimit dhe tregut të punës /Edukimi dhe standardet e të jetuarit /Si të përshtatim përmbajtjen e shkollimit me nevojat e studentit dhe të shoqërisë? /Kujt i duhet edukimi liberal? /Edukimi liberal si qasje dhe praktikë /Edukimi liberal në vende të ndryshme të botës /Edukimi liberal dhe sot: nevoja për ta përshtatur qasjen e djeshme me kërkesat e sotme. /Edukimi liberal dhe ideja e arsimit të lartë /Çfarë peshe, nëse jemi në gjendje ta matim, duhet të zënë në një kurrikul liberale grup-lëndë të ndryshme. /Edukimi liberal në nivele të ndryshme të shkollimit: nga parashkollor në arsimin e lartë. /Trivium dhe quadrivium i ditëve të sotme: synimet e reja në botën e medieve sociale dhe 'fake

news'. /Profesioni i ri i mësuesit: vlerat dhe synimet e edukimit *versus* mësimit me qendër nxënësin dhe përgjegjshmërinë bazuar në test; /A është i detyrueshëm edukimi për shkollën?

Kultivimi i imagjinatës: Letërsia dhe artet *

Martha Nussbaum

Lois Goutman, Marthe Melchior, Marion Stearns, si dhe mësuesve të mi në Baldwin School

- Mund të bëhemi të pushtetshëm falë dijes, por plotësinë e arrijmë vetëm falë simpatisë... Ndërkohë më duhet të pohoj, se edukimi i simpatisë jo vetëm injorohet sistematikisht në shkolla, por edhe ndrydhet forcërisht. *“Shkolla ime”, Rabindranath Tagore, 1916*
- Mund të konstatohet lehtësisht, që jam në kërkim të vlerësimit, nga njëra anë, të zbavitjes tek njerëzit e rritur, apo edhe të disa prej pjellave të saj, për shembull bukurisë apo abstraktes – secila prej tyre, sofistikuar së tepërmi – dhe, nga ana tjetër, të gjetit të pafajshëm të një foshnje, që zgjat dorën drejt gojës së hapur të mamasë, ndjen dhëmbët e saj dhe më pas e sheh në sy, në një mënyrë shumë kreative. Për mua, loja është ajo, që në mënyrë të natyrshme, udhëheq përvojën kulturore dhe, në të njëjtën kohë, formon edhe bazat e saj. *“Loja dhe realiteti”, Donald Winnicott, 1971*

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kurrë nuk u kanë dhënë mbrojtje kushtetuese – të paktën në nivel federal – të drejtave në fushën “sociale dhe ekonomike”, si për shembull shëndetësisë dhe edukimit, dhe përsëri amerikanët duket se janë të pajisur me ndjesinë e fuqishme, se aftësia e të qenit qytetar është një garanci e sigurt në fitimin e këtyre të drejtave në nivel mbarëkombëtar. Pra, modeli i “zhvillimit njerëzor” nuk është ndonjë ëndërr idealiste. Por vlerësimi për llojin e “zhvillimit njerëzor” që do të kemi, duhet bërë në përputhje me angazhimin kushtetues dhe, sigurisht, nuk mund të themi se është realizuar plotësisht, sikundër ndodh në mos për të gjithë, të paktën për shumicën e vendeve demokratike.

* *Shënim*. Ky kapitull është pjesë e librit *“Not for profit: why democracy needs the humanities”*, autor Martha Nussbaum, botuar nga Princeton University Press. Përfshirja në këtë libër bëhet me leje të autorit dhe botuesit.

Qytetarët nuk mund të lidhen mirë me botën komplekse që i rrethon vetëm me ndihmën e dijeve faktike dhe të logjikës. (*Shih shënime, f. 119*)

Edukimi liberal na ndihmon të kultivojmë “tri aftësi kryesore, jashtëzakonisht të rëndësishme për formimin e qytetarëve, pjesë e një shoqërie demokratike dhe pluraliste, në një botë gjithnjë në lëvizje”:

- Aftësinë për të menduar në mënyrë kritike.
- Aftësinë për të transhenduar frymën lokale dhe për t’i trajtuar problemet botërore si “qytetar i botës”.
- Aftësinë për të parë me simpati gjendjen e vështirë të një personi tjetër

Në këtë pjesë do të analizojmë në detaje aftësinë e tretë, e lidhur ngushtë me dy të parat, që mund ta quajmë edhe imagjinata narrative.* Kjo do të thotë të mendosh sikur të jesh në vendin e tjetrit; të mund të lexosh, në mënyrë inteligjente, historinë e tij; të kuptosh emocionet, dëshirat apo ëndrrat që mund të ketë. Kultivimi i empatisë ka qenë element kryesor i ideve më të mira moderne që kanë karakterizuar edukimin demokratik, si për vendet e Perëndimit, ashtu edhe për ato jo-Perëndimore. Pjesa më e madhe e këtij kultivimi duhet të realizohet në familje, por shkollat – dhe pse jo, edhe kolegjet e universitetet – duhet të luajnë një rol po aq të rëndësishëm. Nëse janë në gjendje ta ndërmarrin një nismë të tillë, në kurrikulat e tyre një vend të rëndësishëm duhet të kenë humanitetet dhe artet, që e armatosin shkollimin me dimensionin e përfshirjes, në gjendje të aktivizojë dhe ripërcaktojë kapacitetin për ta parë botën me sytë e tjetrit.

Më pëlqen shpesh të shprehem se fëmijët lindin me kapacitetin rudimentar për empati dhe për t’u shqetësuar për gjithë sa i rrethon. Nga ana tjetër, këto përvoja të hershme dominohen, në përgjithësi, nga një narcizëm i fuqishëm, sepse ankthi për sigurimin e ushqimit dhe të komfortit nuk është i lidhur, ende, me ndonjë copëz të sigurt të realitetit të tjetrit. Të mësuarit e të parit të një qenie tjetër humane jo si një “gjë”, por si një person nuk është një ngjarje automatike.

* *Shënim, M. Nussbaum. Për më shumë, shih Nussbaum, Cultivating Humanity, Kapitulli 3.*

Një arritje e tillë kërkon tejkalimin e shumë pengesave, e para prej të cilave është paaftësia e dukshme për të bërë dallimin ndërmjet vetes dhe tjetrit. Përvoja tipike e një foshnje njerëzore, që në fillimet e hershme të saj, e përmban këtë dallim që, gjithsesi, fillon të marrë formë gradualisht. Falë shqisave të prekurit dhe të të parit, foshnjat arrijnë të koordinohen dhe të “kapin” faktin se disa gjëra janë pjesë e trupit të tyre dhe të tjera nuk janë. Nga ana tjetër, një foshnjë vërtet mund ta kapë që “gjërat” e prindit nuk janë pjesë e trupit të tij, por në të njëjtën kohë të mos e kuptojë fare që zotëron një botë të brendshme ndjenjash dhe mendimesh, në gjendje të formulojë kërkesa për një sjellje të caktuar. Në këtë situatë është e lehtë për narcizmin të marrë frenat në dorë, duke i gjykuar të tjerët si instrumente të thjeshtë të dëshirave dhe ndjenjave të vetë fëmijës.

Kapaciteti për t’u shqetësuar sinqerisht për tjetrin kërkon disa parakushte. I pari, sikundër thekson Rousseau, ka lidhje me shkallën e kompetencës praktike: një fëmijë, që di si t’i bëjë gjërat vetë dhe për vete, nuk ka nevojë t’i shndërrojë të tjerët në “skllëvër”. Rritja fizike fillon t’i çlirojë fëmijët nga varësia totale narciziste nga të tjerët. Parakushti i dytë është njohja, se kontrolli total nuk është as i mundur, dhe as i mirë, që bota është një vend, ku të gjithë reflektojnë dobësitë e tyre dhe kanë nevojë të gjejnë mënyrat për të mbështetur njëri-tjetrin. Kjo njohje përfshin aftësinë për ta parë botën si një vend ku nuk je vetëm – një vend në të cilin njerëzit e tjerë kanë jetët dhe nevojat e tyre, si dhe të drejtën për t’i realizuar ato. Por parakushti im i dytë përbën një arritje komplekse. Si do mund dikush të arrijë ta shohë botën - nëse është e mundur, ndonjëherë - në këtë mënyrë, nëse e ka parë gjithnjë më parë si një vend ku format e tjera lëvizin përreth vetëm në funksion të plotësimit të kërkesave të tij?

Një pjesë e përgjigjes për këtë pyetje gjendet, padyshim, në faktin që ne të gjithë, si qenie njerëzore, jemi të pajisur me disa funksione të brendshme. Ndërveprimi natyral i buzëqeshjes ndërmjet foshnjës dhe prindërve tregon gatishmërinë për të njohur njerëzoren tek tjetri. Shumë shpejt, foshnja duket i kënaqur për këtë njohje. Pjesa tjetër e përgjigjes gjendet tek loja, e cila mbështet parakushtin e tretë tejet të rëndësishëm, atë të shqetësimit për tjetrin: aftësia për të imagjinuar përvojën që do të kesh po të vendosesh në vend të tjetrit.

Një nga mbështetësit më me ndikim dhe interesant të lojës me bazë imagjinatën është Donald Winnicott (1896-1971), psikanalist dhe pediatër britanik. Winnicott filloi ta ushtrojë psikanalizën pas shumë vitesh përvojë

në klinikën e tij pediatrike, ku trajtonte fëmijë që vuanin nga sëmundje nga më të ndryshmet. Në rrjedhojë, në ndryshim nga psikanalistët e tjerë, pikëpamjet e tij e kanë bazën në një informacion të pasur, filtruar nga përvojat e shumta klinike, një fakt që e përmendte shpesh, gjatë gjithë jetës, kur theksonte se “nuk ishte i interesuar në kurimin e simptomave, por në ndërtimin e marrëdhënieve me njerëzit si të tërë, në njohjen e jetës dhe të dashurive të tyre”. Dhe pavarësisht se ku e kanë pasur origjinën, por pikëpamjet e tij rreth lojës në zhvillimin e fëmijës kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë një ndikim të madh e të gjerë në kulturën e rritjes së tyre dhe në përgjithësi nuk kanë pasur lidhje me simpatitë ose jo të mëparshme për vetë idetë psikanaliste. (Për shembull, duket sikur vetë Winnicott besonte se batanija e sigurisë së Linus, në pjesën me kartona “Bizelja” të Charles Schultz përfaqësonte idenë e tij për *objektin tranzitor**).

Si mjek, Winnicott kishte pasur mundësinë të vëzhgonte shumë fëmijë të shëndetshëm dhe besonte në aftësinë për të zbërthyer procesin e zhvillimit të tyre - edhe me koston e shqetësimeve etike që mund të hapte, por që shërbente si bazë për një demokraci të shëndetshme – si një lastar që rritej në mjedisin e luftërave të hershme (gjithnjë nëse gjërat shkonin mirë). Për Winnicott, zhvillimi i fëmijës në përgjithësi shkon si duhet dhe prindërit zakonisht bëjnë punë të mirë. Prindërit shqetësohen për fëmijët që në ditët e para të lindjes dhe u përgjigjen nevojave të tyre më së miri, duke i mundësuar vetes së fëmijës të zhvillohet gradualisht, sikundër të mësojë të shprehet. (Winnicott përgjithësisht përdor fjalën “mama”, por gjithnjë thekson se “mamaja” është një kategori funksionale dhe se roli i saj mund të luhet edhe nga secili nga prindërit, të një apo dy sekseve; akoma, Winnicott thekson rolin maternal të vetë atij si analist). Në fillim, foshnja nuk i percepton prindërit si objekte të përcaktuar dhe nuk mund të ketë emocione të plota, të ndara, në lidhje me ta. Bota e tij është simbiotike dhe në thelb narciziste. Gjithsesi, gradualisht, foshnja zhvillon kapacitetin për të qëndruar vetëm – ndihmuar edhe nga *objektet tranzitorë*, emri që Winnicott i jep batanijes dhe kafshëve pelushi që u mundësojnë fëmijëve të kënaqin veten në mungesë të prindërve. Në fakt, fëmija përgjithësisht zhvillon aftësinë për “të luajtur vetëm, në prani të mamasë”, një shenjë e rëndësishme në rritjen e besimit në zhvillimin e vetes. Në këtë fazë fëmija fillon të aftësohet në perceptimin e prindit si një person i tërë, duke zëvendësuar në këtë mënyrë, perceptimin e tij si një zgjatim të nevojave që ai vetë ka.

* *Shënim i përkthyesit*: Në anglisht është përdorur termi *transitional object*.

Loja - beson Winnicott - është thelbësore në këtë fazë të zhvillimit. Rritur në një mjedis ndrydhës dhe ultra-fetar, ku loja imagjinative ishte rreptësisht e ndaluar, Winnicott kishte përjetuar marrëdhënie seriozisht të vështira në jetën si e rritur, një rrjedhojë që e shihte të lidhur pikërisht me edukimin në fëmijëri dhe e nxiti të krijonte besimin për lojën si element kryesor për një rritje të shëndetshme të personalitetit.* Loja është lloji i aktivitetit që zhvillohet në hapësirën ndërmjet dy njerëzve – ajo që Winnicott e quan “hapësirë potenciale”. Përgjatë lojës (fëmija në fillim, dhe i rrituri më pas) eksperimentojnë me idenë e tjetërsimit në mënyra që janë më pak kërcënuese se sa mund të ndodhë të shndërrohet shpesh takimi direkt me një tjetër.† Përgjatë lojës, të dyja palët fitojnë praktika me shumë vlerë sa i takon reciprocitetit dhe fitimit të empatisë. Loja fillon me fantazitë magjike, ku fëmija ka kontrollin për çfarë do të ndodhë – si lojërat e vetë-kënaqes që një fëmijë i vogël luan me *objektet tranzitorë*. Por me rritjen dhe zhvillimin e besimit të vetja, si dhe të sigurisë, kontrolli nuk është më aq i fortë dhe fëmija manifeston aftësinë për të eksperimentuar me surpriza dhe me shkallën e cenueshmërisë, në mënyra të atilla që mund të shtrihen edhe jashtë kushteve të lojës, por që gjithsesi e bëjnë lojën më të bukur. Mendoni, për shembull, për gëzimin e pafundmë që shfaqet te fëmijët e vegjël kur luajnë në intervalin nga “zhdukja” deri në “rishfaqjen” e njërit prej prindërve, apo të një objekti që u pëlqen.

Me avancimin e lojës, fëmija zhvillon aftësinë për t’u habitur, për të qenë kureshtar. Për shembull, vjershat e thjeshta me rimë që fëmijët mësojnë zakonisht në çerdhe apo kopsht i orientojnë të vendosin veten e tyre në vend të një kafshe të vogël, një tjetër fëmije apo edhe të një objekti material, jo të gjallë. Për shembull:

Xixa-xixa xixëllon,

yll i vogël lart qëndron.

Pyes veten me habi

yll i vogël, si ndrit ti?

* *Shënim, M. Nussbaum*. Për më shumë, shih: F. Robert Rodman, Winnicott: *Life and Work* (Cambridge, MA: Perseus Publishing, 2003).

† *Shënim, M. Nussbaum*. Për më shumë, shih: Donald Winnicott, *Playing and Reality* (London and New York: Routledge, 2005, originally published 1971).

Vargjet e mësipërme janë një paradigmë e habisë, sa kohë që të kërkojnë të vështrosh një formë dhe ta perceptosh nga bota jote e brendshme. Në fund të fundit, kjo është ajo që fëmijët duhet të jenë të aftë të bëjnë me njerëzit e tjerë. Pra, rimat dhe vjershat e fëmijërisë së hershme hedhin bazat e një përgatitje shumë të rëndësishme për problemet që dalin gjatë jetës.* Prezenca e tjetrit, e cila mund të paraqitet edhe në formën e një kërcënimi, në lojë shndërrohet në një burim të këndshëm kurioziteti, kurioziteti i cili kontribuon në zhvillimin e një qëndrimi të shëndetshëm në marrëdhëniet që ndërton me miqtë apo në mënyrën e sjelljes në dashuri dhe, më pas, edhe në jetën politike.

Winnicott kuptoi se “hapësira e mundshme” ndërmjet njerëzve nuk shkërmoqet thjesht sepse u rritën! Jeta është e mbushur me mundësitë për të qenë kureshtar dhe për të luajtur. Në rrjedhojë – thekson Winnicott – marrëdhëniet seksuale në veçanti dhe ato intime në përgjithësi, janë hapësirat në të cilat aftësia për të luajtur është shumë e rëndësishme. Njerëzit mund të mbyllen në vetvete, duke harrur për ekzistencën e botës së brendshme të tjetrit, ose të mbajnë dhe të zhvillojnë edhe më shumë aftësinë për të perceptuar format e tjetrit, në termat e jetës së brendshme, në imagjinatën e tyre. Të gjithë ata që e njihnin Winnicott befasoheshin nga aftësia e tij e jashtëzakonshme për t’u lidhur me tjetrin me ndihmën e lojës dhe të empatisë. Me pacientët – veçanërisht me pacientët fëmijë – kishte zotësinë e pafundme për të hyrë në botën e lojës së fëmijës, për t’u gëzuar bashkë me të për lodrat, për kafshët me plush, për fantazitë për lindjen e një vëllai apo motre. Por jo vetëm! Edhe pacientët e rritur lëvdonin aftësinë e tij për të vënë veten në vendin e tjetrit. Harry Guntrip, analisti gjashtëdhjetë e një vjeçar, e përshkruan në këtë formë mënyrën se si ndihej gjatë seancave me të, në një intervistë dhënë për një gazetë: “Nuk kisha asnjë lloj tensioni dhe ndihesha krejtësisht i çlodhur, falë aftësisë së Winnicott për të qenë i pranishëm në botën time të brendshme, për të kuptuar se çfarë ndodhte aty brenda!”

Loja ishte karakteristikë e marrëdhënieve të Winnicott edhe jashtë detyrave terapeutike. Dhe jo vetëm ai! Edhe bashkëshortja. Të dy bashkë ishin të famshëm në rrethet shoqërore për shakatë e mprehta dhe çapkënlleqet. Ndërsa në shumë nga artikujt e Winnicott mund të gjeni

* *Shënim, M. Nussbaum. Për më shumë, shih: Nussbaum, Poetic Justice: The Literary Imagination and Public Life* (Boston: Beacon, 1995), ch. 1.

vizatimet qesharake apo poezitë, që burrë e grua i shkruanin njëri-tjetrit, të detyruar të ndiqnin takime të mërzitshme!*

Për Winnicott, loja nuk duhet të ndalojë së qeni element i jetës me të filluar “bota e të rriturve”. Për më tepër - thekson Winnicott – loja luan një rol të rëndësishëm në formësimin e qytetarëve demokratikë. Barazia demokratike shoqërizohet me të qenit i cenueshëm. Sikundër ka vënë në dukje, me shumë mprehtësi, një nga pacientët e tij: “Alarmant është fakti që barazi do të thotë se të dy jemi fëmijë. Pyetja është *Ku është babai?* Ne e dimë ku jemi, nëse një nga ne është babai!”† Loja i mëson njerëzit të jenë të aftë të jetojnë me të tjerët pa qenë nevoja për kontroll. Loja lidh përvojat e të qenit i cenueshëm dhe i befasuar, me kureshtjen dhe habinë – jo me ankthin, që frenon e tmerron.

Si arrijnë të rriturit të mbajnë gjallë dhe të zhvillojnë aftësinë për të luajtur, pasi kanë lënë prapa krahëve botën e lojërave të fëmijërisë? Winnicott argumenton, se një rol të rëndësishëm luajnë artet. Sipas Winnicott, funksioni kryesor i artit në të gjitha kulturat e njerëzimit është të ruajë dhe të theksojë kultivimin e “hapësirës së lojës”. Winnicott e shih artin në jetën e njerëzve, përpos të gjithave, si faktor për ushqimin e empatisë, për zgjerimin e kapaciteteve për ta pasur. Në kënaqësinë që të sjell soditja e një veprë të sofistikuar komplekse në art, Winnicott shih vazhdimësinë e asaj kënaqësie që gjente tek lojërat dhe personazhet në kohën kur ishte foshnjë.

Pikëpamjen e Winnicott, që loja është shumë e rëndësishme për zhvillimin e një personaliteti të shëndetshëm, e gjejmë edhe te përfaqësuesit e hershëm të progresivizmit, bazuar në përvojat dhe refleksionet e tyre – pavarësisht sa shumë i njihnin veprat e njëri-tjetrit. E rëndësishme është që edhe progresivistët promovojnë të njëjtën qasje. Progresivistët shkojnë edhe më tej: shkollat tradicionale do të vazhdojnë të jenë të dështuara për mos-përfshirjen e vlerave edukative të lojës. Ata këmbëngulin që loja duhet të jetë pjesë përbërëse e strukturës së shkollimit, përgjatë gjithë edukimit të fëmijës, në fillim dhe në fund, herët dhe më pas. Fröbel (*shih shënime, f. 120*)

* *Shënim, M. Nussbaum.* Për më shumë, shih: Rodman’s extensive discussion. For Guntrip’s analysis with Winnicott, shih J. Hazell, H.J.S. *Guntrip: A Psychoanalytical Biography* (London: Free Association Books, 1986).

† *Shënim, M. Nussbaum.* Për më shumë, shih: Donald Winnicott, *Holding and Interpretation: Fragments of an Analysis* (New York: Grove Press, 1986), 95.

fokusohet në nevojën që fëmijët e vegjël kanë për të eksploruar mjedisin përreth, duke manipuluar objektet dhe përdorur imagjinatën, duke u dhënë formave të thjeshta (sferave dhe kubeve) zë dhe frymë, duke i shndërruar në personazhe të historive që tregojnë dhe përforcuar me personalitet. Gertruda, heroina e krijuar nga Pestalozzi (*shih shënime, f. 121*), kupton se mësimi pasiv e rutinë e mbyt personalitetin e fëmijës, ndërkohë që aktivitetet praktike, të mbushur me nota të gëzuara e të hareshme, e pasurojnë edhe më shumë.

Këta edukatorë arritën të kuptojnë - për fat të mirë, që në fazat më të hershme të studimeve të tyre - se një nga kontributet më të rëndësishme të artit në jetën e fëmijës pas shkollës qëndron në fuqizimin e burimeve emocionale dhe imagjinative të personalitetit të tij, duke i pajisur me aftësinë për të kuptuar si veten, ashtu edhe tjetrin, që ndryshe do u mungonte. Ne nuk arrijmë ta shohim tjetrin vetvetiu, automatikisht, si qenie njerëzore, në brendësi dhe hapësirë, mbushur me emocione, mendime e ndjenja të thella. Është shumë e thjeshtë ta shohësh personin tjetër thjesht si një trup fizik – dhe po aq e thjeshtë të mendosh më pas se mund ta përdorim për synimet që kemi, të mira apo të këqija qofshin. Është arritje të shohësh shpirtin në një trup, një arritje që mbështetet e nxitet edhe më shumë nga poezia dhe artet.

Poezia dhe artet na nxisin të kërkojmë të zbulojmë botën e brendshme në formën që shohim – dhe, në të njëjtën kohë, edhe të gjejmë të njëjtën gjë brenda vetes tonë, të përipiqemi të shohim sa më thellë brenda nesh.

Në edukimin teknik dhe bazuar në fakte është e thjeshtë të mungojë dimensionin i një kultivimi të tillë. Filozofi John Stuart Mill (1806-1873), duke qenë një fëmijë me aftësi të jashtëzakonshme, mori një edukim shumë të mirë në gjuhë, histori dhe shkenca, por që nuk kishte si karakteristikë kultivimin e burimeve emocionale dhe imagjinuese. Në moshë të re, vuante nga një formë e rënduar depresioni. Mill ia atribuon rikuperimin e tij ndikimit që ushtroi poezia e Wordsworth, me ndihmën e së cilës arriti të mësojë se çfarë janë emocionet dhe, në të njëjtën kohë, të kërkojë emocione edhe te tjetri. Vite më vonë, Mill zhvilloi konceptin të ashtuquajturin “feja e humanizmit” – sikundër e quajti – bazuar në kultivimin e simpatisë, të asaj simpatie që kishte gjetur ndërsa merrej me poezi.

Pothuaj në të njëjtën kohë, në Amerikë, Bronson Alcott, frymëzuar nga pedagogjia sokratike (*shih shënime, f. 123*) që përdorte në shkollën “Tempull”,

ku jepte mësim (*shih shënime, f. 127*) përdor të njëjtën ide dhe i jep edukimit poetik një formë kurrikulare. Bazuar te Wordsworth, dhe shpesh edhe duke përdorur poemat e tij në klasë, Alcott mbron teorinë se poezia kultivon një hapësirë të brendshme te fëmija, se poezia e ushqen me aftësinë për t’u emocionuar dhe për të imagjinuar. Në veprën e Louisa Alcott “Burrat e vegjël”, lojërat me bazë imagjinatën që luhen në shkollën “Plum tree” janë po aq të rëndësishme sa leksionet intelektuale dhe ndërthuren me to. Në rrjedhojë, edhe lojërat, edhe leksionet, gjallërohen nga fryma e dashur e reciprocitetit, ndërkohë që shkolla, e drejtuar si një familje e madhe, i paraprin idesë së mrekullueshme të Winnicott-it, se loja e sofistikuar artistike është një vazhdimësi e lojës prind-fëmijë.

Por zhvillimi më i rëndësishëm për artet, si element ku kryqëzohen dimensionet e ndryshme të shkollimit të hershëm, duhej të priste shekullin e njëzetë dhe eksperimentet e sofistikuara teorike në shkollë të Tagore në Indi dhe Dewey në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Dewey shkruan disa studime shumë të mira për artet, si përbërësi kryesor i edukimit në një shoqëri demokratike. Edhe në ditët tona është e qartë, se kultivimi i imagjinatës nëpërmjet muzikës dhe shfaqjeve teatrale kanë luajtur një rol të rëndësishëm në “Shkollën Laborator” të Dewey. Por Dewey këmbëngulte, se ajo çfarë është e rëndësishme për fëmijët nuk është thjesht prania e “arteve të bukura” – duke kuptuar me këtë të fundit ushtrime plotësuese, nëpërmjet të cilave fëmijët mësojnë “të vlerësojnë” veprat e artit, të shkëputur nga bota reale; as edhe përpjekjet për t’i mësuar të besojnë se imagjinata është e përshtatshme vetëm në domenin e botës jo reale! Përkundrazi! Fëmijët kanë nevojë ta shohin dimensionin “imagjinatë” në të gjitha ndërveprimet e tyre, ndërsa veprat e artit si domenin në të cilin mund të kultivohet.

Diferenca ndërmjet lojës dhe asaj që vlerësohet si “punë serioze” nuk duhet të jetë diferenca ndërmjet pranisë dhe mungesës së imagjinatës, por diferenca në materialet mbi/ose rreth të cilave shfaqet imagjinata.

Në një shkollë të suksesshme, fëmijët duhet të kuptojnë se imagjinata duhet të përdoret në çdo aktivitet që shkon “përtej synimit të përgjigjes direkte fizike”.* Dhe në “çdo aktivitet” përfshihet, kryesisht, çdo gjë që ka

* *Shënim, M. Nussbaum. Dewey, Democracy and Education, 226, 227.*

rëndësi: një bisedë me miqtë, studimi i një transaksioni ekonomik deri edhe një eksperiment shkencor.

Tashmë dëshiroj të fokusohem te roli që i jep Tagore përdorimit të arteve, sepse shkolla e tij (*shih shënime, f. 128*) ishte shkolla e një artisti, një shkollë ku mësohej muzikë, luhej teatër e recitohej poezi, kërcehej e ushtrohej vallëzimi – të gjitha të rëndësishme që në klasën e parë, sapo fëmija fillonte të ndiqte shkollën. Por fillimisht, më duhet të nënvizoj përkushtimin që Tagore kishte ndaj “pyetjeve sokratike”.

Vërtet që hulumtimi sokratik mund të duket i ftohtë dhe jo-emocional, dhe ndjekja e vazhdueshme e një argumenti logjik mund të bëhet shpesh në riskun e cenimit të elementëve të tjerë të personalitetit, por duket se Tagore ka qenë i ndërgjegjshëm për dukuritë “anësore” që e shoqëronin dhe, në të njëjtën kohë, edhe shumë i vendosur për t’i shmangur. Sokratizmi i Tagore formësohet nga pasioni për të inkurajuar fuqizimin e grave dhe të vajzave, po aq sa edhe përvoja e hidhur e vetë tij me shkollën e modës së vjetër.

Për Tagore, artet luajnë një rol të rëndësishëm në kultivimin e simpatisë – ndoshta një nga rolet më të rëndësishëm - një rol, që në arsim është “injuar sistematikisht” dhe “ndrydhur forcërisht” nga modelet e standardeve që zbatohen në të. Artet, në pikëpamjen e tij, promovojnë si kultivimin e vetes së brendshme, ashtu edhe aftësinë për t’ju përgjigjur tjetrit. Përgjithësisht, të dyja shkojnë njëkohësisht, krah për krah, sepse vështirë që dikush mund të gëzohet për tjetrin, sa kohë që nuk ka zhvilluar aftësinë për të eksploruar vetveten.

Tagore i përdorte lojërat me role përgjatë gjithë ditës së shkollës, ndërkohë që zhvillimi intelektual realizohej duke u kërkuar fëmijëve të eksploronin dhe debatonin për pikëpamje jo-familjare mendimi e perspektivash. Lojërat me role – për ta zgjeruar argumentin – nuk ishin thjesht lojëra logjike. Lojërat me role përdorehin për të kultivuar simpatinë, njëkohësisht me kultivimin e aftësive logjike. Lexuesi mund të shtojë edhe shumë arsye të tjera, por kam zgjedhur të rendis disa: për të eksploruar hapësirat e vështira në diferencat fetare, duke i ftuar nxënësit të festonin ato rituale dhe ceremoni që nuk ishin pjesë e besimit të tyre, pra të kuptonin dukuri që nuk ishin familjare për ta, duke marrë pjesë në “besimin e tjetrit” me ndihmën e imagjinatës; Tagore përdorte shfaqjet teatrale me imitime, muzikë dhe vallëzim, duke vënë në lëvizje gjithë trupin e tyre, për t’i ndihmuar fëmijët të eksploronin role të ndryshme dhe të familjarizohen me

atë gjesturë apo gjuhë-trupi me të cilat nuk janë familjarë. Kërcimi ishte pjesë e rëndësishme e shkollës, si për vajzat, ashtu edhe për djemtë, sepse Tagore kishte kuptuar se eksplorimi i jo-familjares kërkon vullnetin për të lënë mënjane ngathtësinë e turpin dhe për të hyrë në rol.

Vajzat ishin veçanërisht në qendër të vëmendjes dhe shqetësimit të tij. Në kulturën e kohës, përgjithësisht vajzat kishin turp për trupin e tyre dhe nuk ishin të lira të lëviznin lirisht nga një vend në tjetrin, gjë që bëhej edhe më e vështirë në prani të gjinisë tjetër. Avokat, përgjatë gjithë jetës, i lirisë dhe barazisë për gratë, Tagore arriti në përfundimin se nuk mjaftonte thjesht t’u bëhej thirrje vajzave e grave të lëviznin lirisht – ishte e vështirë të tejkaloheshin vite e vite ndrydhje e kufizimi. Përpjekja për të arritur synimet e mësipërme mund të ishte edhe më e suksesshme nëse arrinin të mësonin, me ndihmën e koreografisë, se si të lëviznin, lirisht, nga një vend në tjetrin. (Akoma, me kërkesën e Tagore, kunata e tij njihet të ketë modeluar bluzën, që vishet nga të gjithë gratë indiane, poshtë *sari*. Synimi i Tagore ishte që gratë të kishin një lloj veshje, me të cilën mund të lëviznin lirisht, nga një vend në tjetrin, pa frikën se *sari* do mund të ekspozonte pjesë të trupit të tyre në mënyrë të papërshtatshme.) Në të njëjtën kohë, nën kujdesin e Tagore, edhe djemtë eksploronin role sfiduese në kërcim. Tagore ka qenë jo vetëm kërcimtar i famshëm, por edhe koreograf i shkëlqyer, i njohur për lëvizjet androgjene dhe me përdredhje të trupit.

Në këto shfaqje, tema e barazisë gjinore trajtohet qartë, pa ekuivokë, dhe është e pranishme në mënyrë konstante. Gratë janë ato që marrin rol udhëheqës në refuzimin e zakoneve të kalcifikuara në shoqërinë e kohës. Për shembull, në pjesën “Toka e letrave”, të gjithë banorët e saj shfaqen si robotë dhe jetojnë në një botë dydimensionale – njësoj si pikturat që gjenden në kartat me piktura që mbajnë përpara - deri sa gratë fillojnë të mendojnë dhe të bëjnë pyetje.

Amita Sen, mamaja e fituesit të Çmimit Nobel Amartya Sen, ka qenë nxënëse në fillore, kur i ati i saj, ekspert i mirënjohur i historisë së besimit Hindu, iu bashkua stafit mësimdhënës të shkollës së Tagore, ku ajo mësonte – në fakt, vetëm pak kohë pas themelimit. Si fëmijë, një ditë po luante në kopshtin ku binin dritaret e zyrës së Tagore. Loja e Amitës e frymëzon Tagore të krijojë poemën e famshme “Chota mai”, ku përshkruhet se si një vajzë e vogël, me lojën e saj, e shqetësoi dhe e la pa punë.

Vite më vonë, kur ishte nuse e re, ajo shërbeu përsëri si burim frymëzimi për një poemë tjetër të mirënjohur të Tagore, ku flitet për një grua të re “që hedh hapat e parë në ujërat e jetës, pa frikë”. Ndërkohë, nxënëse në shkollën e Tagor, Amita ka qenë një nga kërcimtarët më të talentuara dhe vazhdimisht merrte rolet kryesore. Amita Sen ka shkruar dy libra për shkollën. Në librin “Gëzim për të gjitha punët”, përkthyer edhe në anglisht, përshkruan aktivitetin e Tagore si kërcimtar dhe koreograf.*

Amita Sen arrin të kuptojë, se pjesët skenike me kërcim të Tagore nuk janë thjesht shfaqje me elementë të bukur artistikë. Synimi kryesor i Tagore është të kultivojë emocione dhe imaginatë të fëmijët. Përshkrimet e saj të detajuara për rolin e teatrit dhe të dramës në shkollë, tregojnë se gjithë edukimi “i rregullt” në Santiniketan, është një edukim që i aftëson nxënësit t’ia dalin në të gjitha standardet e kriteret e vlerësimit, sepse fuqizohet nga pasioni, kreativiteti dhe kënaqësia, falë kombinimit të shkollës me kërcimin dhe këngën.

Kërcimi i tij ishte sikur të shihje një emocion të vallëzonte. Retë e gëzueshme në qiell, drithërima e erës në gjethet e vjeshtës, drita që shkëlqen në sumbullat e vesës së barit të mëngjesit, drita e hënës që derdhet mbi tokë, lulëzimi dhe vyshkja e luleve, mërmëritja e gjetheve të thara – pulsi i përshpejtuar nga emocionet e gëzimit të zemrës së njeriut dhe brengat e ndërgjegjes së vvarë – të gjitha gjenin rrugën e tyre për të qenë të pranishme në lëvizjet ekspresive të kërcimtarit dhe brendinë e shfaqjes.†

Ndërkohë, mos harroni që po flasim për kujtimet e një zonje të vjetër që përshkruajnë përvojat e kaluara në kohën e fëmijërisë. Është e jashtëzakonshme, se si emocionet dhe poezia e fëmijës kanë mundur të jetojnë me aq forcë në zemrën e kësaj gruaje, dhe çfarë mirënjohje për këtë lloj edukimi, që arrin t’i japë shkëlqim personalitetit, në gjendje ta ruajë përgjatë gjithë jetës, edhe pse faktet e mësuara në atë kohë janë harruar. Sigurisht, sikundër bëhet e qartë edhe në libër, kjo nuk mundësohet duke i lënë fëmijët thjesht të lirë të luajnë. Mësimi me ndihmën e arteve kërkon disiplinë dhe ambicie, nëse dëshirojmë të shtrijmë dhe të zgjerojmë aftësitë për empati dhe për t’u shprehur. Mësimi në orët e letërsisë dhe të arteve mund të kultivojë simpati në shumë mënyra, për shembull nëpërmjet

* *Shënim, M. Nussbaum. Amita Sen, Joy in All Work.*

† *Shënim, M. Nussbaum. Ibid, 35.*

përfshirjes në vepra të ndryshme të letërsisë, muzikës, arteve të bukura dhe kërcimit. Tagore ishte shumë më përpara se sa Perëndimi në fokusin që vendos tek muzika dhe kërcimi, të cilat në rastin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës përdoren vetëm në kohë të caktuara, periodikisht.

Kemi nevojë të mendojmë për “zonat e verbra” të të menduarit të nxënësve, t’i analizojmë dhe, në rrjedhojë, edhe “t’i mbushim” me tekst. Të gjitha shoqëritë, në të gjitha kohërat, kanë pasur “zonat e verbra” të tyre, që në përgjithësi manifestohen në formën e injorimit ose të etiketimit si “intelektualisht të paafte” për grupe të ndryshëm brenda kulturës së tyre, ose edhe ndaj atyre që janë jashtë. Veprat e artit, pavarësisht nëse i përkasin letërsisë, muzikës apo teatrit, mund të zgjidhen të tilla që të promovojnë kritikë ndaj etiketimeve si “kokëtrashë” dhe një perspektivë për të parë më qartë për atë që shpesh nuk shihet ose anashkalohet.

Ralph Ellison, në një ese që ka shkruar për romanin e tij madhështor *Njeriu i padukshëm*, pohon se vepra e tij mund të shërbejë si “varka e perceptimeve, shpresave dhe zbavitjes”, për të cilat kultura amerikane mund të “negociojë ndasitë dhe gropat thithëse” që gjenden ndërmjet nesh dhe idealit tonë për demokracinë.* Tema dhe objektivi i romanit janë “sytë e brendshëm” të lexuesit të bardhë: një zezak i paemër (emri nuk i përmendet kurrë) në kërkim të identitetit dhe vendit të tij në shoqëri. Por heroi i veprës është “i padukshëm” për shoqërinë e bardhë! Në studimin tonë mund të themi, se gjithçka është në rrjedhojë të dështimit të sistemit të edukimit për të përfytyruar, dhe jo të ndonjë aksidenti biologjik që i ka ndodhur. Nëpërmjet imagjinatës - sugjeron Ellison – ne jemi të aftë të zhvillojnë zotësinë për të parë humanizmin te njerëzit me të cilët, takimet në jetën e përditshme janë, përgjithësisht, në rastin më të mirë sipërfaqësore dhe, në rastin më të keq, të infektuara nga stereotipa përçmues. Dhe stereotipat zakonisht janë të bollshme kur bota që na rrethon ka ndërtuar mure të fortë ndarës ndërmjet grupeve, si dhe ka sajuar dyshime që i bëjnë këto takime të vështira.

Në Amerikën e Ellison, sfida më e rëndësishme për “sytë e brendshëm” është ajo e racës, një pozicion i stigmatizuar, pothuaj i pamundshëm për lexuesin e bardhë konvencional për ta kuptuar dhe aq më pak për “të

* *Shënim*, M. Nussbaum. Ralph Ellison, *Invisible Man* (New York: Random House, 1992 Modern Library edition, with Introduction by Ellison, added 1981; originally published 1952), Introduction.

banuar në atë lëkurë”. Për Tagore, sikundër kemi pasur rastin ta konstatojmë edhe në këtë libër, një zonë e verbër kulturore për një çështje të caktuar është agjencia dhe intelijenca e vajzave dhe grave. Me shumë zgjuarsi, Tagore projektonte mënyrat për të promovuar respekt dhe kureshtje ndërmjet dy sekseve. Në rastin e analizës sonë, të dy shkrimtarët arsyetojnë që informacioni për sigmën sociale dhe pabarazinë nuk mund të përmbushë nevojën që ka të kuptuarit të plotë rreth qytetarisë demokratike pa një përvojë pjesëmarrje në pozicionin e të stigmatizuarit, në gjendje të aftësohen nga teatri dhe letërsia. Refleksionet e Tagore dhe Ellison sugjerojnë, se shkolla që lë jashtë artet dhe aktivitetet artistike, lë jashtë mundësitë më të mira për të kuptuar, si duhet, demokracinë. Dikur, një nga miqtë e mi indianë më ka shprehur zhgënjimin, që kur ishte fëmijë, në shkollat indiane publike (shtetërore) nuk i është dhënë kurrë mundësia për të eksploruar pozicione të ndryshme sociale nëpërmjet teatrit, ndërkohë që vite më vonë, nipërit e mbesat e tij që studiuan në Shtetet e Bashkuara të Amerikës mësuuan rreth lëvizjeve për të drejtat civile me ndihmën e aktiviteteve të ndryshme, për shembull duke u vendosur në rolin e Rosa Parks, ku përvoja e të ulurit në fund të autobusit dhe informacioni për arsyet që i detyronin të zinjët të rrinin vetëm në atë vend i bindi edhe më shumë për pasojat e stigmës, që përndryshe nuk do të kishte qenë e plotë pa një pjesëmarrje të tillë.

Pra, kemi nevojë të kultivojmë tek nxënësit e studentët tanë “sytë e brendshëm”, që do të thotë akoma dhënia e kujdesshme e mësimave në arte dhe shkenca humane – sigurisht, në mënyrë të përshtatshme për moshën dhe zhvillimin e tyre – në synimin për t’u sjellë në vëmendje dhe vënë në kontakt çështje të ndryshme që kemi shqetësim dhe që kanë lidhje me gjininë, racën, etninë apo përvoja e të kuptuar që shtrihen në kufijtë e takimit të kulturave të ndryshme. Mësimi në arte mund dhe duhet të lidhet me të kuptuarin se “çfarë do të thotë të jesh qytetar i botës”, duke qenë se veprat e artit janë, gjithnjë, një mënyrë tejet e vyer për të kuptuar arritjet dhe vuajtjet e një kulture të ndryshme nga perceptimi i atyre që e kanë krijuar atë vetë.

Thënë ndryshe, duke qenë se artet kultivojnë aftësitë për të luajtur dhe për të treguar empati, sepse adresojnë veçanërisht “zonat e verbra”, roli i tyre është i dyfishtë. Roli i parë mund të realizohet duke vënë në skenë apo duke i njohur fëmijët dhe studentët me vepra që i çojnë jashtë kohës dhe hapësirës ku jetojnë – gjithsesi, duhet pasur parasysh fakti që jo çdo vepër e zgjedhur në mënyrë rastësore e realizon një synim të tillë. Roli i dytë kërkon

një fokus më të theksuar në ato vepra, tematikat e të cilave shtrihen në zonat e shqetësimit social. Të dy rolet, në një farë mënyre, janë të pranishëm në mënyrë të vazhdueshme, sa kohë që kapaciteti i përgjithshëm, me t’u zhvilluar një herë, e bën më të lehtë adresimin e “zonave kokëfortë të verbërisë”.

Të dy rolet, në synimin për të qenë të lidhur në mënyrë të vazhdueshme me vlerat demokratike, kërkojnë jo vetëm një këndvështrim normativ, në lidhje me atë se si duhet të lidhen qeniet njerëzore me njëra-tjetrën (si të barabartë, dhe secili me dinjtet dhe vlera), por edhe një përzgjedhje të kujdesshme sa i takon veprave të artit që do të përdorim. Imagjinata empative mund të jetë tekanjoze dhe të marrë formën e një “terreni të thyer”, nëse nuk lidhet me idenë e barazisë në dinjtet ndërmjet qenieve të ndryshme njerëzore. Është e thjeshtë të kesh simpati të pastër për ata që i kemi afër gjeografikisht, apo janë të ngjashëm me ne në pikëpamjen e grupit social a racës, dhe po aq e thjeshtë të refuzosh njerëzit që jetojnë larg apo ata që janë pjesëtarë të grupeve minoritare, shpesh bazuar vetëm në paragjykime. Nga ana tjetër, nuk duhet të harrojmë që në shumë vepra arti përforcohen simpati ndërtuar mbi pabarazi. Fëmijëve që u kërkohej të kultivojnë imagjinatën, duke u dhënë për të lexuar literaturë raciste apo ku gruaja objektifikohet pornografikisht, nuk do të edukohen në mënyrën e duhur për një shoqëri demokratike. Nuk mund të mohojmë se në vende të ndryshme të botës kanë lindur lëvizje antidemokratike që kanë ditur t’i shfrytëzojnë si duhet artet, muzikën dhe retorikën, në mënyrë të atillë që kontribuojnë edhe më shumë në stigmatizimin dhe përçmimin e grupeve dhe njerëzve të caktuar.*

Komponentja e imagjinatës në edukimin demokratik kërkon përzgjedhje të kujdesshme. Pse? Duhet të kemi në vëmendje, se mënyra me të cilën këto forma të gjymtuara të “letërsisë” operojnë është nëpërmjet ndalimit të depërtimit të imagjinatës në pozicionet e stigmatizuara, për shembull, duke i trajtuar minoritetet apo gratë thjesht si objekte, pa vlerën më të vogël për të eksploruar përvojat e tyre. Aktiviteti i imagjinatës, me ndihmën e së cilës arrijmë të eksplorojmë jetën e brendshme të dikujt tjetër, ndërkohë që vërtet nuk përbën tërësinë e një marrëdhënie të shëndetshme me tjetrin është, të paktën, një nga përbërësit kryesor të kësaj marrëdhënie. Për më tepër që përbën antidodën e frikës vetë-mbrojtëse që lind brenda

* *Shënim, M. Nussbaum.* On the use of play and the arts by the Hindu right, see Nussbaum, *The Clash Within*.

vetes, e lidhur shpesh me projektionin egocentrik të kontrollit. Kur njerëzit mbajnë një qëndrim loje ndaj tjetrit, janë shumë të vogla gjasat – të paktën për kohën konkrete që po zhvillohet kjo marrëdhënie – për t'i gjykuar si kërcënime të dukshme për sigurinë e tyre dhe aq më tepër për t'i mbajtur nën kontroll.

Kultivimi i imagjinatës, në mënyrën dhe për synimet që kemi përshkruar deri më tani, është e lidhur ngushtësisht me aftësinë sokratike për t'i kritikuar traditat e papërshtatshme dhe përbën një mbështetje të rëndësishme për këtë aktivitet. Vështirë se dikush mund ta trajtojë pozicionin intelektual të një personi me respekt, sa kohë që, të paktën, nuk provon të kuptojë pikëpamjet e tij për jetën, po aq edhe përvojat që i kanë gjeneruar ato. Por kontributi i arteve për kritikën sokratike shkon edhe më tej. Sikundër theksonte shpesh Tagore, arti, duke gjeneruar kënaqësi, i bën spektatorët të përjetojnë akte subversioni ose kritika kulturore pa frikë dhe pa masa vetëmbrojtëse, edhe kur dialogët që zhvillohen janë të mbushur me paragjykime të së shkuarës. Kjo është ajo çfarë kupton Ellison kur e referon veprën tij, *Njeriu i padukshëm*, si “varkën e perceptimeve, shpresave dhe zbavitjes”. Zbavitja është shumë e rëndësishme për aftësinë e arteve për të ofruar perceptim të ri dhe shpresë. Nuk është thjesht përvoja e të qenit aktor në një shfaqje – gjithsesi, sikundër kemi theksuar më lart, edhe kjo tejet e rëndësishme për demokracinë – por është mënyra me të cilën aktori ofron një hapësirë ku eksplorohehen çështje të vështira, të cilat përjetohehen pa praninë e ankthit mbytës dhe frenues.

Në mënyrë të ngjashme, shfaqja e famshme me kërcim e Tagore, ku Amita Sen ka rolin e “Zanës së gjelbër”, është një pikë kthese për gratë, sepse jo vetëm është jashtëzakonisht argëtuese, por edhe artistikisht shumë e arrirë. Të njëjtët epitete mund të përdorim edhe për një dramë tjetër të Tagore, ku Amita ka rolin e mbretëreshës, vetëm se mund të shtojmë se është edhe shumë e guximshme. Në tekstin shoqërues, një nga fjalitë që duhet të thotë Amita, ndërsa kryen lëvizjet e famshme, është “Hajde në gjoksin tim”, i cili në variantin përfundimtar u zëvendësua me “Hajde në zemrën time” – por, sikundër më pohoi Amita, “Të gjithë e dinin çfarë duhej të thoja realisht”. Ky episod, që në një rast tjetër do ta kishte penguar kauzën e grave, e çoi edhe më përpara, sepse agjencia erotike e mbretëreshës, e kërcyer në mënyrë të mrekullueshme nga Anita, ishte mbresëlënëse. Në fund, audienca u pajtua plotësisht me mesazhet që transmetonte si muzika, ashtu edhe lëvizjet e bukura.

Deri më tani kemi trajtuar kryesisht imazhin e gjinisë dhe, ndoshta, nuk ka gjë më të rëndësishme për shëndetin e një demokracie se sa të kesh imazhe të shëndetshme për atë se si duhet të jetë një burrë i vërtetë dhe se si i ndërton marrëdhëniet ky burrë me të dyja gjinitë: me gratë, dhe edhe me vetë burrat. Perceptimi i mësipërm është konsideruar si i rëndësishëm së veçantë që në fillimet e kulturave moderne demokratike, në ato Perëndimore dhe jo-Perëndimore. Në Europë, filozofi Johann Gottfried Herder, që në vitin 1792, shkruan: “Qytetarët e mirë kanë nevojë të mësojnë, se të jesh burrë nuk do të thotë të manifestosh egërsinë e një luftëtari kundër kombeve të tjerë”. Duke aluduar, se me këtë nënkuptonte çfarë ishte e zakonshme në radhët e amerikanëve vendas, Herder shton se burrat e Europës, në mënyrë të ngjashme, duhet të veshin rrobat e grave, kur diskutojnë për luftën dhe paqen dhe se duhet të kultivojnë “respekt të reduktuar” për heronjtë e luftës dhe tmerrin që ngjall një “burrë shteti fals”, që fshikullon njerëzit për t’i bërë të etur për të pushtuar. Përkundrazi, edhe burrat, edhe gratë, në mënyrë të ngjashme, duhet të kultivojnë “predispozitën për paqe” – dhe një shërbim i mirë e i dobishëm për këtë kauzë do të ishte modeli i një femre.*

Ide të ngjashme janë propozuar e zhvilluar në Indi, si nga Tagore, ashtu edhe nga Gandhi. Shkolla e Tagore, përmes idiomës së kërcimit dhe rëndësisë që i kushton arteve, kultivon personalitetin e një mashkulli që di të respektojë dhe të luajë, që është i paiterësuar të dominojë të tjerët. Në mënyrë shumë të qartë, Tagore e lidh këtë synim me mospranimin që ka ndaj një lloji nacionalizmi kolonizues e agresiv që ai vë re në vlerat dhe normat kulturore europiane të burrërisë. Pak më vonë, Gandhi shoqëron qasjen e tij jo të dhunshme për ndryshim social, me heqjen dorë nga synimi për dominim në marrëdhëniet seksuale. Gandhi përpiqet të kultivojë personin androgjen dhe maternal – sigurisht, jo për t’u treguar ndjekësve të tij se duhet të heqim dorë krejtësisht nga dallimet tradicionale gjinore, por për t’i mësuar se mund të jesh burrë i vërtetë edhe pa qenë agresiv, se një numër i madh karakteristikash, që përbëjnë “modelin gjinor të burrit”, janë krejtësisht të pajtueshme me “burrërinë” sa kohë që theksojnë respektin për dinjitetin njerëzor të tjetrit dhe shfaqin dhembshuri për nevojat e tij.

* Johann Gottfried Herder, “Letters for the Advancement of Humanity” (1793–97), translated by Michael Forster, in Forster, ed., *Herder: Philosophical Writings* (Cambridge: Cambridge University Press, 2002), Letter 119, 404–409.

Me pak fjalë, fëmijët kanë nevojë të mësojnë se shfaqja e simpatisë nuk të zhburrëron, se “të jesh burrë” nuk do të thotë të mos qash, të mos tregosh se ke nevojë për diçka apo se të kanë dënuar e rrahur. Sigurisht që një imazh i tillë nuk mund të përvetësohet duke promovuar një qasje konfrontuese, që si moto të vetme ka “Të heqim dorë nga imazhet e vjetra të burrërisë”. Qasja që duhet të përqafojmë është ajo e krijimit të një kulture që është e hapur për të pranuar, si në përmbajtjen kurrikulare, ashtu edhe në stilin pedagogjik të të mësuarit. Dhe nuk është e ekzagjeruar të themi, se aftësitë për të dashur dhe për të qenë i dhimbsur duhet të jenë blloqet kryesore të të gjithë ngrehinës shkollore.

Në një perspektivë tjetër, ato që referon Dr. Nathanaili për të menduarin kritik, mund të thuhet edhe për artet. Edhe artet janë po aq të rëndësishme për realizimin e synimit për rritje ekonomike dhe krijimin e një kulture të shëndetshme në ekonomi. Studiuesit më të mirë të menaxhimit pohojnë, se aftësia e zhvilluar për të imagjinuar është një element i rëndësishëm për të pasur një kulturë të shëndetshme biznesi.* Risitë kërkojnë mendje që janë fleksibël, të hapura dhe kreative – letërsia dhe artet i kanë kapacitetet për t’i krijuar. Kur karakteristikat e mësipërme mungojnë, kultura e biznesit e humbet shumë shpejt entuziazmin dhe energjinë. Gjithnjë e më shumë, kompanitë preferojnë të punësojnë të rinj që janë diplomuar me një kurrikul të pasur në arte liberale, se sa ata që kanë ndjekur studime të ngushta profesionale, për më tepër kur kanë qenë në vijimësi që nga shkolla e mesme. Argumenti kryesor është, se për t’ia dalë në një mjedis dinamik biznesi, kërkohet fleksibilitet dhe kreativitet. Edhe nëse i vetmi shqetësim, për një ekonomi kombëtare, është rritja ekonomike, përsëri duhet t’i dalim në mbrojtje shkollimit që ka si bazë artet liberale. Për fat të keq, pothuaj në të gjithë botën, artet liberale po lihen gjithnjë e më shumë jashtë përmbajtjes kurrikulare.

Në këtë pikë, një rast studimor do të ndihmonte edhe më shumë argumentin, si dhe na mundëson të kuptojmë edhe më mirë, se sa të rëndësishme janë artet për edukimin e karakteristikave të ndryshme të qytetarit demokratik, aq më tepër në një kulturë amerikane të ndarë nga etnia dhe klasa sociale. Rasti studimor që po sjell në vëmendje të lexuesit është “Kori i fëmijëve të Çikagos”. Çikago, njësoj si pjesa më e madhe e qyteteve amerikane, karakterizohet nga pabarazi të jashtëzakonshme

* *Shënim, M. Nussbaum.* Për më shumë, shih: Arguments and references in the LEAP Report, *College Learning for the New Global Century*.

ekonomike, të cilat përkthehen në diferenca të përmasave edhe më të mëdha në mundësimi punësimi, të drejtën për të pasur një shtëpi apo edhe cilësi në shkollim. Problematike janë veçanërisht lagjet afrikano-amerikane dhe ato latine. Për fëmijët e këtyre zonave, as edhe me përafërsi nuk mund të themi se marrin një shkollim të njëjtë me fëmijët e lagjeve të bardha të qendrës ose ata që ndjekin shkolla private. Përveç disavantazheve që mund të kenë në shtëpi – jetojnë me një prind ose edhe pa prindër fare – ju mungojnë edhe “rolet model”: nuk kanë pranë asnjë njeri që mund të quhet “i suksesshëm në profesion” ose “ka bërë karrierë”, që të jetë i disiplinuar ose me aspirata për të ardhmen, apo edhe dikë të angazhuar në politikë. Me ligj, shkollat nuk janë të ndara në bazë të ngjyrës së lëkurës, por “de facto” gjasat janë zero që të kenë ndonjë shok që i përket ndonjë race apo klase të ndryshme nga ajo e tij.

Për ta bërë situatën edhe më të zezë, artet, të cilat mund t’i vënë fëmijët bashkë pa pasur në mes shkallën hierarkike, janë hequr fare nga kurrikula e shkollave publike, si pjesë e masave për kursim. Dhe në këtë zbrazëti, dikush hyn në skenë: “Kori i fëmijëve të Çikagos”, një organizatë e mbështetur financiarisht nga një filantrop privat, që aktualisht përbëhet nga afro 3000 fëmijë, nga të cilët më shumë se 80% jetojnë nën nivelin e varfërisë. Në repertor përfaqësojnë këngë korale, që interpretohen me standarde të shkëlqyera performimi.

Programi ka tre struktura. E para, janë “programet-në-shkollat”, shumë prej të cilëve kanë zëvendësuar programet që organizonte qyteti, por që u mbyllën për mungesë fondesh, ku marrin pjesë më shumë se 250 fëmijë, organizuar në afro 60 kore nga 50 shkolla të arsimit të mesëm të ulët (fokusuar, kryesisht, nga klasa e tretë deri në klasën e tetë). “Programet-në-shkolla”, sikundër e përshkruajnë vetë organizmat shtetërorë, “përforcojnë idenë se muzika është po aq e rëndësishme, sa edhe matematika dhe shkencat në përgjithësi, për zhvillimin e mendjes dhe të shpirtit të fëmijëve”. Struktura e dytë përfshin koret e lagjeve, përbërë nga 8 kore nga rajone të ndryshme të Çikagos. Këto janë programe që zhvillohen pas ditës së shkollës, pjesëmarrja është me audicione dhe kërkon një nivel të caktuar angazhimi; fëmijët që marrin pjesë janë të moshës nga 8-16 vjeç. Në këtë strukturë, parashikohen disa shfaqje në vit, brenda dhe jashtë qytetit të Çikagos. Për të zhvilluar aftësitë e tyre muzikore, fëmijët mësojnë të këndojnë lloje të ndryshme muzike, nga vende të ndryshme të botës.

Struktura e tretë është e një niveli më të përparuar dhe njihet si “Kori i koncerteve”. Në të përfshihen, ndoshta, të rinjtë më të talentuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Koncertet jepen në nivel kombëtar e ndërkombëtar dhe shoqërohen, zakonisht, nga orkestra simfonike ose operistike; kori ka hedhur në qarkullim disa regjistrime. Në repertorin e tyre përfshihen që nga koralet e Bah dhe deri te këngë afrikano-amerikane (gjithnjë në kushtin që duhet ta kenë origjinën nga kultura të vendeve të ndryshme të botës).

Programi i ka fillesat në vitin 1956. Ideuesi është Christopher Moore, pjesë e kishës Unitariane. Moore besonte se mund të ndryshonte jetën e të rinjve nëpërmjet muzikës, duke vënë bashkë raca, besime dhe klasa të ndryshme ekonomike. Nga 24 pjesëmarrës që kishte në fillim, ditët e sotme kori ka marrë përmasat e mësipërme. Aktivitetet mbështeten financiarisht nga shumë sipërmarrës të rajonit të Çikagos. Duhet përmendur edhe mbështetja që i jep qyteti, jo vetëm duke i inkurajuar dhe promovuar, por edhe duke iu ofruar sallat falas, gjë që e bën mbështetjen edhe më solide.

Sigurisht që është e thjeshtë të përshkruhen faktet e mësipërme. Vështirësia qëndron në përshkrimin e ndikimit emocional kur dëgjon këta të rinj, të cilët nuk këndojnë si fëmijët e koreve të kishës që jemi mësuar të dëgjojmë një herë e një kohë – statikë, ndërkohë që muzika ka thjesht rolin e shoqëruesit. Fëmijët memorizojnë çdo gjë që këndojnë dhe këndojë çdo notë e tekst në mënyrë shumë shprehëse, shpesh edhe me ndihmën e gjesturave apo të lëvizjeve (kërcim), për ta përcjellë këngën sa më shumë emocionalisht. Por përsëri nuk kemi mbaruar... Gjatë aktit të të kënduarit, fytyrat e fëmijëve shprehin një gëzim të jashtëzakonshëm. Dhe pikërisht ky është edhe një nga synimet e programit: të kultivojë emocione, tek të dy grupet, këngëtarë dhe spektatorë.

Më ka rënë rasti të ndjek provat dhe aktivitete të ndryshme të korit të lagjes “Hyde Park”, si dhe disa koncerte publike të “Korit të koncerteve” dhe gjithnjë më kanë shoqëruar të njëjtat ndjenja: krenari pafund, frymëzim dhe angazhim tejet profesional nga secili prej fëmijëve. Programi parashikon që pjesëmarrësit e “Korit të koncerteve” të marrin rolin e kujdestarëve për fëmijët më të rinj dhe me më pak përvojë, duke u ofruar me shembullin e tyre modele disipline dhe frymëzimi, apo edhe duke i ndihmuar të ndërgjegjësohen për përgjegjshmërinë që kanë ndaj shoqërisë. Disa vite më parë kam intervistuar Mollie Stone, dirigjente e korit të lagjes “Hyde Park” dhe një nga dirigjentet e “Korit të koncerteve”. Një nga pyetjet që i drejtova

ishte: “Në çfarë mënyre kori kontribuon në jetën e Çikagos?” Por nuk u mjaftua me një përgjigje të vetme: “E kam të vështirë t’i përmbledh të gjitha në një” – filloi Stone, me shumë elokuencë dhe mallëngjim.

Rrëfimi i Stone

Fillimisht, kori u jep fëmijëve mundësinë për të pasur një përvojë të pasur, krah për krah me fëmijë që vijnë nga sfone me raca dhe klasa të ndryshme sociale. Përvoja e të kënduarit me një tjetër përmban një lloj vulnerabiliteti – trupi dhe frymëmarrja nuk është më personale – përzihet me atë të personit që ke në krah dhe, po ashtu, edhe lëvizjet e trupit dhe ritmi i frymëmarrjes duhet të jenë sinkron. Zëri duhet të dalë nga brenda trupit, një karakteristikë që nuk e arrin dot as edhe orkestra. Përvoja muzikore i mëson fëmijët të duan trupin e tyre, për më tepër në një moshë që në përgjithësi fillojnë ta urrejnë dhe të mos ndihen të qetë me çfarë kanë, ndërkohë që zhvillojnë ndjenjën e të qenit i aftë për diçka, të jenë të disiplinuar dhe të përgjegjshëm.

Duke qenë se në repertor përfshihet muzikë nga kultura të ndryshme, mësojnë rreth vendeve të tjera, arrijnë të kapërcejnë shumë nga pengesat që vendosen përgjithësisht në rrugën e njohjes me “tjetrin”, ndërkohë që ideja e të qenit “qytetar i botës” tashmë bëhet e prekshme, konkrete, reale. Duke shpenzuar kohë dhe investuar vullnet e seriozitet për të mësuar të këndojnë muzikën e një vendi tjetër, për më tepër e zhvendosur në hapësirë dhe kohë, kuptojnë sa i rëndësishëm është respekti. Të gjitha bashkë, kontribuojnë të mësojnë për rolin që kanë në komunitet, në atë lokal dhe në botë, si dhe i nxisin fëmijët të jenë edhe më shumë kureshtarë. Jo rrallë na ndodh që krahas muzikës së një vendi, të analizojmë të gjithë bashkë edhe shkencën, historinë, gjuhën e artin viziv të tij – hallkë pas hallke, të gjitha bashkë dhe secila një nga një.

Stone, vijimi i rrëfimit në formën e tre historive / Historia e parë

Një ditë, ndërsa isha drejtuar për në sallën e provave të “Korit të koncerteve”, shoh disa fëmijë afrikano-amerikanë që po këndonin një pasazh kompleks nga një korale e Bahut. “Sot nuk është dita juaj për të qenë këtu. Po bëni prova shtesë?” - iu drejtova fëmijëve. “Jo” – ishte përgjigja e tyre. “Thjesht po kalojmë kohën. Na pëlqen të mblidhemi këtu, sepse ndihemi të qetë!” Fakti që këta fëmijë afrikano-amerikanë që

vinin nga shkollat-geto të periferisë e ndjenin të natyrshme, se një mënyrë e mirë “për të kaluar kohën” me njëri-tjetrin dhe për të pasur pak qetësi ishte duke kënduar Bahun, më tregoi se nuk ndiheshin të izoluar nga “kultura e zezë” e tyre. Ata kishin fituar aftësinë “të përvetësonin” çdo lloj kulture dhe të ndiheshin anëtarë me të drejta të plota të saj: Bahu ishte i tyre, po aq sa edhe muzika afrikano-amerikane.

Historia e dytë

Dua të sjell një përvojë personale. Kur isha e vogël, këndoja në një kor, ku pjesa më e madhe ishin fëmijë afrikano-amerikanë. Rastisi që në repertor futën një këngë populllore hebraike. Duke qenë e vetmja me origjinë hebraike në kor, papritmas më pushtoi ndjesia e përfshirjes. Vura re që fëmijët e tjerë filluan të tregojnë më shumë respekt për mua dhe për kulturën time, dëshironin të studionin dhe të dinin sa më shumë, të ishin pjesë e saj.

Historia e tretë

Pak kohë më parë, kori i lagjes “Hyde Park” gjendej për një koncert të planifikuar në Nashville, Tennessee, vendi i muzikës *kantri*, vendi ku kultura dhe vlerat janë pak a shumë të huaja për pjesën më të madhe të shteteve të veriut, kryesisht për amerikanët e qyteteve – për të cilët, edhe banorët e Nashville mendojnë po njësoj, u duken po aq të çuditshëm. Në një shëtitje nëpër qytet, një grup artistik po jepte shfaqje pranë “Grand Ole Opry”. Fëmijët e njohën menjëherë këngën - e kishin pjesë të repertorit të tyre. Iu afruan grupit dhe filluan të këndojnë të gjithë bashkë. Rezultati? Një manifestim i mrekullueshëm i përfshirjes dhe respektit të ndërsjellë! Një ngjarje e tillë na përforcoi edhe më shumë bindjen (jo të panjohur) për rolin që luajnë artet në promovimin e përfshirjes dhe respektit, si karakteristika të qytetarit në një vend demokratik. Tradita amerikane në këtë fushë shtrihet kohë më parë, përmendur edhe në këtë studim (nga Alcott deri te Dewey), përfaqësuar kryesisht me rrymën progresiviste.

Sa më sipër, kam theksuar kontributin e korit për të gjithë pjesëmarrësit. Mendoj se është e panevojshme të themi, se ky kontribut shumëfishohet disa herë, sa kohë që efektet e tij shtrihen edhe te prindërit dhe familjet e fëmijëve, në shkollë dhe në audiencë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

dhe më gjerë, në botë - mund t'i gjeni edhe në YouTube, me emrin “Chicago Children’s Choir”.

Për fat të keq, sipërmarrje të tilla nuk favorizohen nga sistemi shkollor i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, as në nivel lokal dhe as në atë kombëtar. Në rrjedhojë, kori gjithnjë ka nevojë për mbështetje financiare dhe vijimësia e aktiviteteve të tij mundësohet vetëm nga fondet që ofrojnë vazhdimisht njerëz dhe organizata të ndryshme private, për të shtuar këtu edhe investimet në kohë që bëjnë shumë nga organizatorët. Çikago është një qytet me fat që ka kaq shumë nisma private dhurimi, falë të cilave bëhet e mundur krijimi i programeve të ndryshëm artistikë për shkollat nga organizata që punojnë në këtë fushë – shpesh aktivitete të tilla artistike ofrohen falas për publikun dhe në këtë rast duhet të jemi mirënjohës për partneritetet priva-publik që mundësojnë ngjarje të tilla.

Dhe meqenëse kemi folur për paratë, le të përballemi edhe me këtë çështje. Thuhet se arti është i kushtueshëm. Ndryshe, të bësh art duhen para! Shpesh është e pamundur përballimi i kostove, veçanërisht në rastet kur ekonomia është në vështirësi. Por promovimi i artit nuk është i shtrenjtë! Nëse do të ndihmonim, sikur edhe vetëm me dhënien falas të mjediseve të ndryshëm, atëherë shpenzimet për artin zvogëlohen relativisht shumë – sepse fëmijët duan të këndojnë dhe të kërcëjnë, të tregojnë dhe lexojnë histori. Nga ana tjetër, nëse mendojmë për artin, në të njëjtën mënyrë që Dewey e kritikonte – si “arti i bukur” dhe me finesë, që kërkon pajisje dhe objekte të shtrenjta për t’u shfaqur dhe vlerësuar – atëherë është e lehtë të mbërrish në konkluzionin se në një kohë që kostot janë kryefjala e çdo nisme, paratë nuk dalin edhe për të! E kam dëgjuar nga disa përfaqësues të sistemit shkollor në Çikago, por nuk e pranoj! Kam vizituar disa nga zonat rurale të Indisë, për të ndjekur një projekt kundër analfabetizmit për gratë dhe vajzat. Asnjë pajisje! Të gjitha mungonin! As dërrasa të zeza dhe shkumësa, as lapsa dhe fletore! Vetëm një pllakë argjile për të shkruar që kalonte dorë më dorë. Por arti lulëzonte! Vajza të reja, që sapo kishin mësuar të shkruanin dhe të lexonin, ishin në gjendje të shpreheshin shumë mirë, shumë më mirë se sa kisha parë në qytete të ndryshme të Amerikës, vetëm sepse përvojat e tyre i tregonin me ndihmën e një pjesë të vogël teatrale, një poezie, një kënge që kishin krijuar apo një vizatimi që kishin bërë. Synimet ishin të qarta! Dhe frika për atë çfarë ishin e përfaqësonin reduktuar në zero! Mësues të përkushtuar, në rolin e aktivistëve vullnetarë, ishin të qartë për artet dhe mënyrat që gjen kjo fushë për të vajtur të fëmijët, për t’i bërë të etur për të mësuar e ndjekur shkollën, për të dashuruar

leximin dhe shkrimin, për të qenë të aftë të mendojnë në mënyrë kritike për jetën dhe situatat me të cilat të sfidon.

Në një nga këto vizita, më pyetën nëse dëshiroja t'u mësoja një këngë nga vendi im dhe unë zgjodha “We Shall Overcome”. E dinin! Më pas e përsërita si eksperiment, kur lëvizja si vullnetare, në të gjitha zonat dhe me shumë nga gjuhët e dialektet që fliten në Indi dhe përsëri e njëjta përgjigje: e dimël! Muzika dhe kërcimi, vizatimi dhe teatri janë burime gëzime dhe mënyra shprehje për të gjithë dhe nuk kërkojnë shumë parë për t'i nxitur apo mirëpritur. Në të vërtetë, duhet të përbëjnë shtyllën kurrikore të kurrikulës në programet kundër analfabetizmit në zonat rurale, sepse i nxisin fëmijë dhe të rritur të motivohen për të vajtur në shkollë, i ndihmojnë të gjejnë mënyra pozitive për t'u lidhur me njëri-tjetrin dhe për t'ju gëzuar çdo përpjekje për shkollim.

Pse të mos i përdorim artet në këtë formë edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Pak kohë më parë më ftuan për të dhënë mendime në lidhje me zbatimin e një projekti që merrej me adoleshentë me probleme në “Alternativa Morton”, një shkollë e mesme publike në Cicero, një qytet pranë Çikagos: adoleshentë që ishin përjashtuar nga shkolla të tjera dhe mund të ndiqnin vetëm “Alternativën Morton” – sigurisht, nëse mund të ndiqnin ende një shkollë të mesme (në varësi të moshës, sepse shumë prej tyre ishin mbi 16 vjeç). Shkolla kishte vetëm 40 nxënës. Në rrjedhojë, fokusimi nga nxënësi në nxënës, në mënyrë krejtësisht individuale, ishte plotësisht i mundur. Falë drejtuesit të shkollës, tejet i përkushtuar dhe jashtëzakonisht i mprehtë, për secilin nxënës njëri prej krejt historia e tij – kur fliste, një çast krijova përshtypjen se fliste për fëmijët e tij, aq mirë i dinte përpjekjet dhe dështimet e secilit. Shkolla kishte mundur të bashkërendonte punën me një organizatë vullnetare punonjësish sociale dhe psiko-terapistë, kështu që të gjithë fëmijët merrnin mbështetjen e duhur, ndërsa terapistë në grup organizoheshin me jo më shumë se 4-5 fëmijë.

Më bëri shumë përshtypje ndryshimi që vihej re dhe kjo vetëm sepse disa “të rritur” kishin ditur të lexonin çfarë shkruhet në literaturë për raste të tilla. Por shkolla ishte pranë me mjedisin familjar të një shkolle tjetër, me shkollën “Plumtree” të Alcott dhe gjasat ishin që kur adoleshentët tanë ktheheshin për në shtëpi, shpesh përfundonin në pikën e nisjes: harronin disiplinën e respektin dhe jo rrallë ishin edhe të dhunshëm. Si i keni punët me artet? – i pyeta. Drejtori dhe përgjegjësi për terapistë më panë të habitur. Nuk e kishin menduar si diçka që do mund t'i ndihmonte. Por pse jo? –

ishte pergjigja. rjesa me e maune e adoieshentëve të shkollës ishin meksikano-amerikanë, që do të thotë se vinin nga një kulturë jashtëzakonisht e pasur me tradita muzikore dhe kërcim. Me ndihmën e muzikës dhe të kërcimit, dhe sigurisht edhe të teatrit, mund të gjendeshin mënyra shumë të mira për të shprehur jo vetëm ëndrrat, por edhe pengesat që mund të kishin në realizimin e tyre. Në fakt, terapia në grup është një lloj teatri, por nuk përmban atë nivel disipline që kërkohet në realizimin e një shfaqje. Nga ana tjetër, mungonin arsyet ekonomike që do mund të ndalonin përdorimin e arteve. Thjesht nuk e kishin menduar! Shkolla “Alternativa Morton” vendosi të përfshijë artet në kurrikul. Katër javë më vonë, përgjegjësi për terapitë më dërgon një poemë, që e kishte krijuar njëra nga vajzat që kisha vëzhguar në një sesion terapie. Vargjet ishin jashtëzakonisht të fuqishëm – përjashtuar, sigurisht, dilemat e pasiguritë – sepse mamaja adoleshente, që i ishte dashur të bënte luftërat e saj në atë rol, shprehte dashurinë në rritje për foshnjën e saj. Për mua, poema përfaqësonte një fazë të re në rrugën e progresit të saj - atë drejt rifitimit, edhe një herë, të krenarisë së humbur, si dhe vetë-plotësimit. Edhe përgjegjësi për terapitë e përkrahu konkluzionin tim – ishte shumë i logjikshëm! Dhe gjithçka me asnjë qindarkë më shumë!

Shkollimi që unë rekomandoj kërkon që mësuesit t’i bëjnë gjërat ndryshe. Zbatimi kërkon ndryshime të mëdha në mënyrat e mësimitdhënies, të paktën në pjesën më të madhe të distrikteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të vendeve të botës. Akoma, kërkohet që pjesa më e madhe e drejtorëve të shkollave (sigurisht, jo në rastin e drejtorit të shkollës “Alternativa Morton”) të ndryshojnë karakterin e shkollave që drejtojnë. Në këtë pikëpamje, ky lloj edukimi kushton. Por mendoj që kostot janë vetëm tranzitore. Në vijim, asgjë nuk është më e shtrenjtë. Dhe me t’u vendosur këto norma të reja, proceset ndjekin vetveten. Mund të shtoj, se lloji i edukimit që i bën mësues e nxënës të përfshihen më me pasion në procese, që venë në lëvizje të menduarit dhe imagjinatën redukton kostot, si dhe humbjen e kohës që do të kemi në të ardhmen, sepse po investojmë në burime njerëzore sot. Dhe, sigurisht, do të kemi më pak njerëz të papërgjegjshëm!

Pjesa II

Edukimi liberal dhe teatri / Edukimi liberal si praktikë

Valbona Nathanaili dhe Steve Fuller

Teatri dhe edukimi

Valbona Nathanaili

Në periudhën 1939-1941, që korrespondon me kohën kur Shqipëria ka qenë nën pushtimin italian, Ministër Arsimit ka qenë Ernest Koliqi, një nga mendjet më të shquara të këtij vendi në fushën e kulturës dhe krijimtarisë, njëherazi shumë i diskutuar për arsyet që e kanë shtyrë të pranojë bashkëpunimin me pushtuesit e vendit. Por synimi ynë është të ndalemi në atë dimension të veprimtarisë së tij që e bën me nder dhe për të cilën e respektojmë, krijimtarinë dhe pasionin për kulturën, të cilat nuk i kanë munguar edhe kur ka qenë në postin e ministrit. Në kulmin e veprimtarisë si Ministër i Arsimit, u dërgon të gjitha shkollave një qarkore, nëpërmjet së cilës u kërkon mësuesve të përfshihen në mbledhjen e folklorit në zonat ku japin mësim. Nga 22 pyetje që përmbante qarkorja, mësuesit duhet të zgjidhnin 2-3 “për t’i studiuar e shtjelluar me kujdesin më të madh, peshuem dhe matur mirë, pa shtuar ndonji gjë nga fantazija, dhe pa lënë të metë gjëkafshë për çdo arsye qoftë”, – porosiste Koliqi. Disa nga pyetjet për të cilat mund të mblidhnin të dhëna janë:

- Dëfteni një për një zakonet e lindjes, pagëzimit, synetit, fejesës e vlesës, martesës e vdekjes (të tretat, të shtatat, të nëntat, të dyzetat). Tregoni çfarë urimesh e çfarë thuhet me rastin e këtyre ngjarjeve!
- Si e parashikojnë bujqit ardhjen e kohës së mirë ose të keqe, si shiun, breshrin, borën, dimrin e rreptë ose të butë, vapën e madhe etj.? Për shembull, kur këndon gjelin në një çast të caktuar, kur piquet ndonjë pemë etj.?
- Çfarë zakonesh e çfarë besimesh mund të ketë në katund (a në qytet), që bien fort në sy? Për shembull, dita e djegies së rrogozave në Berat, dita e flakadanit, dita e rusicave (kur dikush vishet me gjethe e gjelbërime dhe i derdhnin ujë) etj.

Pyetjet e qarkores së Koliqit kërkojnë të evidentojnë atë pjesë të kulturës që njihet si “Kultura e përfaqësimit”, kultura që përbëhet nga besime, norma e vlera kolektive, legjenda e simbole popullore, piktura dhe

ikona, ligje e kode kanunore, pra është kultura që përfaqësohet nga një bashkësi faktesh sociale, materiale ose jo-materiale që përbëjnë një detyrim moral, një marrëveshje sociale, unike për një vend dhe kohë të caktuar. Lajmi i keq është që kjo pjesë e kulturës jo vetëm nuk përfaqëson individin, por del edhe jashtë sferës së ndërveprimit individ-individ, ndërsa lajmi i mirë është që mund të studiohet dhe analizohet dhe, në terma afatgjatë, edhe të ndryshojë, por kërkon shumë mekanizma.

Grupet që merren me studime të kësaj natyre janë nga fusha të ndryshme të dijes dhe, ndonëse secili ka këndin e vet të gjykimit dhe vështrimit, të gjithë bashkohen në një pikë: teatri luan një rol të rëndësishëm dhe është një nga mekanizmat që përshpejton ndryshimin. Thënë ndryshe, teatri është mjedisi në të cilin kultura e përfaqësimit, në rrjedhje të misionit e funksionit të tij, përthyeret, njësoj me atë që ndodh me dritën gjatë kalimit nga një mjedis në një mjedis tjetër me koeficient të ndryshëm përthyerje. Pra, teatri përthyen, sepse mjedisi i tij ka koeficient tjetër nga ai i realitetit.

Dukuria e përthyerjes së Teatrit është e lidhur me dy faktorë: mënyrën si funksionojmë ne, si qenie sociale, dhe teatrin si agjenci. Ne si qenie sociale, në të gjitha shoqëritë dhe në të gjitha kohërat, kemi jetuar të ndarë në grupe sociale, ku gjithmonë grupe të caktuara janë lënë mënjanë, janë stigmatizuar dhe kanë qenë në pozita inferiore me të tjerët, për shembull gratë ndaj burrave, vajzat ndaj djemve, romët ndaj gaxhive, të varfrit ndaj të pasurve, të zinjët ndaj të bardhëve etj. Pra sfondi social ose paragjykimet që kemi, me ose pa dashje, ndikojnë mënyrën tonë të të arsyetuarit rreth përkatësisë në grup, pavarësisht nëse jetojmë në qytet a në fshat, jemi të rinj a të vjetër. Gjykimi ynë për një grup të caktuar influencohet shumë nga faktorët e mësipërm. Ajo që perceptojmë varet nga pozicioni ku jemi dhe nga ajo që shpresojmë ose jemi të bindur se do të shohim. Thënë këto, ne përbëjmë realitetin dhe materializohemi në pjesën teatrore.

Pra pjesa teatrore, pavarësisht faktit se është vënë në skenë në gjallje të autorit a pas vdekjes së tij, ose pavarësisht kohës që autori vendos në sfond të zhvillimit të ngjarjeve, na informon për kohën në të cilën është krijuar vepra, për kulturën e asaj kohe. Mënyra e ndërtimit dhe e rrjedhës së ngjarjeve, gjuha e përdorur, veshja, simbolikat, arkitektura e skenës janë, të gjitha bashkë, një lloj prerje e këtij realiteti social e kulturor!

Nga ana tjetër, sa më mirë teatri vepron si agjenci, rol të cilin, duhet ta marrë edhe në shkollë, aq më e madhe bëhet vlera e këtij koeficienti. Thënë këtë, na duhet kapital njerëzor i kualifikuar. Objektivi i zgjedhjes së shfaqjeve - mundësisht të shijeve nga më të ndryshmet - duhet të jetë orientimi ndaj mjedisit përreth, por gjithnjë në synimin për të luftuar ato mënyra të menduarit që janë të dëmshme për shoqërinë.

Ndërkohë, misioni i teatrit është të tregojë, ndërsa thelbi i agjencisë së tij është paraqitja e një konflikti, konkretisht konfliktit ndërmjet individëve dhe rrethanave ku gjenden. Sepse teatri kërkon gjithnjë më shumë se çfarë ofron mjedisi, sepse teatri mban qëndrim, reflekton, hap perspektiva të reja, bind. "Teatri gjeneron kënaqësi, i bën spektatorët të përjetojnë akte subversioni ose kritika kulturore pa frikë dhe pa masa vetëmbrojtëse, edhe kur dialogët që zhvillohen janë të mbushur me paragjykime të së shkuarës" – pohon Martha Nussbaum dhe vazhdon: "Teatri na ndihmon të dëgjojmë me vëmendje dhe inteligjencë historinë e tjetrit, të kuptojmë emocionet e dëshirat që ka ose që ëndërron, ta shohim me simpati, të bëhemi tjetri vetë". Pra, teatri, nëpërmjet agjencisë së tij, vë në lëvizje të menduarin ndryshe, nga këndvështrime të tjera, na ndihmon të kuptojmë sa e vështirë dhe diskriminuese është jeta e personave që u përkasin këtyre grupeve. Dhe të reflektojmë!

Në këtë kuadër, teatri luan rol që kultura e përfaqësimit, sado komplekse, statike dhe e rëndë që të duket, t'i nënshtrohet filtrave e gjykimeve të reja, besimet të rimerren në analizë, ndërsa stereotipet të vihen në pikëpyetje. Teatri shndërrohet në laboratorin e analizës së kulturës së përfaqësimit: çfarë na duhet dhe çfarë jo! Teatri shndërrohet në hapësirën për eksplorimin e çështjeve të vështira pa u zhytur në ankth!

Në vijim, në përpjekjen për të qenë sa më konkretë, kemi zgjedhur dy pjesë, përkatësisht nga Steve Fuller dhe Valbona Nathanaili. Secila është shkruar për dy grup-mosha të ndryshme dhe gjithnjë në funksion të qasjes së mësipërme: teatri si agjenci që trajton një problem të caktuar dhe e analizon në një këndvështrim të ri.

"LINKOLN dhe DARVIN, në një bashkëbisedim, vetëm për një natë" nga Steve Fuller, shkruar për teatër dhe vënë në skenë, më 10 mars 2009, në departamentin e shkencave të Universiteti i Oxford-it, Oxford, është e para në radhë dhe është shkruar kryesisht për të rinjtë që ndjekin studimet universitare.

“Rrëfenjat e disa portokalleve që mund të fluturojnë”, nga Valbona Nathanaili, shkruar për teatër dhe vënë në skenë në verën e vitit 2019, në Teatrin e Metropolit, Tiranë, bazuar në përrallën “Portokalli fluturues rrëfen historitë e tij” të Johan dhe Andreas Galtung është shkruar për fëmijë të shkollave 9-vjeçare. “Portokalli fluturues rrëfen historitë e tij” është një nga librat e paktë për fëmijë në gjuhën shqipe që trajton tema nga jeta e përditshme me një qasje të re, pa Princesha dhe Hirushe që e gjejnë fundin e lumtur te zgjidhja magjike. Fabula e rrëfenjës së Galtung-ëve (at e bir) është një portokall i vogël që ka aftësinë të fluturojë nga një vend në tjetrin dhe t’u tregojë miqve të tij fëmijë se çfarë ka parë dhe, akoma më shumë, t’i mësojë të ndajnë ndërmjet tyre sa herë kanë një konflikt, ose sa herë dy palë duan të njëjtën gjë: të njëjtin portokall, të njëjtën tokë, të njëjtin det. Për Johan Galtung, zgjidhja e konfliktit nuk është kompromisi, sepse kompromisi është i përkohshëm, i kënaq palët vetëm për momentin. “Ne duhet të gjejmë një zgjidhje që i kënaq të dyja palët, që i lumturon njësoj, që i bën të shohin para” – thekson Galtung. Në bazë të pjesës teatrore të V. Nathanailit janë tre rrëfenja, ku secila përmban një konflikt, të ndryshme nga ato të origjinalit, por shtjellimi ka në bosht filozofinë Galtung: propozimet për zgjidhjen e konflikteve janë kreative, në kërkim të së pamundurës, me humor, përtej interesave të çastit, afatgjata dhe në gjendje t’i rezistojnë kohës.

LINKOLN dhe DARVIN

Në një bashkëbisedim, vetëm për një natë

Steve Fuller

(shkruar për teatër; vënë në skenë, më 10 mars 2009)

Departamenti i Shkencave, Universiteti i Oxford-it

Shqip dhe përshtatur për lexuesin shqiptar, Valbona Nathanaili

Personazhet:

SHEILA - *Perky talk show host - Rachel Armstrong*

XHEKI - *Mbështetësja e saj sarkastike - Zoe Walshe*

ABE - *Abraham Linkoln - Steve Fuller*

ÇARLS - *Çarls Darwin - Andrew Nichol*

Skena: Në skenë, në qendër, janë tre karrige. Sheila, pasi thotë pjesën e saj të hapjes, ulet në karrigen e mesit. ABE dhe ÇARLS kur të ulen, zënë, përkatësisht, dy karriget e anës, në të dy krahët e saj. XHEKI qëndron gjatë gjithë kohës në skenë - nuk ulet asnjëherë - dhe del në qendër vetëm kur ka radhën për të thënë pjesën e saj.

SHEILA: Mirëmbërëma, Oxford! Unë jam Sheila, moderatorja e këtij episodi. **[XHEKI krijon një pauzë të shkurtër, për duartrokitjet e sallës]** Kjo është një shfaqje, ku ne përpiqemi të sjellim mes nesh, edhe një herë, të dashurit tanë që kanë ndërruar jetë kohë më parë, për të vlerësuar se

çfarë ka ndodhur ndërsa nuk kanë qenë këtu – si dhe çfarë do të bënin a si do të silleshin në rrethanat e reja. Dhe sikundër janë në dijeni spektatorët tanë të nderuar, në fund ne i pyesim “të ringjallurit” tanë, nëse do të dëshironin të qëndronin apo të iknin nga kjo botë – gjithsesi, sikundër mund ta keni kuptuar, nuk kemi lirinë ta zbulojmë destinacionin e tyre përfundimtar... Por mbrëmja e sotme është shumë e veçantë, sepse kemi sjellë mes nesh dy figura, që kujtohen me shumë dashamirësi jo vetëm nga miqtë dhe familjarët e tyre. Zonja dhe zotërinj, Çarls Darvin dhe Abraham Linkoln, lindur saktësisht në të njëjtën ditë, afro 200 vjet më parë: më 12 shkurt 1809! Ju lutem, një duartrokitje të ngrohtë për Çarls dhe Abel!

[XHEKI fton ABE dhe ÇARLS të futen në skenë, në mënyrë jozyrtare, pa ndonjë ceremoni, si dhe të ulen pranë saj]

SHEILA: Vë bast, që po pyesni veten, se çfarë duan këtu dy njerëz që i përkasin shekullit të 19-të!

[ÇARLS dhe ABE fillojnë të flasin me njëri-tjetrin, duke e injoruar tërësisht SHEILAN]

ÇARLS: Mos jemi gjë në një shekull tjetër?

ABE: Nuk do të çuditesha! Njerëzit duket të ekspozojnë më shumë pjesë të trupit, ndërsa ndërtesat janë shumë ... – si ta shpreh? – shumë të mbyllura!

ÇARLS: Dakord! Tavanet janë më të ulët, ndërsa dritaret duket se janë projektuar për të lënë jashtë sa më shumë natyrë. Shpresoj, të paktën, të kenë ventilimin e duhur!

ABE. Ndoshta kjo është arsyeja pse veshin më pak rroba: nuk duan t’u merret fryma!

ÇARLS: Do të shtoja që këto hapësira të mbyllura të paktën të ishin mobiluar mirë... Praktikisht, duket se çdokush mund të banojë aty brenda! Ndihet një mungesë personaliteti.

ABE: Në përgjithësi jam mësuar të jem i kursyer me mjedisin përreth, por këto hapësira të brendshme... duket sikur janë bërë me një synim të caktuar... të kujtojnë ose spitalin, ose burgun. Hapësira që nuk kanë as edhe ndonjë cep bosh!

SHEILA [e ndërpret]: Kam frikë se pyetjes “si është jeta në fillimet e shekullit të 21-të” do t’i përgjigjeshit: njerëz gjysmë të zhveshur që lëvizin në hapësira të stërmbushura, me të cilat duken se nuk kanë asnjë lidhje!

ÇARLS: [drejton gishtin nga audienca] Dhe pa pasur frikën e etiketimit si i paedukatë, a mund të pyes se kush janë këta njerëz?

SHEILA: Ata? Kjo është audienca! Janë mbledhur për të dëgjuar se çfarë keni për të thënë.

ABE: Mos prisni nga ne që të mbajmë fjalime? Në është kështu, më vjen keq, por nuk kam një tekst për një rast të tillë.

ÇARLS: Jo, mendoj se rasti nuk është për fjalim. Dhe as për ndonjë prezantim formal. Më shumë duket sikur janë mbledhur për të dëgjuar ndonjë koncert muzikor! Apo recital!

SHEILA: Më duket se duhet ndërhyrja ime. Kjo quhet “bisedë në studio”. Ngjan pak me recitalin, në kuptimin që secili nga ju ka radhën për të folur, për të shprehur mendimin e tij në lidhje me pyetjet që bëhen. Ndërsa unë jam drejtuesja e bisedës. Synimi është të argëtojmë audiencën.

ABE: Argëtojmë?

ÇARLS: Për audiencën tuaj moderne, kam përshtypjen se dukemi si një dyshe burrash, që i përkasin ndonjë fisi qëmoti, ardhur nga Toka e Zjarrit.

ABE: Ndoshta është e ngjashme me ato varietetet e kohës sonë, ku personazhet kryesorë që viheshin në lojë ishin të zinjte?*

XHEKI: Fiks! Ky është thelbi! Ndoshta mund të merrni edhe ndonjë valle, të këndonin ndonjë këngë apo të paktën të na demonstroi ndonjë lëvizje të bukur! **[ABE dhe ÇARLS duken të tmerruar.]**

* *Shënim, V. Nathanaël.* Fjala e përdorur nga autori është “The minstrel show”, që kupton një shfaqje argëtuese në Amerikën e fillim-shekullit të 19-të, një përmbledhje e skeçeve komike, pjesëve muzikore dhe atyre me balet, ku në qendër ishin kryesisht njerëzit e zinj, veçanërisht ata me prejardhje afrikane. Në shfaqje luanin kryesisht njerëz të bardhë që kishin bërë makijazh për t’u dukur si të zinj. Në këto shfaqje, njerëzit e zinj paraqiteshin me stereotipa të caktuar: mendjelehtë, përtacë, supersticiozë, komikë dhe që i nënshtrohen fatit. Kam zgjedhur ta zëvendësoj me “variete”, gjithnjë duke pasur në vëmendje shpjegimet e mësipërme.

SHEILA: Hesht! Të lutem, trego pak respekt!

ABE: Kam një pyetje: nëse pyetja që më drejtoni, kërkon pak kohë për t'u menduar, në synimin për të dhënë përgjigjen e duhur?

SHEILA: Mos u shqetëso, do të përpiqem t'i shmang pyetje të kësaj natyre.

ÇARLS: Akoma më shumë në lidhje me argumentin e mësipërm, po nëse vetë pyetja është komplekse – sa kohë kemi në dispozicion për përgjigjen?

XHEKI: As për këtë nuk ka nevojë të shqetësoheni. Thjesht do ju ndërpresë fjalën dhe do kalojë në pyetjen tjetër. Ne kemi evoluar dhe jemi bërë mendjehapur, që mbyllet në çast, sapo dëgjon të artikullohet diçka që na duket familjare, e thënë më parë, në lidhje me atë që pyesim.

ÇARLS: Duket pak si *solipsistic*.

SHEILA: Në rregull, mendoj se Xheki ka të drejtë - por Xheki, mund të tregosh të lutem pak respekt për vizitorët tanë të shquar!

ABE: Në rregull, më duket se tani jemi të qartë. Akoma, në kohën time, njerëzit mund të shpenzonin deri në dy apo tre orë në ditë për të dëgjuar një debat publik, me çfarëdo lloji mënyre, për argumente që kishin rëndësi.

SHEILA: Po, e di. Por në kohën tonë nuk i marrim gjërat kaq ngadalë. Në fakt, njerëzit kanë më pak hapësirë për të qenë të vëmendshëm, ka kaq shumë gjëra për të cilat duan të dinë...

XHEKI: ...veçanërisht kur e dinë se çfarë duan të dinë.

ÇARLS: Por pse është një fenomen i tillë? Mos ndoshta truri ka evoluar shumë në këta 150 vitet e fundit?

SHEILA: Vështirë të thuhet...

XHEKI: ...veçanërisht kur nuk mbaron së lexuari apo shkruari as edhe paragrafin e parë të një artikulli shkencor, pa kontrolluar një herë nëse të ka ardhur ndonjë *e-mail* i ri apo të hapësh *Facebookun*, për të parë se kush i ka bërë "like" postimit të para dy orëve.

ABE: Çfarë thotë ajo?

SHEILA: Mos ia vini re! **[i drejtohet XHEKI]** Xheki, paralajmërimi i fundit! Edhe një vërejtje tjetër e këtij lloji, dhe nuk e rinovojmë kontratën së bashku. Dhe shko bëj edhe një herë atë punën e vjetër dhe të mërzitshme që ke pasur më parë, pedagoge në universitet.

ÇARLS: Akoma nuk na keni thënë pse Linkoln dhe unë jemi këtu, së bashku, në këtë skenë.

ABE: Pyetje e drejtë! Për më tepër që në jetën reale kurrë nuk e kemi njohur njëri-tjetrin, ndonëse sigurisht që kam lexuar rreth librit të famshëm të z. Darwin për origjinën e bimëve dhe të kafshëve.

ÇARLS: Dhe sigurisht edhe unë kam lexuar për lëvizjen tuaj të guximshme për të hequr ligjin për skllavërinë në Amerikë, ndonëse e dinit se do mund të nxiste përshkallëzimin e luftës ndërmjet shteteve.

SHEILA: Kemi zbuluar se të dy keni lindur në të njëjtën ditë dhe në të njëjtin vit dhe vetëm pak kohë më parë mundëm të festojmë dyqind vjetorin e datëlindjes tuaj të përbashkët.

ABE: Kush, saktësisht, po feston për ne?

ÇARLS: Ndoshta grupe obskurre të shoqërisë!

SHEILA: **[qesh]** Oh, jo. Festime të ngjashme janë organizuar në të gjithë botën. Në fakt, ideja e Ditës “Linkoln-Darvin”, të themi si “Dita e Pavarësisë” apo “Dita e Çlirimit”, është propozuar si ditë pushimi në disa shtete të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. **[ABE dhe ÇARLS duken në mëdyshje]** Nuk arrini ta kuptoni, saktë? Për ne, ju jeni dy nga njerëzit më me ndikim dhe, ndoshta, edhe më frymëzues, të shekullit të 19-të.

ABE: **[i zënë si në turp]** Po mirë, më duket si arritje...

ÇARLS: **[njësoj duket si i zënë në turp]** Shpresoj të mos ju zhgënjejme...

SHEILA: Ju lutem... Ju tashmë e keni fituar respektin tonë. Ajo që ka rëndësi sot, besoj, është që ne të arrijmë të kemi respektin tuaj. Në të vërtetë, do na pëlqente të qëndronit mes nesh. **[XHEKI shfaq shenja padurimi nga vendi ku po qëndron dhe SHEILA e merr mesazhin.]** Gjithsesi, pa ju vënë në vështirësi, mendoj të fillojmë me disa prezantime të

shkurtra, sepse ndoshta audiencës tonë mund të mos i kujtohen detaje lidhur me çfarë keni bërë, sa për të fituar meritën e të përballurit me telashet e shumta për t’ju sjellë edhe një herë mes nesh.

XHEKI: Vërtet, dua të them që të dy dolën mirë në votimet që bëmë me ndjekësit tanë, kur i pyetëm se cilët personazhe do të dëshironin t’i kishim edhe një herë mes nesh, megjithëse më duhet të pohoj se nuk ishin aq mirë sa Jezusi! Edhe Hitleri ua kaloi! Por prapë ishin mirë. Morën shumë vota!

ÇARLS: Kush është Hitleri?

ABE: Është provuar, më së fundmi, ekzistenca e Jezusit?

SHEILA: Xheki, mjaft me këto! **[drejtohet nga ÇARLS dhe ABE]** Mos i merrni seriozisht të gjitha që thotë! I pëlqen shumë të vejë të tjerët në lojë!

XHEKI: Po, kështu thonë dhe kam filluar ta besoj edhe vetë! Gjithsesi, dolëm me fitim me ju, dy të ftuarit, sepse keni lindur në të njëjtën ditë, ndërkohë që keni vdekur në një periudhë prej vetëm 17 vitesh larg njëri-tjetrit. Na kursyet gjysmat e parave të produksionit!

[ÇARLS dhe ABE duken të çuditur]

SHEILA: Ajo që do të thotë Xheki është, se mund t’i drejtojmë kronoskopët pothuaj në të njëjtat periudha kohore të së shkuarës, për të bërë një përmbledhje të llojit të ndërveprimit që ka pasur me mjedisin (*Shih shënime, f. 129*), secili nga ju, pak a shumë menjëherë.

ABE: Kronoskopë?

ÇARLS: Ndërveprim ndërmjet njeriut dhe mjedisit?

XHEKI: Ajo do të thotë që kemi në dispozicion gjëra të mëdha, që duken si teleskopë, që arrijnë të zhbirilojnë të shkuarën dhe të nxjerrin në pah vetëm ato figura historike që duken të pastra, të padyshimta.

[ÇARLS dhe ABE duken të alarmuar]

SHEILA: Mos u shqetësoni! Kemi biseduar dhe e kemi zgjidhur problemin nga pikëpamja etike për të qetësuar çdo protestë që mund të vijë nga “Shoqëria për parandalimin e mizorive ndaj të Vdekurve”.

ABE: Mendoj, se kjo do të thotë që duhet të qetësohemi...

SHEILA: Pikërisht! Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndodh shpesh “të ringjallen të vdekurit”, shumë më shpesh se në Britani dhe vetëm një herë në Shqipëri, përjetësuar në veprën e Kadaresë “Kush e solli Doruntinën”, por edhe aty deri në kufijtë e legjendës. Dhe asnjëherë nuk është kërkuar prania e ndonjë personi që merret me etikën për raste të tilla!

ABE: Por nuk do të kishte qenë më e thjeshtë që ju të vinit në kohën tonë, se sa sikleti i të sjellit tonë në kohën tuaj?

CHARLS: Për më tepër, që ju dini shumë më tepër për ne, se sa ne për ju. Në këtë mënyrë, do kishim mundur të shmangnim edhe keqkuptimet e shumta që lindin nga një përballje e tillë. Ne dimë shumë pak për ju!

SHEILA: E vërtetë! Teknologjia jonë e udhëtimit në kohë na e jep një mundësi të tillë, por menduam se do të ishte shumë e vështirë realizimi i një takimi të përbashkët, parë aktivitetet e shumta që keni pasur, si edhe ndryshimet në llojin e jetës që keni jetuar. Duke vepruar në këtë mënyrë, pra duke ju sjellë ju midis nesh, në kohën tonë, e kemi më të thjeshtë! Për më tepër që takoheni në një moment kur secili i ka përfunduar veprat më të rëndësishme që ka ndërmarrë....

XHEKI [e ndërpret]: Për të mos përmendur faktin që na ndihmon të shmangim problemin e këmbënguljes, që shqetësimi ynë kërkon një përgjigje serioze. Përfytyroni sikur, papritmas, të shfaqeshim në kohën tuaj, të themi në vitin 1865! Në rastin më të mirë, menjëherë do trumbetonit se janë parë dy jashtëtokësorë dhe në rastin më të keq do na shpallnit si përfytyrime të njerëzve të sëmurë apo me imagjinatë super të zhvilluar. Duke kuptuar gjithë çfarë kemi kaluar për t’ju sjellë edhe një herë në këtë botë, shpresojmë të vlerësoni se vërtet kemi punë për të bërë sot!

SHEILA: [kthehet nga XHEKI, dukshëm e shqetësuar] Tonin, Xheki! Kujdes tonin!

ABE [duket këmbëngulës]: Kur them se e vlerësoj mikpritjen tuaj, jam i sigurt se flas edhe në emër të Darvinit, por [pak i dëshpëruar] – a do mund të kthehem edhe një herë aty ku ishim?

SHEILA: Sigurisht! Por sikundër ju thamë, shpresa është që do dëshironi të qëndroni!

XHEKI [në dëshpërim]: Sheila, a mund të vazhdojmë me prezantimet? Pak nga pak po më humbet edhe mua dëshira për të qenë këtu, për të jetuar!

SHEILA: Patjetër! Atëherë, sikundër e thamë edhe në fillim, të dy keni lindur në të njëjtën datë, më 12 shkurt 1809. Kjo do të thotë se i takoni shenjës së Ujorit. Ujorët janë miqësorë dhe humanë, të ndershëm dhe besnikë, origjinalë dhe kreativë, të pavarur dhe intelektualë. Deri tani shumë mirë...

ÇARLS: Sigurisht që këtë shenjën e horoskopit nuk e merrni seriozisht!

SHEILA: Sa i takon karakteristikave personale duket se iu përshtaten tërësisht. Të paktën kështu ju mbajmë mend ne!

ABE: Darwin, më duket se ka vend ajo fjala e urtë popullore: “Kalit të dhuruar nuk i shihen dhëmbët!”

SHEILA: Por çdo shenjë zodiakale ka anën e saj të errët dhe, nëse mund të shprehem në këtë formë, mendohet se e njëjta gjë mund të thuhet edhe për karakteristikat. Ujorët janë të vështirë dhe nopranë, të paparashikueshëm dhe të çoroditur, të ftohtë dhe të izoluar. Besoj që asnjë prej jush nuk i ka pasur të gjitha këto tipare paketë! **[ABE dhe ÇARLS nuk flasin, por shikojnë gjithë inat] Duke iu afruar të dyve:** – Ndoshta mund t’ju gëzojë fakti që studiuesit në fushën e mjekësisë kanë punuar shumë dhe për një kohë të gjatë, në përpjekje për të gjetur se çfarë ua ka bërë jetën të mjeruar, të dy juve! Dhe është diçka të cilën vërtet duhet ta vlerësoni sa i takon kohës sonë: ne po i nxjerrim fundin pothuaj çdo sëmundje. Shumë shpejt këshilltarët gjenetikë do të zëvendësojnë astrologët dhe do të shërbejnë si i vetmi burim për të vlerësuar se si mund ta kuptojmë sa më mirë jetën që do të kemi. **[ÇARLS dhe ABE duken të shqetësuar]**

SHEILA: Abe, ndonëse një pjesë e madhe nuk janë të sigurt, por mendoj se nga të dy, ju jeni rasti më i lehtë dhe e gjitha për shkak të trupit tuaj të hollë e të stërgjatë. Studimet e sotme për shëndetin tuaj tregojnë, se pjesën më të madhe të kohës si i rritur, duhet të keni vuajtur nga një dhimbje e vazhdueshme fizike, një dhimbje që duhet të ketë qenë edhe një nga shkaqet e depresionit. Fillimisht mjekët besonin se depresioni e kishte origjinën në “Sindromën Marfan”, një çrregullim i indit lidhës që prek njerëzit me gjymtyrë të gjata. Pesëdhjetë vjet më parë, kushëriri juaj i tretë zbuloi se vuante nga kjo sëmundje. **[ABE dhe ÇARLS rrotullojnë sytë]** Por nuk kam mbaruar! Për të testuar këtë hipotezë është shqyrtuar modeli i

duarve tuaj. Shumë shpejt u bë e dukshme se duart ishin muskulore, jo të holla dhe pa proporcione, sikundër ndodh me ata që vuajnë nga “Sindroma Marfan”.

ÇARLS: Ke akoma për të thënë? Duket si gjueti shtrigash, për të fabrikuar çrregullime të paqena!

SHEILA: Po! Konsensusi mjekësor nuk është arritur plotësisht, por fokusi është një sindromë e trashëguar kanceri, që quhet “endoplasia endokrine e shumëfishtë”. Mjekët kanë arritur t’i zbulojnë simptomat nga ekzaminimi i fotografive dhe kujtimeve të Abe dhe fëmijëve të tij, veçanërisht në vitet e fundit të jetës. Në foto vihet re dobësimi i vazhdueshëm i Abe-s, si dhe lexojmë për një gjendje të qëndrueshme kapsllëku – shenja të sigurta të pranisë së kancerit.

ABE: Nuk mund të jetë, që thjesht po kaloja një gjendje stresi, relativisht të madh?

SHEILA: Sigurisht, edhe kjo mund të jetë e vërtetë, por nuk do të ishte *shkencë*! Gjithsesi, nëse nuk do ju kishin goditur për vdekje, me armë zjarri, në kohën që po vështronit shfaqjen **[ABE papritmas vështron audiencën sikur po heton]** – mos i kushto kohë idesë se çfarë mund të ndodhë këtu! – do të kishit vdekur nga kanceri, ndoshta vetëm pak vite më vonë. **[ABE i kthehet rrolit]** Tani, Çarls, nuk jeni ndopak kureshtar, çfarë mendojnë shkencëtarët në lidhje me faktin që ju zemëroheshit lehtësisht?

ÇARLS [i zbutur]: Po, jam! Ju lutem, nëse është e mundur!

SHEILA [ndërsa Sheila flet, ÇARLS duket i humbur në mendime]: Për një kohë të gjatë, shkencëtarët mendonin se ju ishit skizoid, një çrregullim në personalitet, nisur nga një karakteristikë e spikatur dhe shumë e pazakonshme te njerëzit – shkëputja nga jeta e zakonshme sociale. Më pas u bë shumë populllore ideja se ju vuanit nga autizmi, ose sikundër preferohet të quhet sot, nga Sindroma Asperger. Kjo mund të shpjegojë aftësinë tuaj të pazakonshme për t’u shkëputur nga realiteti, për t’u hutuar. Çarls, po më dëgjon?!

ÇARLS [ndjek përsëri me vëmendje]: Po! Ndjesë, ka qenë udhëtim i gjatë.

XHEKI: Gjithnjë e njëjta histori – problemet me ndryshimin e orës nga një zonë kohore në tjetrën!

SHEILA: Kuptoj! Lajmi i mirë është, Çarls, se shkencëtarët kanë zbuluar diçka gjenetike që nuk shkon në rastin tuaj.

ÇARLS: Më duket se po e përdorni fjalën “gjenetike” në një mënyrë të atillë që nuk e kuptoj plotësisht.

SHEILA: Do ta sqarojmë më vonë, po në këtë program. Për momentin, mendoni për “gjenetikën” si për diçka “të trashëguar”. Së fundmi, shkencëtarët i kanë përqendruar studimet e tyre në faktin, se për afro dyzet vitet e fundit të jetës, ju keni përjetuar episode periodike të vjellash, shqetësim zorrësh dhe dhimbje koke, jeni ankuar për mbi-lodhje, si dhe keni pasur probleme me lëkurën dhe depresionin. Në përgjithësi - flasim për kohën kur keni jetuar - njerëzit janë përpjekur t'i shpjegojnë këto simptoma, kryesisht, si të lidhura me ngjarjet dramatike me të cilat u është dashur të përballen në jetë, por për arsyet për të cilat jemi mbledhur këtu, sot, asnjë prej tyre nuk do të përmendet.

ÇARLS: E vlerësoj shumë që po tregoheni kaq e rezervuar!

SHEILA: Gjithsesi, është vetëm një çrregullim që i përmban të gjitha simptomat e mësipërme: intoleranca ndaj laktozës. Dhe duket se ka qenë e përhapur në familjen tuaj. Akoma, ju keni raportuar se simptomat zhdukeshin sapo hiqnit dorë nga konsumi i qumështit dhe kremit në dietën ushqimore. Mund të shtoj, akoma, se shkencëtarët që kanë botuar këtë hipotezë, vazhdojnë t'ju kritikojnë për injorimin që i keni bërë rolit të laktozës në evolucionin e mamalëve – por edhe me këtë nuk do të merremi këtë radhë. **[ÇARLS duket i lehtësuar]** Shpresoj se u ka bërë përshtypje përparimi i madh që kemi bërë në shkencën e mjekësisë, sa shumë dimë për trupin e sëmundjet nga të cilat mund të vuajmë. Ndoshta - dhe ndjesë për notat e guximit që do i jap këtij përfundimi - për disa aspekte të jetës suaj ne dimë më shumë se sa vetë ju!

ÇARLS [i acaruar]: Kjo mbetet për t'u parë, zonjushë! Deri tani, ajo që më ka bërë përshtypje është diferenca – jo përmirësimi – ndërmjet kohës tuaj *vis-à-vis* kohës tonë.

SHEILA: Mos u shqetësoni! Tani që e kaluam fazën e parë, atë të prezantimeve personale dhe të gjithë e dimë, pak a shumë, përse jemi këtu,

në këtë skenë – pra, si personazhe me vlerë për programin - po vazhdoj me një pyetje direkte, që mori shumë vota nga votuesit, si e domosdoshme për t’u drejtuar: Abe... Çarls... Jeni – ose më mirë, keni qenë – *racistë*?

ABE: Kërkoj ndjesë, por së pari ju lutem më përkufizoni fjalën “racist”. Mos është ndonjë nga ato konceptet që është sajuar këta 150 vitet e fundit?

SHEILA: [e habitur, i drejtohet ÇARLS] Ndoshta mund t’ia shpjegoni racizmin Abe-t...

ÇARLS: Dakord, sigurisht e di çfarë është raca. Për më tepër, nëntitulli i librit tim, *Origjina e specieve* është ‘Ruajtja e racave të favorizuara në luftë për jetën’. Por “racizëm”? Më vjen keq, që as nuk i afrohem kuptimit të fjalës.

SHEILA: Po bëni shaka! Apo ndoshta, Xheki, është ndonjë shaka e jotja? Mos po luani me mua, për të më dhënë ndonjë mësim?!

XHEKI: Jo, Sheila, mendoj se të dy zotërinjtë po flasin me ndershmëri. ‘Racizmi’ filloi të përdoret si term në vitet 1930, për të treguar se çfarë po bënin nazistët në Gjermani. [ABE dhe ÇARLS shfaqen dyshues kur përmendet termi ‘Nazist’] Në fakt, fjalët “racial” dhe “racialist”, ndonëse me një kuptim disi të paqartë, i paraprijnë fjalës “racist” dhe fillojnë të përdoren në dekadën e parë të shekullit XX, gjithnjë në kontekstin e ndarjes raciale në Afrikën e Jugut.

SHEILA: Por nuk besoj se ka ndonjë dallim të madh ndërmjet “racës” dhe “racizmit”. Nëse e dini çfarë është raca, racizmi është vetëm një hap më tutje, të themi fqinji i saj!

XHEKI: Mendoj se diferenca është që as Britania, dhe as Amerika, kurrë nuk i kanë formuluar politikat e tyre mbi bazën e racës - ndërsa Gjermania dhe Afrika e Jugut po! Në të dy këto vende kemi politika bazuar në racë. Në të dy vendet ka pasur politika që *nënkuptonin* diskriminim racial – sikundër *nënkuptoheshin* edhe format e diskriminimit...

ABE: Po, për mua arsyetimi qëndron. Në kohën tonë, pjesa më e madhe e argumenteve që mbështesnin skllavërinë e negërve kishin një komponente shumë të rëndësishme, pikërisht racën. Negërit referoheshin si inferiorë në lidhje me stokun që vinte nga Europa...

SHEILA: Abe, më duhet t'ju tërheq vëmendjen sa i takon gjuhës që përdorni. Nuk mund të thoni vazhdimisht negërit, negërit. Nuk mund ta përdorni si fjalë! Në vend të saj ne themi “të zinjte”, ose thjesht “afrikano-amerikanët”. Ju duhet...

ÇARLS: Por Linkoln është korrekt me termat: skllëvërit amerikanë të emancipuar nga ai ishin negër, që rridhnin po nga negër, pjesa më e madhe e të cilëve kishin lindur në Amerikë. Afrika nuk përbënte problem – dhe as edhe ngjyra, për më tepër që shumë nga negërit ndanë mjedise të përbashkëta me europianët. Përpos të gjithave, negërit kanë jetuar në Amerikë – të shohim **[Ilogarit]** - afro 250 vjet më parë se të emancipoheshin nga Linkoln. Mendoj se vetëm anglezët mund të kenë zbarkuar në Amerikën e Veriut përpara tyre.

SHEILA [e paduruar]: Dakord... dhe Linkoln ka vepruar shumë mirë. Por me gjithë respektin për të dy ju, atëherë dhe tani, dhe këtu... – dua t'u kujtoj se ekziston gjithnjë opsioni që të ikni nga keni ardhur – ne nuk i referojmë njerëzit në bazë të racës...

XHEKI: ...vetëm nga etnia! **[ÇARLS dhe ABE duken konfuzë nga ndryshimi]**

SHEILA: Saktë! Hmmm... Gjithsesi, ju lutem, a mundet që nga tani e në vijim, për qëllimet e debatit, sa herë që ju duhet të përdorni fjalën “negër” ta zëvendësoni me “të Zinj”? Ndërsa për europianët të përdorni fjalën “të Bardhë”? Na duhet vërtet të kalojmë nga një argument në tjetrin dhe nuk mund të humbasim kohë në përkufizimet dhe kuptimet e termave.

ABE: Po vazhdoj aty ku e lashë... Në kohën që kam jetuar unë, ekzistonte një kompromis i përgjithshëm, dhe këtu fus edhe veten time, që të Zinjte ishin inferiorë në krahasim me të Bardhët. Sigurisht që njerëzit kishin mendime të ndryshme. Disa mendonin se edhe të bardhët, edhe të zinjte, i përkisnin të njëjtës specie. Të tjerë jo! Gjithsesi, do më pëlqente që edhe Darvini të shprehej në lidhje me këtë, për t'i dhënë diskutimit një argument më kompetent... Në fund të fundit, ndoshta duhet të pajtohem me ato që do të thotë.

ÇARLS: Dakord, do përpiqem të bëj më të mirën, pasur në konsideratë edhe kohën e shkurtër të vëmendjes që audienca ka në dispozicion. Njëra mënyrë për të menduar për diferencat ndërmjet të Zinjve dhe të Bardhëve është se të dyja palët rrjedhin nga të njëjtët paraardhës, një lloj majmuni i

vogël, që me shumë gjasa ka jetuar në Azi ose Afrikë. Më pas, nga një grupim i vogël i fillimit, popullsia u rrit me kalimin e kohës, deri sa mjedisi fizik u shndërrua në një rrezik të mundshëm për ekzistencën e tyre të vazhdueshme. Besohet se në atë kohë duhet të kenë vdekur shumë pjesëtarë të komunitetit, por të tjerë mbijetuan, qëndruan dhe u shtuan, dhe të tjerë akoma emigruan në klima më mikpritëse, më të favorshme. Me vazhdimin e këtij procesi, brez pas brezi, për mijëra dhe qindra mijëra, ndoshta për miliona vjet, pasardhësit e atyre majmunëve të parë u shtrinë në të gjithë planetin dhe formuan atë që në ditët e sotme e quajmë shoqëri.

SHEILA: Duket si teoria juaj!

CHARLS: Po, teoria ime është! Në këtë rast, diferencat fizike ndërmjet të Zinjve dhe të Bardhëve pasqyrojnë, pak a shumë, sfidat e diferencave të mjedisve që gjetën në luftën për të mbijetuar: sikundër mund ta përfytyroni, në një brez të dhënë të majmunëve-njeri, së pari u shfaqën ndryshime të lehta në ngjyrën e lëkurës, ngjyrë që mund të ketë inkurajuar ose jo lëvizjen. Dua të them, se ata që e patën ngjyrën më të zbehtë lëvizën, ndërsa ata që e patën ngjyrën e lëkurës më të theksuar zgjodhën të qëndrojnë në vendet me diell, sikundër janë Azia dhe Afrika. Pas disa brezash, dy familjet e majmunëve-njeri filluan të jenë dukshëm të ndryshëm në pamje nga njëri-tjetri. Ne jemi në gjendje ta konstatojmë këtë ndryshim natyror, falë seleksionimit, në të gjithë mbretërinë e bimëve dhe të kafshëve. Personalisht kam pasur mundësinë ta konstatoj kur kam qenë i ri, në bordin e anijes “Beagle”, në një udhëtim përreth botës. Si dhe mundësinë e jashtëzakonshme për të parë, me sytë e mi, se si ndryshojnë zogjtë nga njëri-tjetri, ndoshta edhe në mënyrë të papërfillshme – më lejonin të hap një parantezë, turtujt më kanë magjepsur në mënyrë të veçantë – por gjithnjë në përshtatje me strukturën e mjedisit ku jetojnë.

ABE: Po, më kujtohet libri juaj me kujtime rreth atij udhëtimit. U shit shumë mirë në Amerikë!

CHARLS: Faleminderit! Por duhej të kalonin edhe njëzet vjet të tjerë, përpara se të formuloja teorinë time të evolucionit. Dhe deri ditët e fundit të jetës – kritikët e mi nuk pushuan as edhe ato ditë – përsëri nuk munda ta gjej dot mekanizmin e trashëgimisë. A u përshtatën turtujt ndaj mjedisit në ndonjë mënyrë inteligjente apo thjesht ishte fati i të lindurit në vendin e duhur dhe në mënyrën e duhur? Apo asnjë nga këto të dyja? **[fillon të duket i humbur në mendime]**

SHEILA: Gjithë sa thatë janë shumë të bukura, por po flasim për origjinën e racave dhe kemi dëgjuar vetëm gjysmën e historisë. Dhe duket se gjysmën tuaj!

ÇARLS: [e kthen vëmendjen në ato që fliten] Kërkoj ndjesë! Po vazhdoj... Pikëpamja tjetër argumenton se si të Zinjët, ashtu edhe të Bardhët, janë krijuar në të njëjtën mënyrë, ashtu si janë krijuar të gjitha speciet e tjera në Tokë, si janë krijuar bimët dhe kafshët. Një pretendim i tillë ka edhe Biblën në anën e tij ndonëse, sikundër mund të dëshmojë edhe Linkoln, precedenti biblik është edhe më i guximshëm, sepse shprehet që edhe të Zinjët, edhe të Bardhët, janë pjesëtarë të së njëjtës specie.

ABE: Sigurisht që është e vërtetë! Në fakt, grupet që e ngritën të parat zërin kundër skllavërisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si çështje parimore, ishin *Quakers* dhe *Unitarians* në New England,* të cilëve shumë shpejt iu bashkuan edhe anëtarë të grupimit “Zgjidhimi i madh i dytë i krishterimit ungjillor”, që u përhap kryesisht në perëndim të vendit. Ata u mbështetën, sigurisht, në idenë biblike, se në sytë e Zotit të gjithë njerëzit janë të barabartë – cituar fjalë për fjalë nga Bibla. Pra, shumë më parimisht se sa baballarët themelues të kombit, për të cilët, me që ra fjala, duhet thënë se mbanin një qëndrim më pragmatist për një çështje të tillë.

SHEILA: Atëherë, mos duhet të arrijmë në konkluzionin se të dy jeni njësoj “pragmatikë”?

ABE: [i zënë si në turp] Sikur Darvini kishte një argument tejet interesant... Mos duhet të merremi me të?

SHEILA: Në rregull... Çarls, ju po thonit, se sipas teorisë së parë, të Zinjët dhe të Bardhët ishin pjesëtarë të specieve të ndryshme?

ÇARLS: Po, mendoj se ky është thelbi. Gjithsesi, më duhet të shtoj që vetë fjala “specie”, në mënyrën si përdoret, më bën për të qeshur, sepse u krijua në funksion të kreativitetit: supozimi ishte që çdo specie ka cilësitë e saj të veçanta, që e dallojnë tërësisht nga të tjerat. Botanisti i madh suedez, Linnaeus, të cilin shumë e referojnë si shkencëtarin më të madh pas Njutonit, arriti të klasifikojë mijëra lloj kafshësh, bimësh dhe mineralesh. Zelli i tij për këtë punë ushqej nga mendimi se po përsëriste detyrën që i

* *Shënim*, V. Nathanaili. *Quakers* dhe *Unitarians* janë lëvizje fetare, pjesë e besimit të krishterë; secila ka doktrinën e saj.

ishite dhënë Adamit në librin e “Gjenezës”, për t’u dhënë të gjitha krijesave të natyrës emrin e duhur, korrekt, detyrë që e realizoi duke gjetur disa karakteristika, në gjendje t’i dallonte e emëronte. Më pas, i renditi në bazë të një hierarkie.

SHEILA: Sa ide e çuditshme!

ÇARLS: Dakord, mund ta thoni! Por mund të shtoj se puna e tij rezultoi të ishte shumë e dobishme. Edhe unë u kam vënë emrin disa specieve. Ose ndoshta mund të keni dëgjuar për emrin me të cilin Linnaeus ka pagëzuar racën njerëzore: ‘*Homo sapiens*’.

SHEILA: Çarls, shpresoj që kjo që po thoni të mos jetë një tjetër nga ato shakatë politikisht jo-korrekte tuajat!

ÇARLS [qesh] Jo, jo! Ky është emri për specien tonë, humanët! Rrjedh nga latinishtja dhe do të thotë “Njeriu, i mençur”. Linnaeus mendonte se ne ishim majmunë, por ndryshonim nga ata se kishim shpirt.

SHEILA: Por kjo nuk ka qenë pikëpamja juaj?

ÇARLS: Jo, unë nuk besoj se ekziston ndonjë dallim i madh ndërmjet humanëve dhe majmunëve. Unë besoj se të gjithë kemi pasur një paraardhës të përbashkët, nga i cili kemi rrjedhur të gjithë – sigurisht për periudha të gjata kohore, që i kam përshkruar edhe më herët. Në këtë rast, e kemi të vështirë të përcaktojmë se kur fillon një specie dhe kur mbaron tjetra. Gjithçka varet nga suksesi i çiftëzimit të dy individëve dhe aftësia e pasardhësve të tyre për të mbijetuar dhe prodhuar brezin tjetër.

SHEILA: Do të thotë kjo, se majmunët kanë shpirt? Apo jo?

ÇARLS [qesh]: Dakord, por mendoj se Abe duhet të jetë përsëri pjesë e diskutimit, sepse më shumë se sa shkencore është çështje politike...

SHEILA: Nuk jam e sigurt nëse e kuptoj se çfarë po thoni. Por mos u shqetësoni, sepse Abe-s do t’i drejtohem shumë shpejt. Pra, Çarls, po thonit që ...

ÇARLS: Po thoja që nuk mendoj, se të kuptuarit e natyrës si produkt i forcave evolucionare kërkon edhe postulatit e ekzistencës së shpirtit – të paktën, jo në kuptimin që gjejmë në besimin e krishterë për aftësinë e veçantë të të menduarit, që u jep humanëve pushtetin për të reflektuar, në

ndryshim nga ajo që gjejmë te kafshët e tjera. Ne e gjejmë aftësinë për të menduar – sigurisht në forma më të thjeshta - edhe në botën e kafshëve. Në të kaluarën, në përgjithësi, filozofët i mendonin humanët si të ndryshëm, sepse u atribuonin shpirt, ndërsa kafshët i perceptonin thjesht si makina, pa kapacitetin për të reflektuar në lidhje me çfarë ndodh përreth. Nga studimet e mia kam arritur në konkluzionin, që dallimi ndërmjet humanëve dhe kafshëve nuk është kaq absolut.

SHEILA: Pra, po pohoni që ne nuk jemi dhe aq të zgjuar dhe ata nuk janë edhe aq budallenj.

CHARLS: Po, mund të shprehemi edhe në këtë formë. Dakord, këtë po them.

SHEILA: Do t'i kthehemi këtij argumenti për pak, sepse nuk dua të le Abe-n jashtë diskutimit. Abe, të lutem, cila është pikëpamja juaj për gjithë këtë çështjen e specieve? Mendoni se të Zinjët dhe të Bardhët janë pjesëtarë të së njëjtës specie? Dhe pse? **[ABE fillon të flasë, por e ndërpret]** Të lutem, përpara se të fillosh, po të bëj me dije se të gjithë jemi familjarë me të folurën tuaj, një e folur që duket se nuk kërkon të prishë qejf me bashkëbiseduesin, karakteristike për avokatët, trashëguar kohë më parë, kur jetonit e punonit në Illinios. E bëra këtë paraqitje, për të thënë që duam përgjigje të drejtpërdrejta. Mos harroni, që nuk po kandidoni për president, pra nuk po flisni përpara elektoratit.

ABE [qesh]: Vërtet që nuk po kandidoj për president, por ndoshta do më duhet, shumë shpejt, të kandidoj për të fituar të drejtën për të qëndruar në këtë botë! Gjithsesi, në çdo rast do pohoja se Darvini po përpiqet të thotë, se të dy anët e kësaj çështje, si ajo shkencore dhe ajo politike janë të lidhura shumë më tepër se sa mund të mendohet. Kështu që kam frikë se përgjigja ime mund të duket e dykuptimtë... **[SHEILA ka një pamje të dyshimtë]** Por mendoj se një mënyrë e mirë për të filluar është të marrim në konsideratë paradoksin - që për shumë të huaj mund të jetë objekt kureshtjeje - se çfarë mendojnë amerikanët për racën dhe humanizmin.

SHEILA [shkëlqen e tëra]: Sa bukur! Do na pëlqente të flisnim për një paradoks!

ABE: Paradoksi mund të përmblihet pak a shumë në këtë formë: njerëzit që kishin prirjen të besonin se të Bardhët dhe të Zinjët ishin të njëjtë, pra që mendonin se ishin pjesëtarë të të njëjtit grup, shpesh ishin edhe ata që i

trajtonin të Zinjte më keq, më keq se sa ata që kishin prirjen të besonin se u përkisnin racave krejtësisht të pabarabarta.

SHEILA: Si është e mundur?

ABE: Po, është e mundur, nëse gjykojmë në termat e pronarëve të skllëvërve. Dukej se kërkonin të justifikonin veprimet që bënin, në ambicien për të qenë pjesë e racës humane. Ne e vlerësojmë lirinë si një e mirë e panegociueshme, por liria funksionon vetëm nëse keni mundësinë ta përdorni. Tani e ka radhën hipoteza e aftësive. Nëse supozojmë se të Zinjte kanë aftësi, por dështojnë të punësohen e përftojnë të mira materiale prej saj, atëherë është faji i tyre. Nga ana tjetër, nëse supozojmë se nuk kanë aftësi, atëherë edhe pritshmëritë që ata t’ia dalin me sukses janë zero, që do të thotë se edhe nuk kanë faj kur nuk arrijnë t’ia dalin me forcat e veta. Supozimi i dytë është opsioni më human, të paktën në perceptimin e pronarëve të skllëvërve.

SHEILA: Sa e çuditshme!

ABE: E kuptoj çfarë doni të thoni. Por në atë kohë nuk tingëllonte njësoj si sot. Detyra për t’u kujdesur për skllëvërit mbështetej në një bazë të fortë ligjore. Ndodhte shpesh që pronarët e skllëvërve të përfundonin në dyert e gjykatave për keqtrajtimin e skllëvërve. Dhe sa kohë që skllëvërit trajtoheshin ligjërisht, ndonëse në të njëjtat pozita me fëmijët, kafshët shtëpiake ose, për të përdorur një term të vjetër feudal, edhe si “plaçkë”, kjo do të thoshte që pronari i tyre presupozohej se duhej të përdorte gjykimin më të mirë në ushtrimin e pushtetit ndaj tyre dhe nuk presupozonte më shumë inteligjencë – thjesht aq sa ishte e arsyeshme. Gjithsesi, këto çështje ligjore pështilleshin rreth një metodologjie të tejfryrë të pronarëve të skllëvërve, që përbënin “aristokracinë agrare”.

SHEILA: Çfarë doni të thoni saktësisht, ose çfarë po nënkuptoni?

ABE: Dua të them që gjithë këto na kthejnë edhe një herë në kohën e luftës civile dhe të bazës intelektuale të saj. Një nga burrat më të mëdhenj të shtetit, që nga koha e Baballarëve Themelues dhe deri në ditët që kam jetuar unë, ka qenë John Caldwell Calhoun, nga Karolina e Jugut. Mund të them se ka mbajtur pothuaj çdo post të rëndësishëm qeveritar dhe ka shërbyer edhe zëvendës president i SHBA, për më tepër për dy presidentë, edhe pse i përkisnin partive kundërshtarë. Një njeri shumë i talentuar, por figurë

kontradiktore, dhe ndoshta kjo ishte arsyeja pse nuk u bë kurrë President, ndonëse sigurisht që e provoi.

SHEILA: Dhe?

ABE: Libri i tij me titull “Traktat për qeverinë” u botua pak pas vdekjes, më 1850. Në këtë libër, Calhoun mbron skllavërinë, jo vetëm si nevojë ekonomike, por edhe si detyrim moral – dhe të dy argumentet i shpjegon ose i sheh si një rend natyror i gjërave. Calhoun besonte se industrialistët e shteteve të Veriut e përdornin gjuhën e “barazisë” thjesht si arsye për t’i trajtuar të gjithë me diktatin e hekurt të rregullit të punës me pagë. “Duke vepruar në këtë mënyrë, veriorët kërkojnë të fshehin mënyrat grabitqare për sa më shumë fitim dhe të injorojnë variacionet natyrore që vërehen te njerëzit” – shprehet ai.

ÇARLS: Nga këto që po dëgjoj, Calhoun më ngjason pak me një nga ata të zhurmshmit, që erdhën nga kontinenti dhe u shpërngulën në Londër – në veçanti me një prej tyre, që mbaj mend se pohonte se e kisha frymëzuar me një nga librat e mi... [në përpjekje për të kujtuar]

SHEILA: Xheki, për kë po flet?

XHEKI: Për Karl Marks!

SHEILA: Atë Karl Marks? Xheki, ndoshta edhe ai mund të futet në listën e atyre që duhet të ringjallen. Si thua?

XHEKI: Rusët me atë po merren.

SHEILA: Shkurtimisht, Çarls, diçka rreth Karl Marksit... Çfarë marrëdhënie keni pasur bashkë? Mendoj që e kuptuat se Marks i është akoma i famshëm, edhe në ditët tona, ndonëse më duhet ta pohoj se nuk e di arsyen, ose më saktë nuk jam e sigurt pse. Në shekullin e kaluar, ai ishte një nga burrat më të famshëm në radhët e njerëzve të thjeshtë dhe atyre të varfër, të shtypur. Në shekullin XX ishte pothuaj në modë të deklaroje se “i përkisje klasës punëtore”, se “të gjithë ishin mizerje” apo edhe të shpreheshë, se “a nuk do të ishte më mirë të kishim një revolucion?” Të gjithë serialët televizivë shtjelloheshin rreth këtyre koncepteve!

ÇARLS: “Tele” - çfarë?

SHEILA [vështron **ÇARLS**, e habitur]: “Tele” - çfarël! E kalojmë më mirë [duket si ata që shkruajnë rubrikat e thashethemeve] Pra, Çarls, si u takove me Marks-in? Çfarë pamje kishte? Mbante erë të mirë?

ÇARLS: Më vjen keq të të them, por asnjëherë nuk e kam takuar atë burrë! Ai dëshironte të mbanim lidhje bashkë, por unë nuk dëshiroja të kisha me të. Mbaj mend që më dërgoi edhe një libër të tij, për më tepër në gjermanisht, një gjuhë që kurrë nuk arrita ta zotëroj si duhet. Më duket se e kishte titullin ‘Kapitali’ – më pas mësova se ishte vetëm vëllimi i parë! I shkrova një letër mirësjelljeje, për t’i bërë qejfin më tepër dhe e vendosa librin në bibliotekë. Kurrë nuk e preka më me dorë, as e zhvendosa nga një vend në tjetrin - zuri vend diku dhe kaq. Nuk e di, vërtet ka pasur ndonjë rol të rëndësishëm ai burrë? Mos duhej të kisha treguar më shumë vëmendje për të?

ABE: Sa i takon kujtimeve të mia, Marks-in e mbaj mend si korrespondent të Londrës për një nga gazetatat kryesore të New York-ut gjatë luftës. Gazeta kishte disa qindra mijëra lexues. Marksi i përkrahte me forcë përpjekjet e qeverisë sime, përfshirë edhe emancipimin e skllëvërve. Për këto përpjekje i isha shumë mirënjohës, për më tepër që vija e qëndrimit të zyrtarëve britanikë ishte e paqartë. Pa dyshimin më të vogël që këta të fundit llogarisnin të përfitonin sa më shumë nga industria e tekstilit, që do të ofronte çmime shumë më të ulëta pambuku nëse Konfederata e Shteteve të Jugut do të kishte statusin e pavarësisë.

SHEILA: Duket sikur Marksi ishte shumë i ndryshëm nga Calhoun.

ABE: Opinione të Marks-it në gazetë demaskonin pretendimet e jugorëve për një aristokraci “të mirë” të Jugut. Ai mendonte se kjo ide – në fakt një nga gurët e themelit të ideologjisë së Calhoun-it – tradhtonte premtimin e madh të Amerikës, jo më pak edhe trashëgiminë e Britanisë në Amerikë, si dhe u çirrte maskën e notave hipokrite atyre, që ju besoj vazhdoni t’i quani po njësoj: “Zotërinjtë e ardhur nga kontinenti i vjetër”. Pra, Marksi nuk kishte asnjë lidhje me Calhoun-in, nuk mund të quhet “miku” i tij. Në mënyrë shumë të përmbledhur mund të shtoj, se secili prej tyre i kushtoi vëmendje disa prej problemeve më të mëdha ekonomike me të cilat po përballej kontinenti i ri. Në qytetet e mëdha industriale, të Bardhë dhe të Zinj konkurronin me njëri-tjetrin për vendet e punës dhe nëse të Zinjët kishin ndonjë përparësi ishte se punonin më shumë orë për më pak pagë. Gjithsesi, pronarët e Bardhë të këtyre fabrikave ndiheshin krejtësisht në të

drejtën e tyre për të tradhtuar interesat e të Zinjve, për t'i rrahur e keqtrajtuar, me një fjalë për t'jua bërë jetën aspak të mirë. Dhe nuk është aspak për t'u çuditur që shumë nga të Zinjët e kishin më të lehtë të jetonin në rrugë, duke braktisur punën në sistemin e fabrikave. Kjo bëri që të shihen si shqetësim publik dhe të shërbejnë si miell për fabrikën e Calhoun-it. Përpos të tjerave [**fillon të imitojë retorikën e Calhoun-it**] si do ta realizojmë detyrën tonë si kujdestarë të Tokës? Të Zinjët në Veri janë si foshnjat në pyll! Është e ndershme t'i lesh në mëshirë të fatit? Apo e drejtë? Është thjesht një justifikim për të injoruar diferencat e dukshme që na ka dhënë Zoti, në pamje dhe përbërje, të Bardhëve dhe të Zinjve, e cila na vë përpara detyrës, ne që jemi raca superiore, t'u japim mundësi të lulëzojnë nën kujdesin tonë mbrojtës?

SHEILA: Sigurisht që këto nuk janë edhe pikëpamjet e juaja!

ABE: Të jem i ndershëm, kurrë nuk kam menduar se të Zinjve dhe të Bardhëve natyra u ka dhënë inteligjencë të barabartë, dhe e kisha zët kur kundërshtarët më etiketonin si “përkrahës i zezakëve” në kohën kur kandidoja për senator i Illinoisit. Por Calhoun ishte ekstremist – ose më mirë, ishte parimor në një mënyrë politikisht të padobishme. Calhoun kishte bindjen e thellë se njerëzve të Bardhë u ishte caktuar detyra biblike të sundonin botën, dhe duke qenë një Calvinist i mirë, besonte se një gjë e tillë bënte sens - të mirë madje - edhe ekonomikisht. Si Sekretar Luftë, Calhoun filloi të zhvendosë fiset indiane të Amerikës në kufijtë perëndimorë të vendit, duke u mohuar të drejtën për të jetuar në tokën e të parëve të tyre, të drejtën për të pasur atdhe. Por shumë Indianë, si për shembull pjesëtarët e fiseve *Cherokee* dhe *Choctaw*, ndryshe nga sa proklamohesh, ia dëlnin më së miri në tokat e tyre me mjetet e tyre, ndonëse gjykoreshin si budallenj nga të Bardhët, sepse sipas tyre nuk nxirrnin shumë përfitime nga shfrytëzimi i saj.

SHEILA: Si munda t'ia hidhte, ndërkohë që kishte urdhëruar gjëra të tilla?

ABE: Mendoj afshi i zjarrit nacionalist – Calhoun e filloi karrierën si nacionalist i vendosur, përpara se të bëhej i dashuri i separatistëve. Këtu më duhet të shtoj edhe imazhin e krijuar për Indianët, si të paafte, frymëzuar dhe ushqyer nga një varg ngjarjesh të rastësishme, si për shembull zbulimi i arit në tokat e fisit *Cherokee*, në Xhorxhia, më 1828. Në kuptimin e plotë të fjalës, ari gjendej gjithandej, mbi tokë, thjesht për t'u mbledhur, jo për t'u zbuluar, dhe *Cherokee* nuk merrnin mundimin as ta mbledhnin...

SHEILA: Përsëri, nuk është justifikim për të përzënë nga vendi njerëz e fise që kanë jetuar për shekuj me radhë!

ABE: Kuptoj se çfarë keni ndërmend të thoni! Por duket se për Calhoun – dhe nuk ishte vetëm ai – indianët nuk ia dlinin dot të menaxhonin tokat e tyre, që shtriheshin në sipërfaqe të mëdha dhe, për më tepër, edhe me burime të shumta natyrore, ndërsa të Bardhët mundeshin. Për shembull, fakti që Indianët kërkuar të mbeten pothuaj ashtu si ishin në marrëdhëniet me të Bardhët, pra përdornin gjuhën dhe zakonet e tyre, përfshirë të njëjtat forma adhurimi dhe kultit, u interpretua gjerësisht si një trashëgimi e papambetur, nga e cila ata nuk dëshironin të hiqnin dorë. Për të qenë të sigurtë deri në fund, duhet të theksoj se veprimet e Calhoun u pasuan nga kundërshtime të forta, por që në përgjithësi ishin të fokusuar në masën e forcës që ishte përdorur gjatë ri-sistemimit të indianëve në tokat e papopulluara të Veriut – si dhe nëse ishte bërë sa duhet për të siguruar pëlqimin e tyre paraprakisht.

SHEILA: Nga gjithë sa thoni, duket se kemi të bëjmë me “pastrim etnik” – të paktën ky është termi që përdorim ne sot.

ABE: Në kohën tonë ne e quajtmë “Shtegu i lotëve”, por kuptoj edhe termin që përdorni ju, sot.

SHEILA: Xheki, ky Calhoun-i duket nazist.

XHEKI: Sheila, ti harron që Calhoun-i thjesht donte t’i risistemonte Indianët në toka të reja, jo t’i shfaroste.

SHEILA: Dakord, por edhe Hitleri në këtë mënyrë filloi – fliste vetëm për risistemim... Dhe kam idenë që disa çifutë edhe e përkrahën.

ABE: Jam dakord që risistemimi degjeneron shumë shpejt në shfarosje, veçanërisht nëse nativët nuk e kanë të lehtë të shkëputen nga toka ku kanë lindur, nga vendi i të parëve – përndryshe, për aq sa ka rëndësi, mirëseardhët në vendin e ri.

ÇARLS: Nëse mundem... një ndërhyrje të shkurtër. Nga sa po thoni, po krijoj përshtypjen se në “Kapitullin Calhoun” mungojnë dijet e qarta për historinë e natyrës. Ka shumë ndryshim të pohosh se “të Bardhët dhe të Zinjët janë të pabarabartë” në lidhje me sfidat me të cilat u duhet të përballen në një mjedis të caktuar dhe të pohosh se “të Bardhët dhe të

Zinjtë janë të pabarabartë” në përgjithësi. Secili ia del në mënyrë perfekte në habitatin në të cilin ka jetuar për një kohë të gjatë, sepse është përshtatur me karakteristikat e tij, ndërkohë që e ka të vështirë në një vend tjetër. Mosnjohja e një fakti të tillë, kaq të rëndësishëm në lidhje me natyrën tonë – të njëjtë në këtë rast me atë të botës së kafshëve – është e barabartë me mizori. Kjo është arsyeja pse unë dhe e gjithë familja – edhe ajo e bashkëshortes sime – e kundërshtonin me aq forcë skllavërimin e të Zinjve...

ABE: Darwin, ndjesë, por mendoj se çështja nuk është kaq e thjeshtë. Në kohën e Calhoun-it, europianët kishin vetëm 200 vjet që kishin zbarkuar dhe jetonin në kontinentin e ri. Vendi kishte afro pesëdhjetë vjet që ishte shkëputur nga Anglia dhe, duke qëndruar në të njëjtin argument, asnjë nuk kishte në plan të kthehej edhe një herë në brigjet tuaja – mos e merr si mungesë respekti këtë vërejtje!

CHARLS: Patjetër që jo, Linkoln!

ABE: Dhe përsëri, më lejoni të them, pa mungesë respekti për librin tuaj të famshëm për *Origjinën e specieve*, se ishte e nevojshme që ligjberësit të ishin më të fokusuar në atë që mund t'i shërbente të mirës së përgjithshme në shoqëri. Për shembull, unë kurrë nuk kam besuar se të Bardhët dhe të Zinjët ishin të barabartë në termat e inteligjencës, por arrita të besoj se përpara ligjit duhej të ishin të barabartë dhe të meritonin të njëjtën mbrojtje. Sigurisht që ishte e mundur të qetësoheshin ata që vërtet e urrenin shoqërinë e të Zinjve, që nxitnin ndarjen në mjediset e ndryshme publike, përfshirë edhe shkollën, si të thuash duke ndjekur qasjen “të ndarë, por të barabartë”. Por dyshoj që kjo do e kënaqte Calhoun, që gjithsesi, e shihte skllavërimin gjithashtu si një barrë, jo vetëm për të Zinjët, por edhe për të Bardhët. Nëse do të kishte qëndruar edhe ndonjë dekadë më shumë, mendoj se Lufta ndërmjet Shteteve do të kishte shpërthyer më shpejt.

SHEILA: Në rregull, Abe, nuk më pëlqen t'u a jap unë lajmin, por pas Luftës Civile, Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës adoptoi saktësisht qasjen tuaj, “të ndarë, por të barabartë” – dhe këtu kam parasysh në gjithçka, pa përjashtim – gjë që vetëm e vonoi arritjen e plotë në barazinë e të drejtave për të Zinjët. Në fakt, Kongresi e kaloi ligjin “Për të Drejtat Civile” në vitin 1964, domethënë afro 100 vjet pas mbarimit të luftës tuaj civile dhe vetëm nga kjo kohë, doktrina “të ndarë, por të

barabartë” filloi të dënohej gjerësisht. Thënë ndryshe, u përkufizua si “të luash politikë” me jetën e njerëzve.

ABE: Pra, që nga koha ime, shkencëtarët kanë arritur më në fund të tregojnë se të gjitha racat – të Bardhë, të Zinj, Indianë etj. – janë intelektualisht të barabartë?

SHEILA: Jo tamam... Do shtoja është pyetja e gabuar që bëhet zakonisht.

ABE: Kuptoj! Domethënë në këtë kohë, shkencëtarët janë shndërruar në politikanë? Këtë po përpiqeni të shpjegoni?

SHEILA: Abe, nuk e prisja këtë vërejtje nga ju. Në çdo rast, shakatë lejohen vetëm nga mua dhe Xheki! **[i bie me dorë tavolinës]** Tani le t’u kthehemi edhe një herë argumenteve tona, ish-z. President që ke përgjigjen gati për gjithçka! Në dy raste u shprehët se nuk mendoni që të Zinjët dhe të Bardhët zotërojnë inteligjencë të barabartë. Pyes, mos është ndonjë lloj kodi për të nënkuptuar se nuk janë pjesëtarë të së njëjtës specie? **[papritmas kupton se çfarë ka thënë]** Ndjesë, nëse mendoni që pyetja ka nuanca provokative! Por ju lutem, na ndriçoni!

ABE [qesh]: Oh, nuk mendoj! Në fakt, besoj se për këtë argument flas edhe në emër të Calhoun. Në kohën time, njerëzit mendonin se të Zinjët dhe të Bardhët i përkisnin të njëjtës specie, kryesisht sepse të Zinjët mund të konvertoheshin në të krishterë. Sigurisht që një shpjegim i tillë nuk përmbushte të gjitha llojet e debatit për çështjen në fjalë, por ishte një kriter që përdorej gjerësisht dhe elementë të tij gjendeshin, për më tepër, edhe në Ligjin Ndërkombëtar.

SHEILA: Sa e çuditshme!

ÇARLS: Sa *fatale*!

ABE: E çuditshme ndoshta – të paktën për kohën tuaj – por fatale? Nuk do të shkoja deri në terma të tillë. **[Kthehet nga SHEILA]** Të paktën njerëzit nuk më akuzojnë, sikur të kem pasur frikë nga Zoti. Nga ana tjetër, ndoshta nuk i vlerësoni sa duhet mesazhet që përcjell. Për shumë njerëz, nëse keni aftësinë ta gjeni veten në Bibël, do të thotë të jesh human... u duket sikur nëpërmjet saj mund të tregojnë historinë e tyre. Ndërsa ata që besojnë edhe më shumë, të jesh human do të thotë të pranosh se Jezusi vdiq për të larë mëkatet e njerëzve.

ÇARLS: Linkoln, më thuaj që nuk i besoni budallallëqe të tilla!

ABE [pauzë e shkurtër, që të jep përshtypjen se po i zgjedh me kujdes fjalët që thotë]: Nuk i besoj, por sigurisht jam në *brendësi* të vlerës që kanë. Ndoshta është politikani brenda meje që po flet në këtë rast, por njohja e domethënies që ka *Shkrimi* për jetën e njerëzve të ndryshëm gjithmonë më ka befasuar, në kuptimin për standardet e mira që vendos për të jetuar jetën në një shoqëri civile. Kjo është arsyeja pse gjithnjë përfshija pasazhe biblike në fjalimet e mia më të rëndësishme. Vija re që këto pasazhe ishin në gjendje të nxirrnin te audienca që më ndiqte vlerat më të mira, më humane, veçanërisht kur ishte e orientuar nga urrejtja dhe ndasia. **[ÇARLS duket i habitur, por edhe dyshues]**

SHEILA: Mendoj që leximi i Biblës nuk mund të klasifikohet në leximet e lehta, veçanërisht po të kesh në vëmendje që libra të ndryshëm bien në kundërshti me njëri-tjetrin - të paktën për natyrën e Zotit, si dhe të perceptimit të lidhjes së jetës së tij me tona...

XHEKI: Sheila, nuk është vendi këtu të qahesh për rininë tënde, kaluar të dielave në shkollën e kishës!

SHEILA: Xheki, mos e nënvlerëso kaq shumë! Argumenti im është se një të kuptuar inteligjent të asaj se çfarë do të thotë të jesh i krishterë mund të jetë një test i keq për inteligjencën në përgjithësi.

ÇARLS [shumë i irrituar]: Zot – dua të them “Seleksionim Natyror!” – m’i kurse gjithë sa po dëgjoj! E gjithë linja e arsyetimit është sa kallpe, aq edhe sipërfaqësore.

XHEKI [qesh]: Duket sikur Çarls nuk është në humor!

SHEILA: Xheki, shët!

ÇARLS [i indinjuar]: Linkoln, ju folët për forcën civilizuese të Biblës, por harruat të përmendni gjithë ato vuajtje që ka shkaktuar. Njeriu juaj, Calhoun, ishte i tejmbushur me frymëzime biblike, nga ato më të spikaturat. Dhe sigurisht, do më thoni se kemi jetuar në një periudhë, kur britanikët – në të vërtetë, të gjithë popujve të Europës që iu dha kjo mundësi – ishin aq të bindur në rreshtimin kristian, sa këmbëngulën ta shndërrojnë edhe gjithë pjesën tjetër të botës në të ashtuquajturin imazh të tyre, në ngjashmëri me të. Arritën të pushtojnë edhe kulturat e lashta dhe të civilizuara të Azisë, dhe

i riorganizuan pa miratimin e vendasve. Kurrë nuk e kam përkrahur moskockëçarjen që manifestuan në ndërtimin e kësaj perandorie, pavarësisht politikave djallëzore që u përdorën dhe u përmblodhën në togfjalëshin “luftë për mbijetesë”. Lufta sigurisht mund të jetë e vërtetë, por ndodh në nivelin e mjedisve fizikë të veçantë, aty ku organizmat kalojnë ditët e tyre. Është tërësisht jashtë logjikës të flasësh për luftë për mbijetesë në botë, *si e tërë*, sikur disa specie duhet thjesht të mbizotërojnë planetin, të lëvizin nga një vend në tjetrin dhe të jetojnë ku u pëlqen.

XHEKI: Sigurisht, Çarls, ju nuk keni dëgjuar kurrë për aeroplanët dhe as edhe për profesorët e jashtëm! Ne po përpiqemi të përshtatemi sa më shumë, njësoj si bubuzhelët e shtëpive! [**ÇARLS duket edhe i mërzhitur, edhe i çuditur**]

SHEILA: Xheki do të thotë që...

ÇARLS [e ndërpret]: Dëgjo, dëshiroj ta lëmë mënjane subjektin krishterim - mendoj se dalim jashtë teme. Gjithsesi, dua t’i kthehem fillit të argumentit tonë dhe shpresoj ta zgjerojmë edhe më shumë, të themi si arrini, në kohën tuaj, të dalloni “të drejtën” nga “e gabuara” për çështje të ndryshme, për shembull në lidhje me racën.

[**XHEKI i tërheq vëmendjen SHEILA-s, duke i treguar orën, për ta lajmëruar që është koha për një ndërprerje**]

SHEILA [duke e rritur shumë ritmin e të folurit]: Çarls, argumenti që shtruat është vërtet i mrekullueshëm, por na duhet të bëjmë një ndërprerje të shkurtër. Do të rifillojmë, edhe një herë, pas prezantimit të mbështetësve financiarë të kësaj shfaqje.

ABE dhe ÇARLS, së bashku: “Mbështetës financiarë”?

SHEILA: Po, mbështetës financiarë. Jeta nuk do të kishte këtë vlerë që ka, në këtë stad evoluimi që jemi, nëse nuk do të na duhej të përballeshim me sfida të reja – dhe në ditët tona këto vijnë, kryesisht, nga shumëllojshmëria e produkteve që luftojnë për të tërhequr vëmendjen e dashurinë tonë. Radhën e kanë mbështetësit tanë financiarë, për të na dhënë këshilla se si të mbijetojmë në xhunglën konsumatore. [**i drejtohet audiencës direkt**]
Shihemi përsëri në X minuta!

PUSHIM

SHEILA: Çarls, përpara ndërprerjes, ju drejtuat pyetjen se si e trajtojmë problemin e racave sot. Nuk pretendoj ekspertin, por po provoj t’ju krijoj një ide, sikur edhe të përgjithshme, se si ka “evoluar” mendimi ynë. Në kohën tuaj, sikundër mund ta dëshmoni ju dhe Abe, ka pasur mënyra të ndryshme gjykimi, nëse dikush i takonte një race apo një tjetre, gjë që ndikonte seriozisht edhe në shanset që i jepeshin për ta jetuar atë jetë. Sigurisht që disa indikatorë kishin bazë më të fuqishme shkencore se sa të tjerë, por në konkluzion nuk kishte një koherencë në të kuptuarin e racës. Kështu, tabloja e përgjithshme dukej më shumë politike. Gjithsesi, Çarls, edhe ju keni pjesën tuaj të fajit. Përpos të gjithave, ju vetë i klasifikuat speciet nga përmasat, forma dhe struktura – ndryshe nga ... **[është në përpjekje për të gjetur fjalën e duhur]** – më ndihmo, Xheki, të lutem!

XHEKI: Morfologjia!

SHEILA: Morfologjia! Kështu, nuk është për t’u habitur që njerëzit filluan të bëjnë përgjithësime për racën bazuar në përmasat e ballit, dukshmërinë e mollëzave, largësinë e syve nga njëri-tjetri e të tjera të kësaj natyre. Në fakt, ne kemi një fjalë për gjithë këto manovra. Çarls dhe Abe, ndoshta mund t’ju kujtohet një lodër që u shpik në fillimet e fotografisë, e quajtur ‘stereoskopë’.

ÇARLS: Po, sigurisht, më kujtohet. Të krijonte iluzionin e hapësirës tre-përmasore, krijuar me ndihmën e dy fotografive të ndryshme të të njëjtit objekt, i cili vështrohej me ndihmën e një palë lenteve prej xhami.

SHEILA [e ndërpret]: E thatë mirë! Në vitet 1930, sociologët ranë dakord, se termi “stereotip” karakterizon iluzionin e “racës”, prodhuar kryesisht nga korrelacioni i karakteristikave sipërfaqësore të individit. Por në mesin e shekullit të njëzet pranohej gjerësisht - të paktën nga shkencëtarët – se atributet e racës nuk janë më shumë se thjesht stereotipe. Për më tepër, disa antropologë shkuan edhe më tutje, duke i cilësuar si “një nga legjendat më të rrezikshme në lidhje me njeriun”.

ÇARLS: Dakord, ndonëse mendoj se kësaj çështje po i kushtohet më shumë rëndësi se sa duhet. Gjithsesi, në çdo rast, kurrë nuk kam menduar se dijet tona rreth karakteristikave të racës ishin aq të mira sa duheshin! Për shembull, sa për të na siguruar hartimin e politikave sociale bazuar në to...

SHEILA [e ndërpret]: Argumenti juaj është shumë i mirë! Ndonëse nuk mund të thuhet e njëjta gjë për shumë nga ndjekësit tuaj... edhe për ata të ditëve tona.

ÇARLS [përmbledh]: ... akoma, për një individ të caktuar, nevojiten njohuri për disa breza, për të përcaktuar se cila karakteristikë është vërtet e përhershme në atë familje.

SHEILA [disi e befasuar] Dakord, kjo që thoni më kujton nëntitullin e veprës tuaj madhështore, në të cilën pranoni se racat janë ato që mbetën te speciet kur filluan të ndahen. Por duket se po aty, nuk ka një dallim të qartë ndërmjet racave dhe specieve, duke theksuar, në këtë rast, se nuk duhet të bëjmë me faj admiruesit tuaj nëse mendojnë se çfarë është e mirë për patën, është po aq e mirë edhe për patokun. **[konfuze]** Nëse vështrimi i një reptili përcakton llojin e species që i përket, përse nuk mund të themi të njëjtën gjë edhe për humanoidët – ose hominidët - apo si i quani ju, kategorinë në të cilën bëjnë pjesë njerëzit!

ÇARLS [disi i dëshpëruar]: Dakord, më dëgjo, dëshironim të dinim, në parim, se cila ka qenë arsyeja që njerëzit dhe kafshët janë ashtu si janë, por maksimumi që mundëm të arrinim ishte një ekzaminim statistik i strukturës, formës dhe përmasave të tyre. Personalisht, kam përshtypjen se evolucioni i jetës mbart të gjitha shenjat e një paraardhësi të përbashkët, në mos të një origjine të përbashkët, për të gjitha speciet. Por kurrë nuk mundëm të kuptonim mekanizmin. Kështu, gjithë sa arritëm ishte parashtrimi i disa pikëpamjeve, të cilat për hir të së vërtetës nuk qëndronin shumë mirë me njëra-tjetrën. Sigurisht, ishim në dijeni të eksperimenteve të shumta që bënë fermerët, për shekuj me radhë, duke krijuar fara të reja bimësh apo lloje të reja kafshësh, të gjitha për konsum njerëzor. Por edhe mësimet e atyre eksperimenteve dukeshin jobindëse: këto bimë dhe kafshë ishin vërtet specie të reja, apo thjesht zotëronin disa karakteristika të reja, nxitur me forma të ndryshme artificiale, por të cilat do të zhdukeshin me kalimin e kohës, ndërkohë që pasardhësit e këtyre çiftëzoheshin me të tjerë, me karakteristika thjesht normale.

SHEILA: Më lejoni t’u siguroj, se që në shekullin e 20-të, shkencë ka zhvilluar një degë të re, në gjendje t’u përgjigjet të gjitha pyetjeve të juaja - gjenetika!

ÇARLS: Më tingëllon si “Gjeneza”!

SHEILA: [qesh] Dakord jam me ju! Edhe mua ashtu më tingëllon! Veçanërisht po të shtoj që në ditët tona, gjenetika i është afruar shumë krijimit të jetës. Për më tepër, për disa njerëz ka marrë edhe “rolin e Zotit”. **[ÇARLS është dukshëm i shqetësuar, ABE është kureshtar]** Por nuk mendoj se duhet të humbasim vëmendjen ndaj argumentit tonë, pra çfarë është raca dhe baza biologjike e saj.

ÇARLS: Më duket se e kam radhën unë t’ju ndërpres, sepse kam probleme me fjalën “biologji”. Kurrë nuk e kam quajtur veten “biolog”, për më tepër që për veshët e mi tingëllon disi si *Lamarckian*.

SHEILA: Vërtet, rivali juaj i madh Lamarck e shpiku si term... A nuk ishte ai evolucionisti i parë modern?

ÇARLS: Do të thoja pasi termi doli në modë! Lamarck besonte se organizmat kërkojnë të evoluojnë – domethënë që jo vetëm provojnë të përshtaten me kushtet e mjedisit, por në një farë mënyre ia dalin t’i transmetojnë dijet që kanë fituar për këtë mjedis te pasardhësit e tyre, kështu që ata e nisin jetën me më pak disavantazhe. Lamarck e mendonte jetën si të udhëhequr nga një forcë kuazi-shpirtërore, që funksiononte sipas mënyrës së saj, në format gjithnjë e më komplekse të materies.

SHEILA: Në terma bazikë, dakord, është e thjeshtë të përfytyrosh se Lamarck kishte në mendje termat e një prindërimi të mirë, për shembull ofrimi i sa më shumë mundësive për fëmijët, më shumë se ata vetë kishin pasur, si dhe gjëra të tjera të kësaj natyre.

ÇARLS: Dakord, sigurisht, me përjashtim të faktit që Lamarck besonte se të gjitha këto, në një mënyrë a një tjetër, ia dilnin të ishin pjesë e qelizave embrionale, të cilat shërbenin për prodhimin e pasardhësit. Për atë – dhe pothuaj sigurisht jo për mua – mjedisi është thjesht materiali bazë për organizmat për të latuar vetveten, pak nga pak.

SHEILA: Më duhet t’ju kujtoj se pikëpamjet e juaja nuk janë edhe aq të ndryshme.

ÇARLS: Duhet të thoni që portofoli im i pikëpamjeve është i ndryshëm kur bëhej fjalë për trashëgiminë e tipareve dhe në asnjë prej tyre nuk zë vend një mendim i tillë.

SHEILA: Në fakt, më duhet t’ju kujtoj që mbronit idenë se nuk kishte kuptim që gratë të merrnin shkollim pasi i kishin lindur fëmijët, sepse nuk u hynte në punë. Besoj se në mendimin tuaj gratë nuk duhej të punonin jashtë shtëpisë...

ÇARLS: Sigurisht që në atë kohë kishte shumë gra që punonin në fabrika, nëse është kjo që doni të thoni. Por rrallë ishin të arsimuara.

SHEILA [gjithnjë e më shumë e acaruar]: Kjo është saktësisht ajo që *nuk* po them!

ÇARLS [gjithnjë e më i interesuar për temën]: Në kohën time, shumë liberalë të mirë-shkolluar - përfshirë të respektuarin John Stuart Mill – u angazhuan në kauzën për shkollimin e grave, sepse vetëm në këtë mënyrë do kishin mundësi të luanin një rol më aktiv në jetën publike, ndoshta edhe duke fituar të drejtën për të votuar në zgjedhjet lokale apo të përgjithshme. Pikëpamja ime ka qenë se mund të përdorëshin mënyra shumë më të drejtpërdrejta për të lehtësuar barrën e grave, si për shembull, duke monitoruar shkallën e lindjeve të grave të varfra. Në këtë rast, shkollimi i grave duhet të promovohet strategjikisht, jo sentimentalisht.

SHEILA: Dakord! Por në kohën tonë mendojmë dhe veprojmë ndryshe! Çarls, kam kënaqësinë t’ju bëj me dije, se si shkenca, ashtu edhe politikat tuaja, për këtë rast nuk janë ato që duhet të jenë. Të lutem, duhet ta ndërpresim përsëri, sepse e anashkaluam edhe një herë argumentin “racë”. Gjithsesi, përpara se të vazhdojmë më tej, kam dëshirë të bëj një rrëfim: pikëpamjet tuaja për racën, në mendimin tim, jo vetëm që janë të pabesueshme, por ndoshta janë më të pabesueshme edhe se ato të Abe-s. Sigurisht që kuptoj pragmatizmin e Abe-s si politikan, që fitonte relativisht pak, por humbte shumë më tepër, nëse do të vazhdonte të mbronte praktikën e skllavërisë, pavarësisht nëse mendonte se të Bardhët dhe të Zinjët ishin thelbësisht të barabartë.

[ABE përpiqet ta ndërpresë, por i mbyllin mikrofonin.]

SHEILA: Edhe diçka tjetër, Çarls – me shpresën që nuk ju vjen keq për çfarë do them. Mendoj se në situata të ndryshme, jeni shprehur ndryshe. Kështu, ndonjëherë, kur jeni “më shumë racist”, theksoni se speciet e reja dolën nga popullata relativisht të izoluar, falë përshtatjes, me kalimin e kohës, me karakteristika të caktuara të mjedisit fizik ku jetonin. Ndërsa herë të tjera, kur jeni “më pak racist”, shpreheni se popullata të ndryshme, në

fund të fundit, ndajnë të njëjtin paraardhës - të përbashkët për të gjithë. Në rrjedhje, përshtypja që të krijohet është që, specie të ndryshme, janë thjesht degë të një peme të jetës, që u lind nga një origjinë unike. Pra, si duhet të shprehem?

ÇARLS: Të dyja variantet janë në rregull. Bukuria e evolucionit është, se për një kohë sa duhet të gjatë dhe vetëm falë proceseve graduale të ndryshimit që mund të vëzhgojmë sot në natyrë, bëhet plotësisht e mundur të mendojmë se e gjithë gama e specieve i ka burimet në fillesat më të thjeshta organike. Në këtë mënyrë, nuk ka nevojë më të postulojmë as për ekzistencën e Zotit, si fillesa e këtij procesi, dhe as të vendosim kufij të pakalueshëm ndërmjet specieve, pra sikur Zoti ka krijuar secilën prej tyre. I gjithë procesi del jashtë fushës së teologjisë, tërësisht.

SHEILA: Kuptoj pse një teori e tillë mund të ketë disa përparësi. Por nuk ju shqetëson mendimi se bashkë me të këqijat e saj, po sakrifikoni edhe të mirat, ose si thotë populli, për një plesht djeg tërë jorganë.

ÇARLS: Si kështu?

SHEILA: Pak më parë u shprehët se humanët ndryshojnë nga kafshët e tjera me vetëm disa shkallë, që do të thotë se jemi vetëm një ndalesë e momentit në këtë proces pambarim evolucioni.

ÇARLS: Po.... dhe?

SHEILA: Në fakt, arsyeimi im të shpie në përfundimin se një gjë e tillë i de-humanizon njerëzit. Teologët, përpos të tjerave - përfshirë edhe dëshitimet e shumta që kanë pasur - të paktën u japin humanëve një status më të lartë se krijesat e tjera.

ÇARLS: Po... por vetëm duke postuluar subjekte të rreme super të natyrshëm, si për shembull shpirti i pavdekshëm!

SHEILA: Vërtet! Gjithsesi më shqetëson fakti, se ndonjëherë ju kaloni në ekstremin tjetër. Për shembull, tek *Origjina e njeriut*, ju pohoni se ndiheni më mirë të dini që keni të njëjtin paraardhës me një babun fisnik, se me anëtarin e ashpër të një fisi që rastisi të takonit në “Tokën e Zjarrit”.

ABE: Kjo do të thotë, atëherë, që nuk duhet të më mërzisë fakti që kundërshtarët e mi politikë, në mënyrë pothuaj rutinore, më dedikojnë

karikatura ku paraqitesha si babun – me sa duket nuk kam ditur ta vlerësoj si duhet komplimentin që më bënin! **[TË GJITHË qeshin]** Por t’i lemë shakatë! Darwin, në një paragraf tuajin, që duhet ta kem lexuar në kujtimet tuaja për kohën e kaluar në “Beagle”, shpreheni se më shumë metafizikë mund të mësoni nga një babun se sa – jo pak - por se sa vetë John Locke! Marrë në konsideratë ndikimin e jashtëzakonshëm që Locke ka pasur në hartimin e “Deklaratës së Pavarësisë”, më duhet të pohoj se kam një lloj pakënaqësie në lidhje me sa jeni shprehur. Përpos të tjerave, Locke është një nga ata që formuloi ekzistencën e humanitetit në termat e mbrojtjes së “jetës, lirisë dhe pronës”, të cilat Thomas Jefferson i përmbloodhi, në thënien e pavdekshme “të gjesh lumturinë”.

CHARLS [me ton sarkastik]: Nuk kam dyshim tashmë, pse e keni shmangur gjithnjë një qëndrim të qartë për skllavërinë!

ABE [duket i ofenduar]: Darwin, po përpiqemi të jemi serioz në këtë panel. Moderatorja ka të drejtë kur thotë që teoria juaj e trazon të kuptuarin tonë për njerëzimin.

CHARLS: Abe, kam frikë se nuk e kapët sensin tim të ironisë. **[veçan]** Pas disa brezash, ironia duket të jetë karakteristika e parë që *nuk* u përçoll nga anglezët kur zbarkuan në Amerikë. **[kthehet nga ABE]** Me përkufizimin e tij, Locke bëri të duket sikur *vetëm* njerëzve u ishin atribuuar të drejtat për mbrojtjen e jetës, lirisë dhe pronës. Nëse ka ndonjë pasojë etike nga Teoria ime e Evolucionit – dhe përgjithësisht ua le të tjerëve ta vendosin – është se të drejtat përfshijnë dhe janë të njëjta për të gjitha llojet e specieve.

SHEILA: Mos po sugjeroni se edhe kafshët – dhe ndoshta edhe bimët – kanë të drejtën për të jetuar dhe për të qenë të lirë, pra edhe për të gjetur lumturinë?

CHARLS: Thjesht po sugjeroj se na duhet të ndjekim provat, pavarësisht se ku na shpien – dhe ndoshta mund të na detyrojnë të merremi me argumente, që nga pikëpamja politike apo morale nuk jemi marrë kurrë më parë. Një shembull i qartë mund të jetë shqetësimi i mikut tim të mirë Thomas Henry Huxley. Ndoshta e mbani mend akoma debatin e famshëm që pati me Peshkopin Wilberforce, në Londër, të cilin e referojnë si arsyen e rritjes së ndjeshmërisë së publikut ndaj personit tim. Por pavarësisht kësaj, Huxley me profesion ishte kirurg. Ai e lexoi teorinë time dhe kuptoi se kafshët mund të përdoren për kërkime shkencore për të modeluar

sëmundjet që prekin njerëzit. Dhe akoma më shumë, mbështeti diseksionin e kafshëve, duke e përkufizuar si të nevojshëm për t'i dhënë mjekësisë mbështetjen e duhur shkencore. Është e qartë që Huxley u përpoq të përdorte të gjitha sa më sipër – sipas tij, rrjedhoja të teorisë sime – për të përforcuar vlerat tona, pra të njerëzve, në krahasim me ato të krijesave të tjera. Natyra e kafshës që gjendet thellë, brenda nesh, e nxiti të besonte se mund të përdorim kafshët për të kuptuar veten tonë. Këmbëngulja e tij e vazhdueshme për varësinë e jetës së kafshëve ndaj nevojave të njerëzve gjithnjë më ka befasuar, aq sa për të vënë në pikëpyetje se çfarë ka mbetur nga gjithë ai besim i krishterë me të cilin është rritur.

SHEILA: Ndoshta nevoja e vazhdueshme e Huxley-t për të nxjerrë jashtë vetes demonët e vjetër fetarë shpjegon nevojën për të luftuar klerikët, shumë më tepër se sa i luftuat ju?

ÇARLS: Realisht, nuk kam dëshirë të bëj ndonjë koment për këtë motiv të Huxley-t. Ishte një person me shumë më tepër interesa se sa unë. Gjithsesi, mendoj se duhen vënë shumë faktorë në balancë, si afërsia empirike e njerëzve me kafshët me sistem nervor të zhvilluar, imperativi moral i përgjithshëm për të minimizuar vuajtjet e të gjitha krijesave apo edhe karakteri me ulje-ngritje i përpjekjeve për ta shndërruar mjekësinë në një shkencë të vërtetë dhe, të gjitha bashkë - këto që kam përmendur e të tjera po aq të rëndësishme – ose edhe veç e veç, duhet të na bëjnë shumë të kujdesshëm kur të vendosim, nëse duhet apo jo të sakrifikojmë jetët e një numri të madh kafshësh për shpresën spekulative të zgjatjes së jetës së disa pak njerëzve. Sigurisht, me këtë nuk dua të them që kërkimi shkencor në mjekësi me bazë kafshët nuk është kurrë i garantuar, por këmbëngul që qasja për një çështje të tillë duhet të jetë kujdesi i madh – dhe do ta shpreh në publik, sa herë të mendoj që është e dobishme.

SHEILA: Është shumë keq që nuk e kemi Huxley-n këtu, mes nesh! Do të ishte interesante të kishim opinionin e tij dhe, realisht - **[drejton gishtin nga ÇARLSI]** – edhe opinionin tuaj në lidhje me rritjen e rezistencës së organizuar ndaj kërkimeve shkencore me bazë kafshët, veçanërisht ato të dedikuara për nevojat e mjekësisë për të shëruar njerëzit. Në këta pesë vitet e fundit kemi qenë dëshmitarë, në Europë dhe më gjerë, të protestave të organizuara nga grupe të ndryshme dhe po aq shpesh edhe të kërcënimeve e akteve të dhunës ndaj shkencëtarëve që i kanë përdorur kafshët për synime të kësaj natyre. Dhe rezultatet kanë qenë të tilla që janë shoqëruar edhe me

lirimin e krijesave nga kafazet ku mbaheshin të mbyllur, gjithnjë në emër të “të drejtave të kafshëve”.

ÇARLS: Të drejtat e kafshëve? Një frazë e tillë tingëllon çuditshëm për veshët e mi. Unë jam mësuar ta shoqërizoj “të drejtën” me diçka që ka lidhje me politikën, ose më e pakta ta perceptoj, ndoshta, edhe si të natyrës teologjike. Tashmë jam i sigurt: evolucioni nuk paska bërë përpara me ritme të shpejta!

SHEILA: Jo, por njerëzit kanë arritur të mësojnë më shumë rreth kafshëve – për kapacitetin e tyre për të menduar dhe ndjerë. Pjesa më e madhe e kërkimeve të kësaj natyre, që sot klasifikohen në disiplina si “psikologjia evolucionare”, “etologjia” dhe, më e kundërshtuara e që po ngjall debate të shumta, “sociobiologjia”, në fakt janë frymëzuar ekskluzivisht nga puna juaj.

ÇARLS: Më duket se ka diçka që nuk po e kuptoj. Pse është e nevojshme prania e një lëvizje për *të drejtat* e kafshëve, kur mund të kishte thjesht një lëvizje për të kundërshtuar mizorinë ndaj tyre, ashtu si ishte në kohën time? A nuk është apeli për të drejtat e tyre pak i tepruar?

SHEILA: Po, ka shumë që shprehen në të njëjtën formë. Por, me shumë gjasë, ajo që nuk kuptoni është një rritje masive e kërkimeve shkencore në laboratorë, bazuar në kafshë, krahasuar me kohën tuaj. Duket se pikëpamjet e Huxley-t kanë gjetur terren. Shkencëtarët i studiojnë kafshët në laboratorë shumë të kontrolluar, ku synimi kryesor dhe final është përfitimi i racës njerëzore, sigurisht pa mohuar që jo rrallë synimi është edhe studimi i kafshëve, njohja e tyre. Dhe ndërkohë që shkencëtarët mësojnë gjithnjë e më shumë se sa interesante janë krijesat e botës jo-njerëzore, është gjithnjë tundimi për më shumë. Në fund të fundit, çfarë i bën mushkonjat të jenë aq të etura për gjak njeriu? Gjithsesi, dua të deklaroj që, aktualisht, çdo shkencëtar që kërkon të ndërmarrë një studim ku përfshihen kafshë, duhet të shprehë angazhimin dhe besnikërinë ndaj **[bën shenjën e thonjëzave]** “kodit të etikës së kërkuesit shkencor” përpara se ta fillojë eksperimentin.

XHEKI [e ndërpret]: Dhe përsëri kjo nuk është, sa duhet e mirë, për disa njerëz. Ata synojnë t'i mbyllin plotësisht laboratorët e kësaj natyre, sepse besojnë se çdo eksperiment me kafshë nuk është gjë tjetër, përveç se torturë. Shpresoj se e kuptoni ironinë e kësaj situatë! Çarls, këta që protestojnë kaq shumë për të drejtat e kafshëve, nuk do të kishin asgjë

kundra nëse vetë shkencëtarët nuk do të kishin qenë të aftë të kryenin eksperimente që tregojnë pikërisht shkallën e plotë të aftësive të kafshëve, që do të thotë kanë mundur të shkojnë përtej kushteve që natyra u ofron kafshëve.

ÇARLS: Aha... domethënë kafshët nuk studiohen më në habitatin e tyre natyror, aty ku kanë lindur?

SHEILA: Sigurisht, kanë ndodhur dhe po ndodhin shumë ndryshime, por faktikisht çdo gjë shkon në laborator – veçanërisht eksperimentet e llojit bio-mjekësor, pra pikërisht ato lloj eksperimentesh që janë target i protestave. **[ÇARLS duket në mëdyshje]** Por ndoshta pikërisht ajo që nuk po arrini të kapni është se aktualisht, në ditët tona, jemi në gjendje të hetojmë shumë më tepër dhe më mirë mekanizmat bazë të jetës, krahasuar me atë çfarë arrihej në kohën tuaj.

XHEKI: Po, Çarls. Kam lexuar disa nga të ashtuquajturit eksperimente të kohës suaj, dhe më duhet të pohoj që nuk të bëjnë shumë përshtypje, për më tepër që janë larg standardeve e pritshmërive që kemi ne sot. **[ÇARLS duket i indinjuar]** Më kujtohet që ju vetë keni studiuar mënyrat e ndryshme me të cilat disa insekte mbrohen nga drita, ndërsa studiues të tjerë po të kohës suaj, janë marrë me llojet e ushqimeve që u duhen për të mbijetuar.

ÇARLS: Në fakt, në kohën time, kanë qenë ndër eksperimentet më të mirë. Nuk e di nëse ju keni mundur të bëni edhe më të mirë?

XHEKI: Sot, në kohën tonë, mund të ri-ndërtojmë lloje bimësh që mund të hanë gjithçka, ndërkohë që kanë aftësinë të gjenerojnë vetë dritë! **[ÇARLS duket i tmerruar]**

SHEILA [në përpjekje për të mbajtur të qeshurën]: Mos u shqetëso, Çarls. Xheki thjesht po përpiqet të bëjë shaka, të na bëjë për të qeshur. Gjithsesi, argumenti që ngre qëndron, por do t'i kthehemi pak më vonë... **[kthehet nga ABE]** Tani, Abe, pak më përpara, krijova idenë sikur nuk e besoni plotësisht teorinë e evolucionit të Darvin-it. Është e vërtetë?

ABE: Për fat të keq, nuk mund të them që e kam studiuar me shumë kujdes *Origjinën* e Darvinit, që më duhet të pohoj, në të njëjtën kohë, se është edhe vepra më madhështore e tij që më ka rënë në dorë. Duket se produktivitetin si autor e ka arritur vonë. **[qesh]** Në fakt, pak libra kam lexuar me shumë

kujdes. Për shembull, mund të veçoj Biblën, Shekspirin dhe poetët e mëdhenj anglezë. Kam lexuar edhe një libër për evolucionin, nga fillimi deri në fund, mos të them brenda ditës – dhe jam i sigurt që edhe Darvini duhet ta ketë lexuar në të njëjtën formë. Prit... më duket se mu kujtua edhe titulli... “*Rudimentet në historinë natyrore të krijimit*”. Po, ky duhet të jetë titulli! **[ÇARLS pohon me kokë]** Besoj se ka dalë në qarkullim në kohën kur unë sapo kisha filluar punë si jurist në Springfield, Illinois – ndoshta më shumë se një dekadë përpara botimit të veprës suaj madhështore...

ÇARLS: Fiks! Skandali që shoqëroi publikimin e *Rudimenteve* më detyroi të vonoj publikimin e studimit tim – në botimin e parë të *Origjinës*, e ndjeva moralisht të drejtë ta distancoja veten nga *Rudimentet*.

XHEKI: *Rudimentet* ka qenë vërtet skandaloz. Por nga të dhënat që kemi, të paktën deri në fillimet e shekullit të njëzet, ky libër ka shitur rregullisht shumë më tepër kopje se sa *Origjina e specieve* – të themi të dy librat kanë qenë në qarkullim për të paktën pesëdhjetë vjet.

SHEILA: Por çfarë, saktësisht, e bëri kaq skandaloz?

ABE: Çfarë të them... skandali është te dera kur autori shfaqet si “anonim”!

ÇARLS: Por nuk kaloi shumë kohë dhe u zbulua që autori ishte një sipërmarrës dhe botues skocez, Robert Chambers, që e dashuronte natyrën dhe amator i zjarrtë pas saj dhe seleksionimit. Mund ta njihni edhe si botues fjalorësh.

SHEILA: Po, fjalorët e tij janë ende në qarkullim.

ÇARLS: Faktikisht, Robert Chambers propozoi një teori evolucioni që është pothuaj në koherencë të plotë me frymën e Lamarck – *çdo gjë* evoluon, duke filluar nga sistemi ynë diellor dhe me radhë, të gjitha. Chambers paraqet një bashkësi faktesh që, për më tepër, i përshkruan me metafora shumë të goditura: më shumë art dhe më pak diskriminim. Ai dinte edhe më pak se unë për mekanizmat e trashëgimisë, por ishte i sigurt në vetëm një gjë: Zoti thjesht e vuri të gjithë procesin në lëvizje. Dhe nëse ka ndonjë konkluzion që mund të nxirret nga vepra e tij, është vetëm kaotizmi i të gjithë procesit. Dhe ky është aspekti vërtet skandaloz i tezës së Chambers. Zoti jo vetëm që nevojitet shumë pak, por edhe aty ku përdoret është me shumë kufizim. Në librin e tij, Zoti është pothuaj *tërësisht* i panevojshëm...

SHEILA [e ndërpret]: As ju nuk e bëtë Zotin të nevojshëm?

ÇARLS: Po, vërtet! Unë, në fakt, nuk kam nevojë *fare* për Zotin. Në librin tim e them qartë se seleksionimi natyror, lëvizësi kryesor i evolucionit, është një koncept tërësisht vetë-shpjegues. Por Chambers, jo! Chambers të krijon përshtypjen se të gjitha speciet që lindin e zhduken – për shembull, nga vrasjet masive apo fenomene të tjera të ngjashme me të – është më e mira që mund të bëjë Zoti dhe se nuk ka shpresë për ndonjë lloj ndërhyrje hyjnore ose mrekulli që do mund t'i bëjë gjërat më mirë se sa janë. Chambers provon të argumentojë se të gjitha këto e drejtojnë gishtin tek një vetëpërmbytje hyjnore, që ne njerëzit mund ta kapim në një mënyrë shumë imperfekte! Por një mësim i tillë nuk përshtatet shumë mirë me një publik të etur për të mësuar për një hyjni që vepron sipas një plani, njohja e të cilit mund të frymëzojë intelektin e njerëzve për të përfunduar çfarëdo hollësie që ka mbetur.

ABE: Nga sa po thoni, mund të them se jeni përkrahës dhe admirues i përpjekjeve të z. Chambers.

SHEILA: Sigurisht! Përpos të gjithave, ju jeni një evolucionist!

ABE: Aktualisht, më mallëngjen koncepti i tij për Zotin, sipas të cilit për krijimin tonë janë përdorur imazhi dhe ngjashmëritë me të. **[ÇARLS duket i çuditur.]** Por, Darwin, pavarësisht se çfarë themi, të lutem mos u mërzit...

SHEILA [e ndërpret]: Abe, prit një minutë! Nuk kemi ndonjë material që dëshmon të jeni shprehur në këtë mënyrë në lidhje me ndonjë lloj kishe.

ABE: Jeni krejtësisht korrekte! Dhe një gjë e tillë më ka shkaktuar pafund pikëllim në karrierën time politike. Gjithsesi, e kam lexuar rregullisht Biblën. Kryesisht për dy arsye: për t'u ndier mirë, si dhe për ta pasur si udhërrëfyes shpirtëror. E kam lexuar edhe më shumë pas shpërthimit të luftës ndërmjet shteteve. Në këto rrethana, shpesh ndihesha si Job! Besoj e kuptoni për kë e kam fjalën...

SHEILA: E kuptoj, por më duhet t'ju ndërpres. Kthehemi pak prapa... U shprehët që ju pëlqen mënyra se si shfaqet Zoti tek *Rudimentet*.

ABE: Gjithnjë kam besuar, se nëse ka një Zot, nuk ka arsye pse puna e tij të jetë tërësisht transparente për mendjen njerëzore. Nga ana tjetër, nëse një

njeri mund të kuptojë mënyrat e tij inteligjente të punës, atëherë edhe ne mundemi – dhe ndoshta mund t’i përdorim për të mirën tonë...

SHEILA: Tani e kuptoj pse nuk iu bashkuat kurrë ndonjë kishe – në fund të fundit, nuk i përkisni asnjërës!

XHEKI: Shumë e bukur! Më ngjan si ndonjë nga ato shakatë e vjetra të Groucho Marks, treguar në një kohë tjetër, por që vlejnë ende edhe për kohën tonë!

ÇARLS: Groucho Marks... mos është ai burri që më dërgoi një kopje të librit të tij?

XHEKI: Jo nuk është ai... Ky është ai Marksi i dytë që ka jetuar në SHBA – dhe është marrë me shfaqjet komike! Është një komedian shumë i famshëm që ka jetuar shekullin e kaluar dhe ka pasur të njëjtin mbiemër me atë që ju ka dërguar librin. Edhe ky Marksi tjetër - pra i dyti në radhë – ka shkruar një ese shumë të bukur, ku gjykon se historia ndodh dy herë, herën e parë si tragjedi dhe të dytën si farsë. **[ÇARLS tund kokën, por përsëri i paqartë]** Duhet ta kishit parë sa bukur interpretonte! Nuk e keni pasur atë fat, jam e sigurt! Por, Abe, ju lutem, vazhdoni me analizën tuaj për natyrën e Zotit! Ndjesë për ndërprerjen!

[SHEILA sheh me inat XHEKIN që largohet]

ABE: Faleminderit, ndonëse nuk jam i sigurt se sa interesante do i gjeni analizat e një teologu amator... Unë besoj se edhe në Jug, edhe në Veri, ishin korrekt në pretendimin për të vepruar në përputhje me vullnetin e Zotit. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë që si njëri, ashtu edhe tjetri, apo në fund të fundit edhe të dyja palët, të mos jenë të pasaktë në të kuptuarin e rolit që Zoti ka shkruar për ta.

ÇARLS: Lincoln, tani po më ngjani si një *kalvinist* i thekur! Argumenti tjetër i juaj është që Zoti e ka paracaktuar fatin e njerëzve, duke i ndarë në ata që duhen shpëtuar dhe në ata që jo.

ABE: Qetësohuni, i dashur! Gabimi ka brenda lirinë, e cila në rrjedhojë ka pasoja – pasoja që shkaktojnë probleme për Zotin. Zoti e ka krijuar Universin që të funksionojë me ne *dhe* pavarësisht nga ne.

ÇARLS: Linkoln, po filloni të më dukeni si ata mitikët e Lindjes! Ose flisni qartë, ose lëreni fare!

SHEILA: Ritëm, Çarls!

ABE: Po ju tregoj mënyrën për të menduar se çfarë kam në mendje, e cila mund të ketë qenë fare mirë edhe ideja e Chambers. E kam marrë këtë ide nga Tom Paine, një ish-britanik, i cili kishte prirjen interesante për të nxitur revolta kudo që shkonte. Paine ishte njeriu kryesor që nxitu Baballarët e Kombit tonë të hartonin “Kartën e të drejtave” në Kushtetutë. Ndoshta, po të kishte qëndruar në Britani, edhe ju do të kishit sot një kartë për të drejtat e njeriut. Apo e keni hartuar?

SHEILA: Jo, nuk kemi, ende.

ABE: Gjithsesi, Paine ishte një *deist*, që adhuronte mënyrën se si hyjnorja qeveris një planetariumin.

SHEILA: Planetarium?

ABE: Po, planetariumin. [Sheila mbledh shpatullat, akoma në gjendje injorance] OK, më lejoni t’ua shpjegoj. Praktikisht është modeli mekanik i sistemit diellor që përdorim për të demonstruar se si funksionojnë Ligjet e Njutonit. Për shembull, nëse Toka gjendet në një distancë të caktuar nga Dielli në trajektoren e rrotullimit rreth tij (të themi ka përshkruar gjysmën e orbitës), atëherë edhe të gjithë planetët e tjerë që lëvizin në orbitat e tyre, ndodhen në një distancë plotësisht të përcaktuar përsëri nga Dielli. Funksionimin e një planetariumi mund ta përfytyroni në dy mënyra. Mund të ndërtohet si një orë që funksionon në mënyrë automatike, që do të thotë se thjesht vëzhgoni planetët që lëvizin në orbitat e tyre respektive me shpejtësitë respektive. Ose mund të lëvizni një planet ju vetë dhe të vështroini se çfarë ndodh me lëvizjen e trupave të tjerë. Më pëlqen ta mendoj planin hyjnor që funksionon për ne, qeniet humane, sipas mënyrës së dytë: çfarëdo që të bëjmë, sado të çuditshëm apo të paparashikueshëm të jemi në sjelljet tona, në një mënyrë apo një tjetër kompensohet nga ajo që bëjnë të tjerët – secili në termat që Zoti ka shkruar për të.

SHEILA: Abe, kjo është pak a shumë delikate dhe e pakapshme për mua. Duket si një kombinim bastard i gjenetikës me astrologjinë.

XHEKI: Mos e nxit, Sheila, sepse më duket se Abe, me këtë lloj përkrahje që po i jep gjenetikës, shumë shpejt do të krijojë një qasje të re në nxitjen e saj. Sigurisht, nëse pranon të qëndrojë në këtë botë!

ÇARLS: Më vjen keq, Linkoln, por ky Zot super i sofistikuar i *deizmit* është tërësisht një mendim i dëshiruar. Po, Lufta Amerikane Civile ka qenë e përgjakshme dhe sigurisht që është e vështirë të bësh hesapet se kush, nëse ka pasur ndonjë, mund të pretendojë për fitore, pavarësisht nëse bëhet fjalë për fitore morale apo materiale. Por në fund nuk ka përgjigje për këto pyetje thjesht sepse vetë pyetjet janë të pakuptimta. Nga pikëpamja e evolucionit, ankthi juaj për këto çështje mund të jetë pak më shumë se sa një rrjedhojë e lehtë patologjike e zmadhimit të trurit të përpamë të specieve tona.

XHEKI: Kujdes, Çarls, më duket se po vjen radha t’i thoni Abe-t se do të ketë nevojë për lobotomi!

ÇARLS dhe ABE, së bashku: Çfarë?!

SHEILA: Pa problem, mos u shqetësoni! Një nga ato shakatë e tjera të Xhekit. Pyetja ime është shumë serioze tani: Çarls, keni besuar ndonjëherë, sikur edhe vetëm një herë, në një Zot tuajin?

ÇARLS: Po, kam besuar, dhe ishte ky Zot personal që më motivoi të përfshihej në studimin sistematik të Natyrës. Besoj se vetë Natyra përbën një Krijim Hyjnor, modelin e së cilës u përpoqa ta kuptoj. Në rininë time, në Kembrixh, kam adhuruar figurën e William Whewell, “Master of Trinity College”, dijetar, njohuritë e të cilit shtriheshin nga teologjia në gjeologji. Libri im, *Origjina e specieve* hapet me një epigraf kushtuar Whewell.

SHEILA: Mund ta gërmëzoni emrin e tij, ju lutem? Nuk mendoj se e kam dëgjuar ndonjëherë! [hedh vështrimin nga XHEKI; të dyja duken të çuditura nga emri që sapo dëgjuan].

ÇARLS: W-H-E-W-E-L-L. Whewell është themeluesi i “Shoqatës Britanike për Përparimin e Shkencës”. Ngado që ta marrësh, Whewell besonte se njerëzimi është fuqizuar për të zbuluar strukturën shkakore, shumë të rëndësishme, të universit! Si dhe të krenohet për karakterin e saj racional e gjithëpërfshirës. Njutoni kishte vendosur standardet dhe, ndonjëherë, vetë Whewell të krijon idenë se për të, Njutoni vjen i dyti në radhë, pas Jezusit. Gjithsesi, Whewell mendon që njerëzit duhet të trajnohen dhe të paguhën për t’u përfshirë në studime origjinale që kanë lidhje me natyrën, si pjesë e

rëndësishme e formimit të tyre, pavarësisht se do ju duhet thjesht për të kaluar kohën e lirë, apo do ta përdorin për të dhënë leksion – pra, për të mësuar të tjerët. Whewell-it i njihet merita e krijimit të fjalës “shkencëtar”, që është e përshtatshme për grupin e dytë cituar më sipër. Vitet e fundit të jetës sime, fjala “shkencëtar” gjeti përdorim të gjerë. Sa për mua, kisha një lloj ngurrimi ta përdorja për veten time, ndonëse të tjerët më respektonin pikërisht për këtë.

SHEILA: Çarls, duket sikur jeni më shumë se ç’duhet modest!

ÇARLS: Jo, më shumë se modest jam i ndershëm! Jam i sigurt se nuk të them çfarë e motivoi emërtimin e Whewell – diçka që ai e zgjodhi vetë në një analizë kritike që bën për *Origjinën* time. Sido që të bëhet, seleksionimi natyror *nuk* është një emër tjetër për Zotin! Por për të qenë të qartë, është diçka që shkon përtej kontrollit njerëzor, rezultati i të cilit është vendosja e disa llojeve të caktuara marrëdhëniesh të organizmave me njëri-tjetrin dhe me mjedisin e tyre. Por nuk ekziston një projekt i mirëfilltë, të cilin duhet ta kuptojmë apo ta përdorim.

SHEILA: Si arritët në një konkluzion kaq të zymtë?

ÇARLS: Ndërsa udhëtoja përreth botës në bordin e anijes “Beagle”, arrita të krijoj jo vetëm një panoramë të përgjithshme të natyrës, por edhe të kuptoja marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet specieve të ndryshme, sikundër të isha dëshmitar i shkatërrimeve, monstrooziteteve dhe keqpërshtatjes – të gjitha shumë mizore dhe të mbrapshta, veçanërisht nëse do të vinin nga dora e një qenie supreme, për më tepër që na ka krijuar ne të gjithë. Përfytyro të zbulosh gjithë këto që bën vetë Krijuesi ynë! Në vitet në vijim, zbulimi i një numri të madh speciesh të zhdukura në mbretërinë e kafshëve – përgjatë *gjithë* periudhave të ndryshme gjeologjike, jo vetëm gjatë “Përmbytjes së Madhe” – u bënë pjesë e besimit tim të përgjithshëm, për të arritur në konkluzionin e thjeshtë që humbja e jetës është pjesë e natyrës së qenieve të gjalla.

SHEILA: Me sa di unë, edhe ju, personalisht, keni pasur humbje të njerëzve tuaj të afërt...

ÇARLS: ... po dy nga pasardhësit e mi vdiqën gjatë lindjes, ndërsa një vajzë më ka vdekur në moshën dhjetëvjeçare [**ngurron të flasë, përtypet**] – por ju lutem, nëse nuk ju vjen keq, preferoj të mos flas për këtë temë.

SHEILA: Sigurisht, sigurisht!

ÇARLS [e mbledh veten]: Kam frikë, se ndryshe nga z. Linkoln, jam i përgatitur të besoj vetëm në një Zot të dashur dhe të llojit suprem, mjetet dhe synimet e të cilit janë transparente për çdo person të arsyeshëm të zakonshëm. Nëse një Zot i tillë nuk ekziston, atëherë mund të them se nuk besoj fare në Zot.

ABE: Ndjesë, Darwin, me gjithë respektin që kam për ju, por më duket se po mbron idenë e një Zoti të standardeve të larta, aq të larta, sa vështirë se mund të arrihen.

XHEKI: Pyetje e bukur, Abel!

SHEILA: Xheki, të lutem!

ÇARLS: Linkoln, gënjen veten nëse mendon se të qenit në Shtëpinë e Bardhë, të shndërron një lloj personi aq “të fuqishëm”, sa të jesh në gjendje të kontrollosh dhe vendosësh balancat e dukurive të natyrës.

SHEILA: Ti po e thua këtë, Çarls. Por një miku juaj – të cilit, po ashtu, i njihet merita e propozimit të një teorie për evolucionin natyror – duket se mban një qëndrim pak a shumë të ngjashëm me atë të Abe-s. Bëhet fjalë për Alfred Russel Wallace. Kam mundur të gjej një frazë të tij, në një artikull origjinal, botuar jo më shumë se një vit përpara se të dilte libri juaj në qarkullim, ku përkufizon seleksionimin natyror:

Mënyra si vepron ky parim është saktësisht i njëjtë me atë të centrifugës së një makine me avull. Pra, kontrollon dhe rregullon çdo parregullsi, përpara se të bëhet evidente dhe të shndërrohet në shqetësim. Në mënyrë të ngjashme, në natyrë, asnjë ç’rregullsi në botën e kafshëve nuk mund të arrijë vlera të dukshme në madhësi, sepse e vendos ekzistencën e vetë saj, që në hapat e para të shfaqjes në vështirësi dhe, në vijim, shumë shpejt edhe në një zhdukje pothuaj të sigurt.

Për mua ky parim është personi “i fuqishëm”!

ÇARLS: Dakord, Wallace ishte shumë inteligjent dhe burrë i zoti, por teoria e tij lë për të dëshiruar. Referimi i vazhdueshëm ndaj të drejtës njerëzore si hyjnore, e orienton të kuptuarin drejt një të perceptuari të seleksionimit natyror më shumë të ngjashëm me seleksionimin artificial – si

dhe me përpjekjet e tjera mekanike për ta shoqërizuar natyrën me synimet e njerëzimit – që unë kurrë nuk e bëra. Në fakt, me daljen e librit i paralajmërova lexuesit e mi që të mos krijojnë një lidhje shumë të ngushtë ndërmjet pushtetit të pafund të natyrës dhe përpjekjeve tona relativisht kalimtare për të arritur ndryshime artificiale. Unë besoj se diferenca përbën një hendek që nuk mund të mbushet!

SHEILA: Por hendeku është mbushur – ose të paktën po mbushet. Nëse ju kujtohet, në fillim folëm për gjenetikën. Arsyeja pse Xheki ishte disi e zhgënjyer me eksperimentet tuaja është se në këta pesëdhjetë vitet e fundit, shkencëtarët kanë qenë të aftë të penetrojnë shumë më thellë në natyrën e jetës – si kurrë më parë! Në ditët tona, nëse flasim me një gjuhë popullore, kemi arritur “të thyejmë kodin gjenetik!” [**ÇARLS vështron në mëdyshje**]

XHEKI: Çarls, më vjen keq, por mendoj se çdo mënyrë tjetër artikulimi do të ishte e pakuptueshme! Për më tepër, të lutem, programit tonë po i vjen fundi dhe kemi akoma shumë për të thënë!

ÇARLS: Kodi gjenetik? Mos i jemi kthyer përsëri studimit të “Gjenezës”? Mendoja që këtë lloj debati e kishim lënë me kohë prapa shpine, të themi që në shekullin e shtatëmbëdhjetë, kur njerëz të ngjashëm me Galileon shpenzonin kohë në përpjekje për të bashkërenduar të “dy librat” – librin e Natyrës me atë të Zotit. Pra, nëse flasim në termat e historisë së vjetër, cilin nga të dy librat shkel kod i juaj gjenetik?

SHEILA [duke qeshur]: E dini, Çarls, ndoshta mund të keni të ardhme të mirë në teatër, nëse vendosni të qëndroni në këtë botë.

ÇARLS: Të lutem, të jemi seriozë! Po filloj të mendoj që e gjithë puna e jetës sime paska qenë humbje kohe dhe se më keni sjellë përsëri në këtë botë, thjesht për hir të një shakaje apo rrengu mizor. Gjithë thelbi i evolucionit nëpërmjet seleksionimit natyror është se nuk ekziston ndonjë “marifet” hyjnor apo projekt intelektual në natyrë – dhe, sigurisht, edhe asgjë që mund të reduktohet në një “kod”, nëse me këtë kuptoni mediumin abstrakt për transmetimin e informacionit. Kjo është arsyeja pse marrëdhënia e organizmave *të veçantë* me mjediset *të veçantë* për breza *me radhë* është e një rëndësie të posaçme në të kuptuarin e funksionit të seleksionimit natyror. Kompleksiteti i rastësive të përfshira tejkalon gjithçka që mund të fabrikohet në një laborator - kjo është arsyeja pse vazhdoj të habitem që studime me bazë laboratorin janë zgjeruar në një masë të tillë, sa duhet

përfshirja e mobilizimi i “Lëvizjeve për të drejtat e kafshëve” për të ndaluar zhvillimin e tyre.

SHEILA: Më vjen keq ta pohoj, por jam përsëri e zhgënjyer, Çarls. Vetë seleksionimi natyror është shndërruar në një fenomen me bazë laboratorin. Në fakt, procesi ka filluar çerekun e parë të shekullit të kaluar, kur teoria juaj filloi të mos pranohet gjerësisht. Shkencëtarët, të cilët më parë i referova si “gjenetistë” kanë, përgjithësisht, aftësi shumë të mira në matematikë dhe janë në gjendje të zhvillojnë eksperimente të ndryshme. Këta kanë prirjen t’i perceptojnë organizmat si makina, pjesët e të cilave mund t’i analizojnë një nga një, t’i inspektojnë dhe, pse jo, edhe t’i korrigojnë. Edhe proceset nëpërmjet të cilave zhvillohen dhe janë subjekte të ligjeve të zhvillimit, përsëri mund të manipulohen në mënyra të atilla, sa mund të ndryshojnë sjelljet më thelbësore të organizmit.

ÇARLS [me sarkazëm]: Tani besoj do thoni se këta të ashtuquajtur gjenetistë i trajtojnë organizmat si fabrika, në gjendje të prodhojnë edhe evolucionin!

SHEILA [duke qeshur]: Çarls, po më vidhni tekstin! Po thoni saktësisht atë që dëshiroja t’ju thoj! **[ÇARLS duket i tmerruar]** Këta shkencëtarë kanë gjetur mënyrat se si t’i përdorin popullatat e insekteve me cikël të shkurtër jete për të modeluar evolucionin për breza me radhë. Ndoshta mund t’ju habisë fakti se iu desh pak kohë për t’ju gëzuar seleksionimit tuaj natyror, por në termat absolutë të tij, sepse kanë qenë shumë të suksesshëm deri në ndryshimin e modeleve të shumimit të tyre, duke arritur deri aty sa të krijojnë lloje të reja insektesh. Nga gjithë sa mund të thuhet, ky brez gjenetistësh e sheh seleksionimin artificial si mundësi për të përmirësuar seleksionimin natyral.

ABE [i habitur nga ato që thotë SHEILA]: “Fabrikat e evolucionit?” Mua më tingëllon më shumë si “makina krijimi”! Ndoshta është e vërtetë që njeriu është krijuar në imazhin e Zotit dhe ngjan me të edhe në sjellje!

ÇARLS: Kjo është çmenduri! Dhe ju jeni i çmendur, Linkoln! Gjithë sa thotë më duket si një vijim i përpjekjeve të kushëririt tim në një fushë të re studimi, që ai e quajti “eugjenizëm”, bazuar në statistika të historive familjare, kombinuar me pak eksperimente me binjakë.

SHEILA: E keni fjalën për Francis Galton, kushëririn tuaj?

ÇARLS: Po! Dhe mbi bazën e provave shumë të zbehta, Francis kërkonte të ndikonte politikat publike, duke këshilluar të zgjedhurit dhe ligjvënësit se si të dallonin aspekte të jetës së njerëzve, produkt të dy faktorëve, që sipas tij ishin “natyra” dhe “mënyra e rritjes”. Atëherë e paralajmërova që duhet të ishte shumë i kujdesshëm me çështje të tilla, sepse njerëzit mund të dëmtohen apo edhe të vihet në rrezik vetë jeta e tyre nga politikanë, që në dëshpërimin për vëmendje, mund t’i merrnin shumë seriozisht gjithë sa deklaronte për vijimësinë e arritjeve në linjën e pasardhësve të një familje. Në fund, natyra gjithnjë fiton dhe çdo përpjekje që propozon ligje që janë në kundërshtim me karakterin e natyrës i ka gjasat të na shkaktojë lot.

ABE: Darwin, ju dëgjova me vëmendje dhe në riskun për t’u dukur edhe egoist, mund të deklaroj se nuk pajtohem me ju. Për mua, ligjet që kemi mundur të formulojmë janë jo vetëm një nga mekanizmat që korrektojnë dhe kompensojnë natyrën, por dhe na dallojnë ne, si shoqëri e civilizuar. Nëse pretendojmë të jemi mbi majmunët, kjo është pikërisht ajo që na ndan!

ÇARLS: Pa merak, i nderuar, sepse jam mësuar të dëgjoj plot biseda të kësaj natyre, gjatë gjithë kohës, nga Huxley – në rastin e tij, si një justifikim për zgjerimin shumë të madh të fushave të kërkimit shkencor në mjekësi, në ndihmë të zgjatjes, sa më shumë, të një jete sa më produktive. Mos më keqkupto: nuk kam asgjë kundër ligjeve apo mjekësisë si mënyra për të përmirësuar kushtet e njerëzimit. Por kur konceptohen në terma jashtëzakonisht të fuqishëm, që në një farë mënyre tejkalojnë – në mos i kthejnë mbrapsht – forcat e seleksionimit natyror, atëherë unë bëj një hap mënjane. Ideja fillestare e gjithë sa po diskutohet këtu, ndonëse e formuluar dhe e artikuluar më së miri, në fund të fundit është jo më shumë se një rudiment për ndjenjat biblike.

XHEKI: Sheila, kohën, të lutem!

SHEILA: Çarls, duhet të rrisim tempin! Po kalojmë të gjithë kufijtë e mundshëm kohorë që kemi në dispozicion!

ÇARLS [përmbledh]: Dakord, me pak fjalë: kanë mundur këta, të ashtuquajtur gjenetistë, të izolojnë me besnikëri faktorët *e saktë* në insekte *individuale*, që prodhojnë diapazonin e *plotë* të karakteristikave të tyre?

SHEILA: Ç’është e vërteta, kanë mundur! Aktualisht i kanë lokalizuar këta faktorë – ndryshe “gjene” – në gjëra që quhen “kromozome”, ku mund të vëzhgohet se si qelizat ndahen e shumohen përgjatë zhvillimit të tyre deri në

formimin e një organizmi të plotë. Por ky ishte vetëm fillimi. Ndoshta edhe njëqind vjet më parë. Gjërat filluan të lëvizin realisht – dhe njerëzit filluan të merren vërtet me idenë e kodit gjenetik – kur studimit iu bashkuan edhe shumë fizikanë. Vetëm atëherë arritën ta izolojnë gjenin. Gjithçka filloi në vitet 1930, me paratë që vuri në dispozicion Fondacioni “Rockefeller”, për të filluar studimet në një fushë të re, të quajtur “biologjia molekulare”, misioni i së cilës ishte të zbulonte linjën kimike që gjendet në bazë të jetës.

ÇARLS [konfuz]: Prisni, ju lutem! “Para të vëna në dispozicion”?

XHEKI: Çarls, në shekullin e njëzet, njerëzit mësuan jo vetëm si të prodhojnë evolucionin, por edhe shkencën e evolucionit. Marifete, sido që ta thuash dhe ngado që ta shohësh!

ÇARLS: Por ju nuk mund të krijoni fusha të reja studimi, ose të ndryshoni krejt linjën e studimit, thjesht duke u dhënë pará njerëzve!

XHEKI: Ke të drejtë! Nuk u japim pará vetëm njerëzve! Nuk e ke idenë sa pará hidhet edhe për ndërtesa e pajisje. Dhe pres që të habiteni përsëri, po t’ju them se sa mirë funksionojnë paratë si fertilizues në shkencë. Shumë më mirë se sa plehu për tokën! Dhe duhen përsëri, veçanërisht kur shkencëtarëve u duhet të formulojnë ndonjë njoftim për mediat.

SHEILA: Mjaft, Xheki! Sikundër thatë, jemi ngushtë me kohën – ndërsa Çarls dhe Abe duhet të dëgjojnë pjesën tjetër të historisë! **[rrit pak ritmin e të folurit]** Shumë gjëra të çuditshme dhe të pabesueshme kanë ndodhur me “thyerjen” e kodit gjenetik, më 1953. Tani jemi në gjendje të pohojmë, me bindje, se sa të ngjashme janë speciet me njëra-tjetrën – dhe po të flasim nga perspektiva e kimisë, nuk kanë shumë diferencë. Ndërsa brenda çdo specie kemi aftësinë të krahasojmë edhe diferencat më të vogla në kodin gjenetik, në gjendje të bëjnë dallimin nga një individ tek tjetri. Kjo është e dobishme veçanërisht për bujqësinë dhe mjekësinë, ku na duhet të neutralizojmë apo transformojmë pjesë të vogla të këtij kodi, duke përmirësuar për shembull pjesë të tjera, ndoshta edhe me ndihmën e kodit të një individi apo një specie tjetër. **[ÇARLS dhe ABE duken të mahnitur]** Të gjitha këto falë ndihmës që na japin njohuritë që kemi për kodin dhe mënyrën se si arrin një organizëm të prodhojë vetveten me ndihmën e tij. Nëse do të shpreheshja ndryshe, në ditët tona jemi në gjendje të imitojmë procese që çojnë në fabrikimin e një organizmi, pavarësisht nëse bëhet fjalë për të plotin apo pjesë të tij. Akoma, jemi në gjendje të

krijojme deri edhe organizma trans-gjenikë, që kanë pjesë nga edhe nga një lloj, edhe nga një lloj tjetër organizmi. **[ÇARLS dhe ABE duken të tronditur]**

ABE: Pra, në fund të fundit, Xheki kishte të drejtë kur tha se mund të fabrikoni organizma që hanë çdo gjë dhe prodhojnë, ndërmjet të tjerave, edhe dritën e tyre!

SHEILA: Jo, jo tamam! Akoma nuk kemi arritur t'i shndërrojmë të gjitha insektet që jetojnë në Tokë, të paktën jo për momentin. Në fakt, për shkak të mungesës së kohës, do na duhet të mos përmendim shumë detaje. Gjithsesi, gjatë kësaj periudhe është ecur gjithnjë me qasjen “dy hapa para, një hap prapa”. Për më tepër, që kërkimet shkencore jo gjithnjë shkojnë ashtu sikundër shpresohet. Por në thelb kjo është rruga që ka marrë shkenca, ku Charles Darwin mund të quhet si personi që shtroi trasenë. **[ÇARLS skërmitet.]** Për të qenë e ndershme deri në fund, nuk kemi përmendur një histori që pothuaj shkatërroi gjithë sa po bënte shkenca – dhe që mund ta kishte shndërruar Çarlsin e vjetër nga shenjt në mëkatar. Bëhet fjalë për Hitlerin, të cilin e kemi përmendur edhe më parë, një nga ata politikanët që në dëshpërim e sipër, për të mbajtur pushtetin, inicioi një lëvizje jashtëzakonisht eugenike, me shfarosjen në masë të hebrenjve.

ÇARLS [i alarmuar]: Sigurisht që nuk kam fare të bëj me këtë person dhe nuk do ta shoqërizoja veten kurrë me një tmerr të tillë!

SHEILA: Për fat të keq, nuk mund të ushtroni as edhe kontrollin më të vogël mbi tifozët tuaj - për më tepër, që nuk jeni më midis nesh – sigurisht, me përjashtim të kësaj dite. Por mos u shqetësoni, Çarls, të gjitha këto zhvillime emocionuese për të cilat kemi folur dhe që kanë lidhje me “thyerjen” e kodit gjenetik kanë ndodhur pas vdekjes së Hitlerit. Në ditët tona, qasja e njerëzve ndaj çështjeve që kanë lidhje me gjenetikën, do shtoja edhe e eugenikëve, është shumë mendje-hapur, e panjollësuar nga ngjarjet e së kaluarës.

XHEKI: “E panjollësuar?” Do thoja “e panjohur”! **[ABE dhe ÇARLS duken të çuditur]**

SHEILA [seriozisht e mërzhitur]: Xheki, kjo që thoni është një mesazh shumë larg asaj që duam të transmetojmë!!

ABE: Pra, synimi përfundimtar i kësaj shkence, që e shoqërizon veten me emrin e Darvinit, është krijimi i formave komplekse të jetës nga një projekt hartuar në letër?

SHEILA: Sigurisht që ashtu duket, ndonëse nuk do të thotë se do vazhdohet në të njëjtën mënyrë. Gjithsesi, shkencëtarët po bëjnë më të mirën e tyre, edhe tani, në momentin që ne flasim.

ABE [i zhytur në mendime]: Darwin, të pëlqen ose jo, duket se jeni shndërruar në Zotin që qëndron prapa kësaj shkence të re të Gjenezës!

ÇARLS [duket në mëdyshje]: Nuk po kap dot humorin në ato që sapo artikuluat! Emri im i mirë po shpërdorohet në emër të një forme më të sofistikuar të alkimisë!

SHEILA: Çarls, qartësohu! Shkencëtarët punojnë – të paktën kështu na kanë thënë! Më lejon të shtoj një deklaratë që ka bërë së fundmi një ekspert. Dëgjoni çfarë thotë:

Gjenet janë tekste të koduar digjitalisht, në një kuptim aq të mirëfilltë e të plotë, sa është e pamundur të mos pranohet analogjia. Njësoj si fjalët që përdorim në jetën e përditshme, edhe gjenet kanë pushtetin të dëmtojnë apo të shërojnë, por ky pushtet është edhe më i madh se sa i fjalëve, sepse për rrethana të caktuara, “fjalët gjenetike” mund të diktojnë me një parashikueshmëri shumë më të madhe, se sa shumica e imperativëve njerëzorë.

ÇARLS: Gjithë sa thoni tingëllon si përçartjet e disa teologëve që u ka mbetur ora në shekullin e shtatëmbëdhjetë, që nuk bëjnë gjë tjetër vetëm se referojnë “Librin e Natyrës” dhe “Librin e Zotit”.

SHEILA: Jo, Çarls! Ky është Richard Dawkins. Ai është në anën tuaj dhe është evolucionisti më i madh prodhuar ndonjëherë me ndihmën e një televizionit!

ÇARLS: Kjo fjala... përsëri! *Televizion!*

XHEKI [në përpjekje për t'i ardhur në ndihmë]: Çarls, gjyko në këtë mënyrë: jo vetëm që kemi nevojë për të fabrikuar evolucionin dhe shkencën e evolucionit, por kemi nevojë të fabrikojmë edhe *kërkesën* për shkencën e evolucionit. Kështu, në fund të fundit, pjesa *më e madhe* e parave shkojnë në

departamentin e marketingut, për t'ia shitur evolucionin masave. Dhe kjo ndodh në një medium që ne e quajmë televizion...

SHEILA [e ndërpret]: Xheki, më vjen keq, por tashmë kemi kohë vetëm për një gjë: të pyesim të ftuarit tanë nëse dëshirojnë të qëndrojnë ose të iknin. Abe, fillojmë me ju. [në stilin e “Kush do të bëhet milioner”] Atëherë, si vendosët, do qëndroni?... Apo do ikni!

ABE [merr pak a shumë rolin e një konkurruesi, ndoshta edhe jashtë karakterit të tij si person, e zgjat pak përgjigjen]: Do qëndroj! Do qëndroj!

SHEILA: Çarls, tani është radha juaj – dhe e di që edhe spektatorët janë në ethet e vendimit tuaj final. Do qëndroni?... Apo do ikni!

ÇARLS [konfuz]: Më vjen keq, por zgjedh të iki!

[**SHEILA, XHEKI, ABE dhe të gjithë artikulojnë një Ohhhhh....**]

SHEILA: Çarls, do kthehem shumë shpejt te ju, për të na shpjeguar arsyet që qëndrojnë pas jo-së tejet zhgënjyese. Por në fillim Abe! Pse vendosët të qëndroni?

ABE: Mendoj se shoh progres në dy fronte, krahasuar sigurisht me herën e fundit që isha në këtë botë. Çështja “racë” duket se është zgjidhur si nga pikëpamja shkencore, ashtu edhe nga pikëpamja politike, dhe në një mënyrë të atillë që inkurajon bashkekzistencën miqësore. Akoma, më pëlqen fakti që hulumtimi shkencor ka ecur përpara aq shumë, sa të rihapë mundësinë për të diskutuar për çështje shumë të rëndësishme, disa prej të cilave edhe me natyrë fetare apo që kanë lidhje me ekzistencën. Duket sikur jemi në pozitën për të menduar edhe një herë rreth tyre, por me shumë më tepër qartësi, dhe jo thjesht t'i lëmë mënjanë si relikte të një të kaluarë që është mbyllur, sikundër sugjeroi edhe Darvini në momentet më të përmbajtura të bisedës. I përshëndes me forcë arritje të tilla!

SHEILA: Abe, sigurisht që jemi të lumtur t'ju kemi përsëri mes nesh dhe kam dëshirë t'ju them, se kemi kaluar një ditë të bukur! Thënë këtë, mund ta na thoni, Çarls, pse vendosët “Të ikni”?

ÇARLS [zëri i bëhet gjithnjë e më profetik]: Sigurisht që ishte vendim i vështirë. Duke theksuar që në fillim respektin që kam për ju, në pikëpamjen

time, ajo që ju sot e quani “shkencë” nuk është më shumë se monstrozitet dhe gjasat janë që jo shumë larg në kohë do ju duhet të derdhni lot për këto që po bëni, ndoshta edhe për zhdukjen, për fare, të *Homo sapiens* nga planeti. Nëse mendoni se mendimi im vlen, uroj të mos kem të bëj me biologjinë tuaj gjenetike apo molekulare, si edhe me asgjë tjetër që ka lidhje me to. Shpresa që kisha, dhe më bënte gjithnjë të gëzohesha për teorinë time të seleksionimit natyror, ishte se mund ta çonte njerëzimin drejt një të vetëkuptuari më real. Konceptimi i unifikuar për gjithë realitetin, që shkon aq larg, sa të na lejojë të ri-ndërtojmë funksionet e brendshme të jetës, në përputhje me kërkesat tona, më duket një lloj arrogance, që vetëm një besim i pamasë në Bibël mund ta ushqejë. Nuk ka asnjë të dhënë empirike, që qeniet njerëzore kanë aftësinë për ta kuptuar të gjithë natyrën dhe të ndërhyjnë me një siguri të tillë. Kjo, sigurisht, jo për të mohuar kapacitetet bazuar në specie, të cilat kanë qenë shumë të mira dhe do të bëhen edhe më të mira. Por këto kapacitete nuk janë në përpjesëtim të drejtë me entuziazmin që u shpreh këtu. Thënë ndryshe, kam frikë se gjithë sa po bëni ose ëndërroni të bëni është thjesht një zhgënjim – që nuk e keni kuptuar ende, por mendoj se do të ndërgjegjësoheni sapo seleksionimi natyror të fillojë hakmarren nëpërmjet katastrofave mbarë botërore, në gjendje të vendosin të gjithë jetën në rrezik.

SHEILA [e ndërgjegjshme për kohën]: Ju lutem, jemi në minutat e fundit të kohës që kemi në dispozicion. Dëshiroj të falënderoj, edhe një herë, të ftuarit tanë të veçantë Abe Linkoln [**XHEKI nxjerr në tabelë, ku shkruhet: Duartrokitje**] dhe Çarls Darwin [**Xheki nxjerr në tabelë, ku shkruhet: Duartrokitje**] që ishin të pranishëm sot në sallë dhe për më tepër që e morën me kaq sportivitet praninë e tyre në një kohë tjetër. Nga ne, Sheila dhe Xheki, urimet më të mira – kudo ku jeni – në këtë botë –

XHEKI: ... ose në atë tjetrën!

SHEILA: Natën e mirë! [**XHEKI sinjalizon përsëri “Duartrokitje”**]

XHEKI [duke përcjellë **ÇARLSIN** dhe **ABE-n**]: Z. Darwin, taksia juaj e kohës po ju pret në oborr. Abe, kemi rezervuar për ju një dhomë të vogël, pa dritare, që mund ta përdorni përkohësisht.

[**Duartrokitjet fillojnë të shuhet. SHEILA dhe XHEKI janë vetëm, në skenë.**]

SHEILA: Si është e mundur që Çarlsi kishte dijeni për ngrohjen globale?

XHEKI: Nuk besoj se kishte! Bëri bluf! Dhe nuk e besoj se ngrohja globale ekziston, në fakt! Si thua?

SHEILA: Ndonjëherë, Xheki, mendoj se këtë çështjen e udhëtimit në kohë e merrni shumë seriozisht. Në fund të fundit, kjo që bëjmë ne është thjesht televizion!

XHEKI: Saktë, por kështu jam! Besoj se kjo “në fund të fundit” është shpëtimi im!

SHEILA [duket sikur nuk e ka dëgjuar fare se çfarë tha XHEKI]: Oh, përpara se të më dalë nga mendja: kontrollo nëse ka ndonjë problem me kthimin e Jezusit dhe Njutonit – të dy kanë lindur në të njëjtën ditë, më 25 dhjetor. Në klasifikimet e ndjekësve tanë, kanë vlerësime shumë të mira, përkatësisht Nr. 1 dhe Nr. 5. Besoj se do dalë më mirë se me Linkolnin dhe Darwinin!

XHEKI: Për fat të keq, kalendari ka ndryshuar pas lindjes së Njutonit. Sipas llogarive të mia, nuk kanë lindur në të njëjtën datë.

SHEILA [pak “të dalë ku të dalë”]: Mund të bëjmë ndonjë gjë kronoskopike dhe të ndryshojmë kalendarin?

XHEKI: Jo, do të ishte e rrezikshme – Zoti e merr vesh se çfarë mund të ndodhte ndërkohë. Më e mira është të shpresojmë në injorancën e shikuesve tanë. Na bie shumë më lirë!

[Të dyja kthehen me shpinë nga skena dhe nisen për të dalë]

SHEILA: Xheki, kur do vijë dita të mësoh, se në bisedë duhet të jesh politikisht korrekt! Pra, në vend të “injorancës”, thuaj “imagjinatë”. Imagjinata u jep njerëzve pushtet, ndërsa injoranca i zhvesh nga çdo lloj pushteti që mund të kenë. Dhe të mendosh se sa shumë të paguajnë...
[zërat shuhet përfundimisht]

Rrëfenjat e disa portokalleve që mund të fluturojnë

Shkruar për teatër

vënë në skenë në verën e vitit 2019, në Teatrin e Metropolit, Tiranë

Valbona Nathanaili

**Bazuar në rrëfenjën e Johan Galtung dhe Andreas Galtung
“Portokalli fluturues rrëfën historitë e tij”***

Për fëmijë të moshës 6-12 vjeç

Karakteret

Portokalli 1, Portokalli 2, Portokalli 3, Portokalli 4

Kryetari i grupit të ambasadorëve blu, Kryetari i grupit të ambasadorëve të kuq

Ambasadori blu 1, Ambasadori blu 2, Ambasadori blu 3, Ambasadori blu 4

Ambasadori i kuq 1, Ambasadori i kuq 2, Ambasadori i kuq 3, Ambasadori i kuq 4

Avokati , Sekretari i avokatit

Vëllai 1, Vëllai 2

Një grup djemsh dhe vajzash me uniformë shkollore, të moshës 8-12 vjeç
(jo më shumë se 6)

* Libri është botuar në shqip nga “Albanian University Press”, në përkthimin e Valbona Nathanaili.

Akti I

Skena I

Dritat bien. Në sfond duket një pemë portokalli mbushur me kokrra. Në skenë hyjnë 4 portokallet.

Portokalli 1: Ne, portokallet, rritemi në pemë. Duhet ta dini që jemi shumë të lumtur që ushqejmë njerëzit dhe i ndihmojmë të bëhen më të fortë, më të shëndetshëm.

Portokalli 2 Por edhe njerëzit na pëlqejnë aq shumë, aq shumë sa edhe një ngjyre i kanë vënë emrin tonë: ngjyrë portokalli!

Portokalli 3: E dini që ne, portokallet, e kemi origjinën nga vendet e ngrohta të Azisë?

Portokalli 1: Po që nga një pemë portokalle merren afërsisht 500 portokalle në vit?

Portokalli 4: Do ju tregojmë një sekret: ne, portokalleve, na pëlqen të flasim me njëri-tjetrin dhe të tregojmë rrëfenja. Kur fryn erë dhe lëkunden degët, rrëfenjat tona përhapen nga një pemë në tjetrën dhe dëgjohen nga portokallet e gjithë botës.

Portokalli 2 Sot do tregojmë rrëfenja për ju, njerëzit.

Portokalli 3: Te pema që rritem unë, një portokall më tregoi një herë për një fëmijë të vogël, që sa herë dilte me mamën dhe babin dhe shihte njerëz që lypin, mërzhitej shumë, fillonte të qante, dhe nuk hante gjithë ditën. Mami, për ta qetësuar, i tha të mbyllte sytë.

Ju njerëzit jeni të çuditshëm ndonjëherë. Sepse e dini çfarë ndodhi? Kaq shumë njerëz që lypin pa në rrugë një ditë djali i vogël, sa i mbylli sytë dhe nuk donte t'i hapte më.

Korri i portokalleve: *Rrëfenjat tona - parë e dëgjuar,*

sapo kanë filluar.

Portokalli 4

*Por më parë – shët... - një sekret, i fshehtë plot,
Afroni kokat të dëgjoni – gjoksi nuk ma mban dot
Fat i bukur dhe i pakuptuar, të katërve na ka dhuruar
Ëndrrën që kishim – dëshirën për të fluturuar.*

Portokalli 3

*Bashkë do shohim dhe dëgjojmë,
Do gjykojmë dhe mësojmë!*

Portokalli 1: Sot kemi planifikuar tre udhëtime. I pari është shumë i rëndësishëm, sepse edhe vetë ata mbahen për shumë të rëndësishëm: do jemi në një takim me ambasadorë. Parashikojmë që, si gjithmonë, nuk do të arrijnë të zgjidhin gjë, ose do kërkojnë edhe një takim tjetër. Udhëtimi i dytë është në zyrën e një avokati dhe i treti në një shkollë.

Portokalli 3:

*Të dashurit spektatorë ftojmë,
Së bashku me ne të vrojtojnë.
Mësimet e nxjerrin dhe të kuptojnë -
fjalët e pamenduara njerëzit i lëndojnë!*

Korri i portokalleve:

*Rrëfenjat tona - parë e dëgjuar,
sapo kanë filluar!*

Skena II

Një tavolinë e madhe, rrethuar me karrige; mbi tavolinë janë vendosur etiketa me emra “Ambasadori 1” dhe me radhë. Një tabelë e madhe me rendin e ditës, temat e diskutimeve dhe orën kur do pihet kafja, kur do hahet dreka. Grupi i portokalleve është ulur mënjanë, rrotull pemës.

Portokalli 2:

Të dashur fëmijë, hapni veshët mirë

Të dëgjojmë këta të nderuar zotërinj

Që duan të korrigjojnë historinë

Se të parët e tyre s'e kanë bërë mirë!?

Portokalli 3: Thonë se do ndajnë detin edhe një herë! Por ja ku po vinë! Sa shumë janë! Le të shpresojmë se edhe punë do bëjnë aq shumë.

Në skenë hyjnë 10 vetë, gra e burra, gjysma veshur me të kuqe dhe gjysma veshur me blu, flokët e veshjet tepër elegant, shumica të vjetër, disa me mustaqe, me syze e çanta të mëdha në dorë, një burrë duket si më i vjetri (për secilën ngjyrë). Disa kanë tabakë me letra në dorë, disa vizore e kompas të mëdhenj dhe disa edhe laptop-e e celularë. Marshi i Aidës (Xh. Verdi) në sfond; mjetet i mbajnë në dorë si armë – njësoj si te opera. Hyrja është pompoze dhe triumfale e bëhet nga dy drejtime të ndryshme, udhëheqin grupet burrat më të vjetër; i bien rrotull skenës dhe zënë vend rreth e përqark tavolinës – megjithëse i kanë emrat në tavolinë, përsëri grindje me njëri-tjetrin se ku do të ulen, i heqin edhe karrigen njëri-tjetrit, dikur qetësohen dhe zënë vend. Mbi tavolinë vendosin mjetet që kishin me vete dhe i hapin sa më shumë për të bërë rrëmujë. Fillojnë të pëshpëritin me njëri-tjetrin. Mbas pak, fillojnë fjalimet:

Kryetari i grupit të kuq: Zotëri, duam të ndajmë detin edhe një herë! Kemi zbuluar që ju keni marrë më shumë det se ju takon! Kemi sjellë hartat tona dhe do ju tregojmë padrejtësinë që na është bërë!

Kryetari i grupit blu: *Oh, për të qeshur apo për të qarë!*

Në fakt, ju të kuqtë detin tonë keni marrë!

Pjesëtar nga grupi i kuq: Kur isha vjet me pushime në plazh, pashë në pjesën tuaj që deti kishte shumë peshq të kuq! Ai det duhet të jetë i yni!

Pjesëtar nga grupi blu: Edhe unë kur isha me pushime, pashë në pjesën tuaj që deti kishte shumë peshq blu! Ai det duhet të jetë i jonit!

Të dy kryetarët: Propozime për ndarje!

Pjesëtar nga grupi blu: Propozoj të ndërrojmë peshqit dhe ndarjen e detit ta lëmë si është.

Të gjithë bashkë: Pushooooooooo, o i marrë, o i uruar!

Kryetari i grupit blu: *Ti, që fole kot, pamenduar,*

Nga grupi ynë je përjashtuar!

Pjesëtar nga grupi i kuq: Propozoj që asnjë anëtar i grupit të mos shkojë më me pushime në plazh. Kështu nuk shohim as peshq, as ngjyrën e tyre dhe nuk kemi pse të grindemi e të kërkojmë ndarje!

Të gjithë bashkë: Pushooooooooo, o i marrë, o i uruar!

Kryetari i grupit të kuq: *Ti, që fole kot, pamenduar,*

Nga grupi ynë je përjashtuar!

Pjesëtar nga grupi blu: Kemi nevojë për harta më të mira. Duhet të përkufizojmë dhe përcaktojmë çfarë janë “Ujërat e brendshëm” dhe “Ujërat territorialë”, ose ku fillojnë e mbarojnë “Ujërat ndërkombëtarë”.

Pjesëtar nga grupi i kuq: Duhet të konsultohemi me ndonjë specialist ose avokat që njeh ligjet ndërkombëtare, na duhen njohuri për Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit.

(Fillojnë të flasin të gjithë menjëherë. Dëgjohen zëra për mbledhje tjetër.)

Kryetari i grupit blu: Propozoj të mbledhemi përsëri.

Kryetari i grupit të kuq: *Edhe unë propozoj të mbledhemi përsëri*

pas mbledhjes që propozoni ju, zotëri!

(Fillojnë të flasin të gjithë menjëherë. Zhurmë.)

Portokalli 4: Ju lutem, mbani qetësi!

Korri i portokalleve: *Njerëzit kur kuvendojnë,*

për rregulla kanë nevojë.

Portokalli 1: Flisni me radhë!

Portokalli 2: *Që fjala të marrë peshën e duhur*
Shoku duhet dëgjuar dhe respektuar

Portokalli 3: *Gjuhë e bukur ngazëllon*
dhe bëhet e lënduar
kur pas mendimit shkon – (ndërprerje e shkurtër)
se vetëm atëherë frymëzon!

Portokalli 4: *Sa shumë fjalë,*
sa pak veprim.
Turp kur shtetin përfaqëson
dhe paafësi tregon!

Portokalli 2: *Mbledhja e sotme kaq e pat*
Deti ndahet veç me avokat!

Skena II

Në sfond një bibliotekë me shumë libra, ku dallojnë disa tituj: Kushtetuta, E drejta penale, e drejta administrative, Pronësia mbi tokën, Si të zgjidhim një konflikt, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit; librat janë klasifikuar edhe në shekuj, që fillojnë nga shekulli XV; një tavolinë e madhe mbushur me libra, dhe një burrë me kostum ulur në të. Një burrë tjetër, sekretari, është ulur pak më tutje. Hyjnë të gjithë bashkë: grupi i portokalleve dhe i ambasadorëve. Muzika: Traviata, korri i matadorëve, pjesa e fundit. Ju del përpara sekretari i avokatit – pushon muzika.

Portokalli 3: Duam të konsultohemi me avokatin për një çështje shumë të rëndësishme.

Sekretari: Ju lutem duhet të prisni. Avokati është i zënë. Pret dy klientë!

Korri i portokalleve

aha... aha...

Vëlla me vëlla, nuk po merren vesh,

Kërkesat secili i ka bërë përsbesh

Te avokati kanë ardhur, për të sqaruar

Si të zgjidhin këtë lëmsh që kanë krijuar.

(Vazhdon muzika. Skena plotësohet me dy burra që hyjnë nga drejtime të ndryshme.)

Sekretari: Mirëserdhët. Mund të hyni te avokati.

Avokati: Përsëndetje. Po ju dëgjoj.

Vëllai i parë: Babai na ka lënë të dyve, trashëgimi një tokë.

Vëllai i dytë:

Kemi bërë një zgjidhje

Ja, ashtu, me kokën tonë

Por cenon dëshirën

E të ndjerit babait tonë!

Vëllai i parë:

Kufiri i tokës, si për rastësi

Kalon tek një pemë portokalli

Që babai e ka mbjellë me duart e tij

Kur lindëm, ne, të tijtë fëmijë!

Vëllai i parë: Sipas testamentit që na ka lënë babai, tokën mund ta ndajmë, por pemën jo. Për më tepër, pemën e duam të dy, edhe unë, edhe vëllai im, por më shumë e duan fëmijët tanë.

Vëllai i dytë:

E duam atë pemë dhe shpirti na e kërkon

Se lëngu i frutave, fëmijët na i shëron!

Vëllai i parë: Kujtimi i babait më shfaqet sa herë shoh pemën. Më shfaqet duke u kujdesur dhe punuar... **(fshin sytë me shami)**. Mban mend...? **(i drejtohet të vëllait)** Bëri mot i shkëlqyer dhe pema plot me fruta u rëndua. Ftua fqinjët dhe bashkë i mblodhëm dhe gëzuam.

Vëllai i dytë: Po, më kujtohet, sa ditë e bukur! Dhe një ditë tjetër, prodhimet një shkolle me nxënës të varfër ia dhuruam.

(Të dy burrat përqafohen të përmalluar)

Avokati:

Ju dëgjova me vëmendje, me durim

Dhe puna ime sigurisht ka një çmim

Por sot, për ju, do bëj një përjashtim.

(I drejtohet sekretarit): Më sillni Statutin e Testamentit të vitit 1544. Është në raftin që ka botime të shekullit XVI. **(e shfleton, gjen diçka që i intereson)** Besoj se jam i qartë dhe kam një vendim! **(u drejtohet dy vëllezërve)** Pra, çështja është kjo: babai ju ka lënë, me testament, gjithë çka pasur: një tokë dhe një pemë portokalli. Ju mund të ndani tokën, por jo portokallin. Pema e portokallit duhet të mbetet aty ku është dhe në të njëjtën kohë nuk mund ta ketë në pronësi vetëm njëri nga ju! Dhe ju erdhët te mua, sepse doni një zgjidhje që të respektojë dëshirën e babait tuaj të ndjerë, që besoj se ju ka dashur shumë! Po ju e keni dashur?

Të dy vëllezërit, me një gojë: Ah, babai ynë i shtrenjtë! Sa shumë e kemi dashur.

(Të dy burrat përqafohen të përmalluar)

Avokati: Propozimi im: Tokën do ta ndajmë në tri pjesë

Një për ty, një për atë, (tregon me gisht secilin)

një për mua që po bëj këtë. (tregon letrat)

Unë dua pjesën e tokës që ka portokallin!

(Të dy burrat tronditen)

Pema nuk shkatërrohet (i gëzuar për zgjidhjen që ka gjetur)

Dhe testamenti zbatohet!

Jam për t'u lënduar

Gjithnjë punëmbarruar!

(drejtohet nga dy vëllezërit)

Sa për frutat, më kujtoni kur të pigen,

me para në dorë, mund të vilen!

(vëllezërit janë si të shushatur!)

Ah, se harrova, duhet të paguani edhe shpenzimet e gardhit rreth tokës sime. **(Vëllezërit bëhen gati të ikin.)** Prisni, nuk kam mbaruar. **(I drejtohet sekretarit):** Më sillni librin e përmbledhjes së motit të këtyre 100 viteve të fundit në fshatin nga vinë zotërinjtë. **(e shfleton, gjen diçka që i intereson; i drejtohet vëllezërve)** Besoj se jam i qartë dhe kam një vendim! Këtu thuhet se përpara 89 vjetësh, në fshatin tuaj ka bërë një stuhi aq e fortë, sa ka rrëzuar të gjitha prodhimet e portokallit. Gardhi duhet aq i lartë, sa ta kalojë gjatësinë e portokallit. Kështu sigurohem që prodhimin do e marr po unë.

Portokalli 1: Ndaloni!

Portokalli 3: *Nderimi i babait tuaj*

Kërkon një zgjidhje më të zgjuar!

Portokalli 4: Punojeni bashkë tokën dhe prodhimet e portokallit le t'i gëzojnë përsëri fëmijët e fëmijët e fëmijëve tuaj.

Kryetari i grupit blu: *Vëlla me vëlla të ulen edhe një herë e të plegërojnë*

Kryetari i grupit të kuq: *Çfarë mund të fitojnë dhe çfarë të sakrifikojnë.*

Vëllai 1: Portokall i dashur! Dielli, ajri, uji dhe toka janë miqtë tuaj më të mirë. Ju keni mësuar të jetoni në harmoni me to. Ne, njerëzit, kemi shumë

për të mësuar nga ju. Vërtet ju vadisim dhe krasisim, punojmë tokën rreth jush dhe shkulim barërat e këqija, por ju na e ktheni me frutat e mrekullueshme që prodhoni.

Vëllai 2: Njësoj si ju, edhe ne duhet ta kërkojmë harmoninë te njerëzit që na rrethojnë, që na ushqejnë, na rrisin e mbështesin, te miqtë që na bëjnë më të bukur shpirtërisht.

Portokalli 2: Ju, njerëzit, jeni shumë të mençur... avokatë dhe ambasadorë, fshatarë dhe qytetarë... Por jo gjithmonë e përdorni këtë mençuri ashtu si duhet.

Korri i portokalleve: *Njerëzit, nëse të ndajnë kanë nevojë*

Njeri-tjetrin të gëzojnë!

Portokalli 1: *Vëlla e motër humbet, kur kërkon*

më shumë se të takon!

Portokalli 2: *Por ne jemi portokalle të lumtur*

Dhe mos u çudisni që jemi edhe pak mendjebollë

Ndaj dëgjoni tani një ngjarje të bukur

Por për këtë na dubet të shkojmë më parë në një shkollë!

Akti III

Skena I

Në sfond një tabelë ku shkruhet “Shkolla 9 vjeçare e fshatit”, 6 karrige ku janë ulur fëmijë, si dhe mjete të tjera që të kujtojnë një klasë të zakonshme. Në mes janë dy shporta me portokalle. Hyn gjithë grupi i mëparshëm. Muzika përsëri është Traviata, por këtë radhë hyrja është e thjeshtë dhe kokulur. Të gjithë hyjnë nga një drejtëm. Në njëren anë të skenës, bëhet biseda ndërmjet dy vëllezërve.

Vëllai 1: Portokallet tona!

Vëllai 2: Të shohim si do i ndajnë!

(Duke pëshpëritur dhe bërë shenjën që të mos flasin)

Portokalli 3: Jemi tamam në kohë. Të mos i shqetësojmë fëmijët, por t'i dëgjojmë dhe prej tyre të mësojmë.

(Dëgjohen zërat e nxënësve)

Nxënësja 1: Një nga banorët e fshatit na ka sjellë dhuratë dy shporta me portokalle. Si do t'i ndajmë?

Nxënësi 2: Fillimisht t'i porosisim gjithë nxënësit që bërthamat e tyre mund të mbillen. Klima jonë është e ngrohtë dhe është shumë e thjeshtë të rriten. Kush ka pak oborr a një vazo të madhe, të mbjelli një bërthamë dhe të kujdeset për rritjen e saj.

Nxënësja 3: Mund të mbjellim portokalle edhe te oborri i shkollës dhe të kujdesemi me radhë. Te oborri është një vend që bie dielli gjithë paraditen.

Nxënësi 4:

Një porosi nga nëna ime

Në mendje më ka ngel'

Lëkurat e portokallit të mos flaken

Se ato bëhen për bukuri reçel!

Nxënësja 1: Dakord. Këto do t'i shkruajmë me kujdes dhe do e varim njoftimin te korridori i katit të parë. Kur të organizoni takimet me klasat e juaja, theksojeni përsëri. Më duhen vullnetarë për mbjelljet në oborrin e shkollës. **(të gjithë ngrenë duart)**

Nxënësja 1: Shumë mirë. Kthehemi edhe një herë te pyetja e parë: si do i ndajmë?

(Portokallet fluturues i afrohen tavolinës)

Portokalli 3: Ja ku erdhëm përsëri!

(Mbledhja ndërpritet. Të gjithë fëmijët brohorasin dhe ngrihen për t'i përqaftuar. Duket se njihen prej kohësh, pasi takimi është i përzemërt.)

Portokalli 2: Por nuk jemi vetëm. Kemi sjellë edhe miq të rinj me vete.

Nxënësja 1: Shoh dy vëllezërit që na sollën portokallet. Faleminderit! Jemi mbledhur për të diskutuar se si do t'i ndajmë. Shkolla ka nxënës të varfër.

Vëllai 1: Do ju sjellim përsëri portokalle.

Vëllai 2: Dhe do mësojmë të gjithë nxënësit si të mbjellin pemë me portokalle e si të kujdesen me to. Që të kenë sa më shumë.

Ambasadori i grupit të kuq: Ne do ju ndihmojmë t'i shpërndani idetë tuaja në të gjithë botën.

Ambasadori i grupit blu: Edhe mënyrën si i ndani portokallet...

Avokati:

Dhe unë si avokat

Do t'iu lehtësoj ballet

T'ju gjej vendin ku mbillen portokallet!

Korri i portokalleve:

Njerëzit, nëse të ndajnë kanë nevojë

Njeri-tjetrin të gëzojnë!

Portokalli 4: Ato që pamë, bashkë i treguam

Portokalli 1:

Të rriturit të dëgjojnë

Se në jetë mund të ndodhë

Që edhe nga fëmijët të mësojnë.

Portokalli 2: Tani ka ardhur koha të gjithë të largohemi

Korri i portokalleve:

Krëfjenjat tona - parë e dëgjuar,

Sapo kanë mbaruar!

Jemi në kohë, tek e mira për të besuar

Dhe një botë më të drejtë për të ndërtuar!

SHËNIME

1. *Martha Nussbaum* Nëse një vend dëshiron të promovojë këtë lloj demokracie humane, ndryshe të jetë e ndjeshme ndaj natyrës njerëzore dhe synon të promovojë mundësitë për “jetën, lirinë dhe gjetjen e lumturisë” për çdo person - në veçanti - çfarë aftësish duhet të edukohen te çdo qytetar? Më e pakta që mund të bëjmë, është të edukojmë aftësitë e mëposhtme:

- Aftësinë për të menduar me kujdes për çështje të ndryshme politike që ndikojnë vendin, për të analizuar, reflektuar, debatuar dhe argumentuar, duke mos bërë kompromis as me traditën dhe as me autoritetin.

- Aftësinë për t’i pranuar bashkëqytetarët si njerëz me të drejta të barabarta, edhe pse mund jenë të ndryshëm në racë, fe, gjini dhe orientim seksual: trajtojini me respekt, si synime, dhe jo si mjete që mund të manipulohen për përfitimet tuaja personale.

- Aftësinë për t’u shqetësuar për jetën e të tjerëve, për të kuptuar se çfarë ofrojnë për mundësitë dhe përvojat e bashkëqytetarëve, si dhe për të tjerët, jashtë kufijve të vendit tënd.

- Aftësinë për të perceptuar bashkësinë e problematikave komplekse që ndikojnë historinë tonë si qenie humane, në të gjithë natyrën dhe llojet që mund të shfaqen: të mendosh për fëmijërinë, adoleshencën, marrëdhëniet familjare, sëmundjet, vdekjet dhe shumë e shumë faktorë të tjerë, por gjithnjë i informuar nga histori të ndryshme njerëzore, dhe jo thjesht nga analiza e të dhënave.

- Aftësinë për të gjykuar, në mënyrë kritike, udhëheqësit politikë, por gjithnjë me kushtin që kjo kritikë duhet të jetë i informuar dhe realiste në lidhje me mundësitë që ata vetë kanë për të bërë ndryshimin.

- Aftësinë për të menduar për të mirën e vendit si një i tërë, jo thjesht nga perspektiva e një apo tjetër grupi lokal ku mund të bësh pjesë.

- Aftësinë për ta parë vendin tënd si pjesë të një rend të komplikuar botëror, ku çështje të llojeve të ndryshme kërkojnë debat trans-kombëtar për zgjidhje.

2. *Valbona Nathanaeli*. Friedrich Fröbel (1782 – 1852) (profesor gjerman, ish-student i Pestalozzi-t dhe një nga dishepujt e tij) mund të quhet me plot të drejtë një figurë vizionare në fushën e studimit të zhvillimit të fëmijërisë së hershme. Sipas Fröbel, fëmijët në thelb janë të mirë: fëmija nuk duhet të thyhet, por të formësohet. Fröbel hodhi bazat e arsimit modern, ngritur mbi njohjen e nevojave dhe të aftësive specifike që kanë a zotërojnë fëmijët, duke e ndarë procesin e edukimit të hershëm nga lindja deri në moshën gjashtë vjeç në disa faza të veçanta, secila prej të cilave e përcaktuar më së miri nga shkalla e zhvillimit fizik dhe mendor të tij. Për çdo fazë ai hartoi aktivitetet përkatëse, materialet që mund të përdoren, aftësitë që zotërojnë si dhe me çfarë mund të merren, të cilave u bashkëngjiti objektivat specifike të arritjeve, me synimin që mësimdhënia të ishte në funksion të aftësive dhe vlerave që duheshin formësuar.

Me dyshimin se jo të gjithë prindërit janë të aftë t'i japin fëmijës atë edukim dhe disiplinë për të cilën ka nevojë dhe, nga ana tjetër, me besimin se fëmija në atë moshë nuk është gati për shkollë, Fröbel krijoi konceptin e kopshtit, një institucion alternativ i përshtatshëm për shëndetin, begatinë dhe fuqizimin e jetës së jashtme dhe të brendshme në fëmijërinë e hershme. Në kopsht fëmija kishte mundësinë të rrinte me bashkëmoshatarët e tij, larg shtrëngimeve të familjes dhe, në të njëjtën kohë, në një mjedis të mbrojtur. Kopshtet e Fröbel janë në shërbim të fëmijëve të të gjitha klasave, jo thjesht për të varfrit; janë në shërbim të promovimit të arsyes, jo thjesht të bindjes fetare. Për fat të keq, më 1851, Fröbel etiketohet si nacionalist dhe vetë koncepti i kopshteve të propozuar prej tij, u propagandua si një mjet në ndihmë të lëvizjes socialiste. Vetëm disa dekada më vonë idetë e tij do të përhapen në shumë vende: fillimisht në SHBA, e më vonë në Britani dhe në disa vende të tjera evropiane. Më 1890 Belgjika adoptoi për herë të parë kurrikulën për fëmijët parashkollorë bazuar në veprën e Fröbel dhe, më 1911, edhe trajnimi i mësuesve të këtij niveli mbështetej po në veprën e tij, shprehur kjo edhe me vendime të posaçme. Në fillimin e viteve '910, falë ideve të Fröbel, kopshtet bëhen, pothuaj në të gjithë botën, një strukturë standarde e sistemeve arsimore para-universitare.

Vepra kryesore e Fröbel është “Mutter-und-Koselieder” (Këngët e mamasë dhe të rritjes), që përmban një varg këngësh, shoqëruar me lojëra të thjeshta, përpiluar me synim stimulimin e shqisave të perceptimit që në muajt e parë të jetës. Për fëmijë pak më të rritur, ai përpiloi disa lojëra të tjera, që shërbenin për të mësuar marrëdhëniet e të tërës me pjesën (me synim zhvillimin e të menduarit abstrakt) dhe që ishin blloqe të ndryshëm, shkopinj e cilindra, të cilët bashkoheshin me njëri-tjetrin për të formuar modelet (shumë nga lodrat e krijuara prej tij gjenden akoma në kopshtet e

ditëve tona). Fröbel aspironte për një komb të bashkuar dhe reforma liberale; arsimi, sipas tij, është një mjet i mirë në arritjen e këtyre synimeve.

Debatet kryesore që lidhen me përhapjen e kopshteve janë ato të zhvilluara ndërmjet konservatorëve dhe liberalëve: të parët janë për ruajtjen e autoritetit të familjes në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve; të dytët përpiqen ta mënjanojnë disi këtë autoritet, nëpërmjet mësimin të vlerave të tjera në këto institucione edukimi.

3. *Valbona Nathanaeli*. Johann Heinrich Pestalozzi (1746 –1827)

Ne mbjellim një farë të vogël në tokë, por shpesh barrojmë që në të gjenden rrënjët e të gjithë pemës.

Pedagog zviceran, një nga reformuesit e mendimit pedagogjik dhe përkrahës i flaktë i arsimimit të fëmijëve të varfër e jetimë. Motoja e tij: “Nxënia realizohet me kokë, zemër e dorë” vazhdon, edhe në ditët tona, të jetë një nga parimet kryesore të nxënies për shumë shkolla. Është themeluesi i disa institucioneve arsimore në Zvicër.

Më 1769, në moshën 23 vjeçare, bleu një tokë të shkretë në Birr, Aargau, që e quajti Nuehof (Ferma e re), në të cilën fillimisht hapi një shkollë për fëmijët jetimë dhe ata pa të ardhura, por për shkak të problemeve financiare si dhe të luftës, shumë shpejt e mbylli. Në përpjekje për të siguruar disa të ardhura, provoi edhe me fermë, por edhe ajo rezultoi e pasuksesshme.

Vepra e parë, e botuar më 1780, me titull “Orët e mbrëmjes së një heremiti”, një përmbledhje aforizmesh dhe reflektimesh private, ku gjenin vend edhe teoritë e tij rreth sigurisë në shtëpi që duhet të ketë fëmija nëse duam që të jetë i lumtur apo edukimit në përshtatje me natyrën, nuk gjeti shumë jehonë në shtypin e kohës. “Leonardi dhe Gertruda”, një libër që botohet vetëm një vit më vonë, më 1782, e bën emrin e Pestalozzit të njohur edhe në rrethet akademike. Më 1801 vendos të paraqesë idetë e tij për arsimin në librin “Si i mëson Gertruda fëmijët e saj”. Sipas tij, mësimi i fëmijëve duhet të kalojë nga më thjeshta tek e ndërlikuara, duke ndjekur këto hapa: vëzhgim, ndërgjegjësim, artikulum qartë i problemit dhe i ideve; ishte kundra dënimit fizik dhe kundërshtar i mësimin përmendësh; pohonte se çdo aspekt i jetës së fëmijës kontribuon direkt në zhvillimin e personalitetit, karakterit dhe shkallës së arsytimit. Metoda kryesore që zbaton në mësim është ajo me qendër-nxënësin, bazuar në karakteristikat e tij individuale, si dhe në aktivitete që zhvillohen nga vetë ai. Kurrikula e Pestalozzit, ndonëse është e ngjashme me atë që Jean-Jacques Rousseau

modelon për “Emilin” e tij, i kushton një vëmendje të veçantë punës në grup dhe përbëhet nga vizatimi, shkrimi, njehsime me numrat, ushtrime fizike, modelim dhe ekskursione në natyrë; në klasat e tij vihet re tendenca e grupimit të fëmijëve më shumë bazuar në aftësitë e tyre, se në moshë; është pro rolit të mësuesit në arsimimin formal të nxënësve në shkenca.

Filozofia e Pestalozzit për arsimin ngrihet mbi perceptimin se vetë qenia njerëzore, për nga natyra, në thelb është e mirë. Në të gjenden të ashtuquajturat sfera të jetës, gjithsej katër. Tre sferat e parat ose sferat e jashtme, janë: 1.shtëpia dhe familja, 2.vetëvendosja individuale dhe përgatitja profesionale, 3. shteti e kombi. Nëpërmjet krijimit të mekanizmit të këtyre sferave Pestalozzi njeh rolin e familjes, të marrëdhënieve prindër-fëmijë dhe të shoqërisë në tërësi në zhvillimin e karakterit të fëmijës, në ngulitjen e ndjenjës së detyrës dhe në nxitjen e aftësisë për të nxënë. Sfera e katërt ose sfera e jashtme lidhet me faktin se sa kohë themi që arsimi listohet si nevojë themelore, sigurimi i tij e çon individin në vendosjen e një paqeje të brendshme dhe në një besim “të mençur” tek Zoti.

Johann Heinrich Pestalozzi njihet si një nga dishepujt e Rousseau, që e zhvilloi më tej veprën e mjeshtrit të tij, duke i dhënë edhe nuanca të reja. Sipas Pestalozzi-t edukimi i fëmijës duhet të fillojë që në ditët e para të jetës. Ai glorifikon rolin e nënës, duke e quajtur mësuesen më të mirë të fëmijës. Në ndryshim nga Rousseau i cili shprehet se mësimdhënia, që në moshë të njomë, mund t’u besohet edhe meshkujve, Pestalozzi mendon se mësimdhënia në këtë moshë duhet të jetë detyrë vetëm për femrat, rrjedhojë e proceseve natyrore që zhvillohen tek to.

Pedagogjia e Pestalozzi-t, e cila pati një ndikim shumë të madh në lëvizjen progresiviste amerikane gjatë gjithë shekullit XIX, shërbeu si një argument i mirë për të justifikuar shtrirjen e rolit të gruas në edukimin e kësaj grup-moshe nga sfera private në atë publike.

4. *Valbona Nathanaeli*. Ajo që dimë nga Sokrati është, kryesisht, rrjedhojë e shkrimeve për të nga dishepujt e tij, kryesisht Platoni (në fakt, edhe në ditët e sotme, shumë studiues përsëri nuk janë në gjendje të përcaktojnë qartë se cilat nga idetë janë të Sokratit dhe cilat të Platonit). Sokrati njihet për bisedat që bën me pasuesit e tij, të cilat zhvillohen në formën e dialogëve, me një tematikë të caktuar, bazuar në pyetje të ndryshme. Zakonisht është Sokrati që luan rolin e udhëheqësit të dialogut, duke i dhënë bashkëbiseduesit informacion të vyer për temën. Për shembull, duke i drejtuar pyetje të shumta dhe me karakter hetues që e ndihmojnë të qartësojë idetë, analizojë faktet, kërkojë argumentet e nevojshëm për eksplorimin e çështjes fillestare apo të zhvillojë idetë. Biseda

zhvillohet deri në atë fazë që ose Sokrati, ose studenti, ose të dy bashkë arrijnë në konkluzionin se janë ezauruar të gjitha këndvështrimet e mundshme. Bisedat zhvillohen në mënyrë informale në vende të ndryshme, private ose publike. Pjesëmarrja nuk është e detyrueshme, në kuptimin që hyrja dhe dalja gjatë zhvillimit të bisedës janë të lira.

Sokrati këmbëngul shumë mbi një argument a një tjetër, pa lëshuar udhë, duke çuar në përfundime që shpeshherë kundërshtohen nga dëgjuesit. Në një rast, gjatë një debati me filozofin Hippias, mbi ndryshimet ndërmjet të vërtetës dhe gënjeshtërisë, Hippias, duke mos u pajtuar me këmbënguljen e Sokratit mbi argumentin, tërhiqet me përlulesi, duke i thënë: “Nuk pajtohem me ju, Sokrat”. Mjeshtri i përgjigjet: “As unë nuk pajtohem me veten time, Hippias! Jam shpesh në mëdyshje! Mendimet më shkojnë sa andej-këtej dhe kurrë nuk ruaj të njëjtin opinion”. Sokrati pranon se është aq i zgjuar, sa shpesh çorodit edhe veten!

Për Sokratin “të njohësh vetveten” do të thotë të jesh i aftë të njohësh, në mënyrë kritike, edhe shoqërinë. Sokrati akuzohet për mungesë respekti ndaj fesë dhe për shumë kohë deklaroi “Unë nuk jam mësues” dhe “Unë nuk di”. Sipas Meletus, akuzuesit të tij, ai u mëson të rinjve të mos besojnë tek zotat, se dielli e hëna nuk janë zota ose që dielli është gur dhe hëna është si toka. (Platoni, Apology 27d) Më saktësisht, akuza shtjellohet rreth tri çështjeve kryesore: 1. Nuk njeh Zotat, që në atë kohë njihen nga shteti; 2. Ka paraqitur “gjëra të reja” si hyjnore; 3. Korrupton të rinjtë.

“Korrupsioni i të rinjve” ose ndryshe lloji i mësimi për të cilin Sokrati akuzohet se kërkon të korruptojë të rinjtë, në ditët tona njihet me emrin “mësimdhënie indoktrinuese” (“Mësimdhënie indoktrinuese” është mësimi që detyron ose bind studentët të pranojnë një doktrinë si të vërtetë, të cilën studentët nuk e dinin ose nuk e besonin përpara se t’u mësohej si e tillë). Në kushtet e daljes përpara një gjykate, Sokrati mohon të jetë mësues ose *se di gjithëka*, përkundrazi: “Unë nuk kam qenë kurrë mësuesi i ndokujt. Vërtet që bëj shumë pyetje e jap shumë përgjigje, të varfëra e të pasura, dhe, nëse dikush, i ri ose i vjetër, kërkon të dëgjojë se çfarë po them, kjo është puna e tij, nuk e refuzoj.” (Plato, Apology 33a-b2) Pikërisht në këtë kontekst duhet kuptuar pretendimi i Sokratit “Unë nuk jam mësues”! Në fakt, ajo që del nga studimi i gjithë dialogëve që ai bën me pasuesit e tij është thjesht mësim. Ndonëse vetë Sokrati nuk u vë një emër llojit të pyetjeve që drejton, studiuesit kanë rënë dakord t’u referohen si “Metoda sokratike”. Pyetja është: A beson Sokrati vetë, se ata që pyet mësojnë diçka që ja vlen nga ky lloj sistemi pyetjesh refuzuese të vazhdueshme dhe, nëse po, a mund të konsiderohet ky lloj mësimi ajo që ne sot e quajmë “metoda sokratike”? Sigurisht që e vetmja gjë që mund të bëjmë në kërkim të përgjigjes është të

përpiqemi të interpretojmë të gjitha veprat ku përshkruhen dialogët e Sokratit – gjë e cila lë vend për shumë subjektivitet, pasi secili studiues sjell një aspekt të ri në këtë argument, por e rëndësishme është të theksojmë se dijet që Sokrati zbulon nëpërmjet tyre, pavarësisht natyrës që kanë pyetjet, refuzuese ose udhëheqëse, në mungesë të tyre nuk do të kishte qenë e mundur të kishin dalë në dritë. Pra, metoda kryesore e mësimdhënies së Sokratit mbështetet në organizimin e dialogëve verbalë me studentët. Në varësi të llojit të pyetjeve, mënyrës së organizimit të tyre dhe synimeve që kërkon të arrijë, autorët i klasifikojnë në dy grupe kryesore: metoda “Meno” dhe metoda “Theaetetus” – pasqyruar respektivisht në veprat e Platonit me të njëjtin emër.

“Meno” është një vepër e Platonit, shkruar në formën e një dialogu që zhvillohet ndërmjet vetë Sokratit dhe Meno lidhur me argumentin “nëse mund të mësohet virtyti”. Në dialog përfshihet, pak më vonë, edhe një nga sklevërit e Meno, të cilit Sokrati i bën pyetje rreth gjeometrisë.

Rëndësi ka për ne mënyra e organizimit të pyetjeve të Platonit dhe synimi që kërkon të arrijë. Që këtëj merr emrin edhe metoda, e cila ka gjetur përdorim të gjerë në ditët tona. Në metodën “Meno” ai që drejton pyetjet është eksperti, që e di rezultatin, por nuk ja jap të gatshëm studentit. Mësuesi “sokratik” që përdor këtë metodë, i përdor njohuritë e tij për të bërë pyetje që e udhëheqin studentin; pyetjet riformatohen herë pas here, në mënyrë që të ekspozojnë ato njohuri që studenti fillimisht i dinte gabim, pasqyruar në përgjigjet e para të tij dhe vazhdojnë deri sa studenti të fillojë të japë përgjigje më të frytshme, pra të reflektojë. Kjo mënyrë e udhëheqjes së studentit e lejon Platonin të përdorë parimet kryesore të argumentit (shkencës, për shembull) në bazë të arsyetimeve të tij, në vend që të memorizojë e të thotë përmbajtje të mësuara nga teksti apo mësuesi. Sa më shumë të angazhohet studenti në këtë sistem arsyetimi dhe sa më mirë të mësojë fazat e funksionimit të tij, aq më e mirë do të jetë cilësia dhe kohëzgjatja e dijes së fituar. Modeli “Meno” mund të përdoret më mirë në ato raste ku kërkohet arsyetim abstrakt dhe nxitet të menduarit kritik. Ai përdoret veçanërisht në fakultetet e drejtësisë të shumë universiteteve të njohur në botë. Ky model u zhvillua për herë të parë nga Christopher Columbus Langdell, dekani i Fakultetit Juridik, Harvard, gjatë periudhës 1870 -1895. Langdell u jepte studentëve të tij si detyrë të lexonin kazuse të ndryshme dhe, në klasë, u kërkonte jo vetëm të përmbledhnin kazuset, por edhe të përcaktonin teoritë ligjore që u korrespondojnë ose që buronin prej tyre (Redlich 1914, f.12-13). Ndonëse kemi hasur disa kritika që i bëhen kësaj metode, një studim i kohëve të fundit tregon se afro 97% e

profesorëve vazhdojnë të përdorin metodën sokratike me studentët e vitit të parë në fakultetet e drejtësisë.

Metoda “Theaetetus” lidhet me faktin se Sokratin e shqetësojnë çështje, kryesisht, *të natyrës filozofike* dhe për të cilat mungonte një përkufizim i qartë si, për shembull: e vërteta dhe kufijtë e njohjes së vetvetes, qenia njerëzore dhe mënyra e saj e jetesës; ose *të natyrës politike*, sociale dhe psikologjike si, për shembull: çfarë do të thotë të jesh i drejtë, çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar, e keqe ose e mirë. Në këtë aspekt, pavarësisht se kjo metodë mund të lejë hapësirë për konflikt - Sokrati nuk është relativist: një e vërtetë, mund të jetë jo e tillë për një tjetër - synimi i kësaj metode është arritja në dije të reja që ndikojnë në zbulimin e së vërtetës, pra “njëlloj sikundër mamia ndihmon në lindjen e fëmijës” edhe mësuesi ndihmon në lindjen e ideve të reja. Supozohet se një metodë e tillë duhet përdorur në mjedise të ngrohtë dhe ku përpjekjet për bashkëpunim janë më se të dukshme, ku është e pranishme një frymë e dyanshme bashkëpunimi. Një metodë e tillë jo vetëm vë në përdorim dijet që studentët kanë në çastin që hyjnë në klasë, por i bën ato dije edhe më produktive, pra studentët lenë klasën me më shumë dije, pse jo edhe të reja.

Në këtë kontekst, pavarësisht se çfarë modeli zgjedhim të zbatojmë, duhet të pranojmë se dijet tona nuk janë të përjetshme, as nuk përfshijnë gjithçka. Duke perfrazuar Sokratin, edhe pse ndoshta ai ka qenë i detyruar ta pohojë një gjë të tillë, “duhet të jemi të ndërgjegjshëm për injorancën tonë”: përpjekjet tona, në mos për ta zhdukur, duhet të fokusohen, të paktën, në reduktimin e vlerës së saj. Ne duhet t'i shqyrtojmë argumentet e njëri-tjetri me një frymë të thellë kritike, duke i parë ata që sjellin argumente, edhe kur janë të kundërta me të tonat, si kolegë e bashkëpunëtorë, me shpresën se duke vënë në dukje gabimet, të tjerët do të dinë të mësojnë prej tyre.

Rrathët sokratikë janë një qasje pedagogjike bazuar në metodën sokratike, sipas së cilës është më e lehtë të arrish në një të kuptuar të qartë dhe të plotë nëpërmjet dialogut se sa memorizimit të informacionit. Struktura mund ketë forma të ndryshme në varësi të klasës apo zgjedhjes së mësuesit. Një prej tyre është e ashtuquajtura *fishbowl*. Në këtë strukturë, karriget vendosen në formën e rrathëve bashkëqendrorë, të cilët konceptohen ose të hapur, ose të mbyllur. Në të dyja konceptimet, studentët që ulen në rrethin me rreze më të vogël dhe që quhet rrethi i brendshëm, janë ata që përfshihen direkt në diskutimin e çështjes. Një nga studentët shtron argumentin për diskutim.

Në metodën e rrethit të mbyllur, studentët e rrathëve të tjerë (të rrathëve të jashtëm) nuk lejohet të jenë pjesë e diskutimeve që zhvillohen nga studentët e rrethit të brendshëm: në këtë rreth asnjë karrige nuk është bosh; ata marrin shënime dhe dëgjojnë diskutimet dhe argumentet që sillen në favor ose kundra çështjes, të cilat mund t'i përdorin vetëm më vonë, për shembull gjatë seminarit, kur bëhet diskutimi.

Në metodën e rrethit të hapur, në rrethin e brendshëm lihen karrige bosh në të cilat mund të ulen studentë që vijnë nga rrathët e tjerë e që kanë dëshirë të kontribuojnë me argumente për një çështje të caktuar; kur numri i studentëve që dëshirojnë të kontribuojnë në debat është më i madh se numri i karrigeve bosh, studentë nga rrethi i brendshëm, vullnetarisht, lëshojnë karriget për pjesëmarrjen e re; diskutimi vazhdon me pjesëmarrës që hyjnë e dalin vazhdimisht në rrethin e brendshëm.

Në varësi të kohës në dispozicion, zgjedhja mund të jetë për njërin apo tjetrin konceptim. Rrathët sokratikë kanë përparësi kur numri i pjesëmarrësve në debat është i madh, pra për klasa të mëdha, sepse u jep mundësi pothuaj të gjithëve të jenë pjesë e diskutimeve, si dhe të ndihmojnë në rritjen e përqendrimit në orën e mësimit. Synimi i këtij aktiviteti është bashkëpunimi për gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta. Roli i mësuesit është vetëm ai i monitoruesit të aktivitetit.

Më shumë: Thomas C. Brickhouse & Nicholas D. Smith.

5. *Martha Nussbaum*. Në shkollën “Tempulli”, themeluar në Boston, më 1834, Alcott kishte tridhjetë nxënës dhe nxënëse, të moshës 6-12 vjeç (edhe mësuesit ishin të dy gjinive, gra dhe burra). Në vitin 1839, shkolla pranon, për herë të parë, një fëmijë të zi. Shumë nga prindërit nuk i sollën më fëmijët në shkollë dhe shkolla u mbyll. Por edhe pse qëndroi e hapur për një kohë të shkurtër, shkolla punoi me filozofinë e edukimit progresiv evropian dhe falë përvojës që krijoi e pasuroi edhe më shumë këtë qasje. Metodot e Alcott janë më sokratike edhe se ato të Pestalozzi-t apo Froebel-it. Mësimi zhvillohej më shumë me ndihmën e pyetjeve që ngrinin vetë fëmijët, se sa me kërkesën për të pohuar ose treguar se çfarë dinin. Akoma, fëmijëve u kërkohej të analizonin vetveten, mendimet dhe emocionet që shfaqnin. Edukimi – shkruan Alcott – është procesi me ndihmën e të cilit mendimi është i hapur për shpirtin dhe, më pas, shoqërizuar me refleksionet për botën jashtë, kthehet përsëri për një analizë të mëtejshme. Në këtë mënyrë ndërjegjësohemi për realitetin dhe format [e gjërave përreth]... Ky proces

quhet vetë-plotësim”. Kjo është më shumë gjuha e Hegelit se sa e Platonit, por në të dyja rastet, kufiri i poshtëm – flasin gjithnjë në termat pedagogjikë - është Sokrati. Edukimi i udhëhequr nga të pyeturit dhe vetë-analiza.

Njësoj si Froebel dhe Pestalozzi, edhe Alcott ndryshon nga Sokrati, sepse e vë theksin në zhvillimin emocional dhe rolin e poezisë. Orët e mësimit shpesh kërkonin të fokusohesh te leximi dhe interpretimi i poemave. Për shembull, Wordsworth ishte një nga autorët më të preferuar. Gjithsesi, argumentet nuk kaloheshin lehtë. Fëmijëve u mësohej të merrnin përgjegjësi dhe të mbronin idetë e tyre personale. Për Alcott, njësoj si për paraardhësit e tij europianë, qasja sokratike nuk është e plotë, sepse nuk i kushton vëmendje emocioneve dhe imagjinatës. Gjithsesi, Sokrati përbente burimin kryesor për gjithë sa kërkohej në shkollë: vetë-analizë, përgjegjshmëri personale dhe aktivitete mendore individual, si antidota të atij shkollimi që formon studentë sipas qasjes tradicionale autoritare.

6. *Martha Nussbaum*. Shkolla e themeluar nga Tagore, në shumë pikëpamje, është larg asaj të zakonshmes. Pothuaj të gjitha orët e mësimit zhvillohen jashtë, në oborr dhe në natyrë. Artet ndërthuren me të gjithë kurrikulën. Artistë dhe shkrimtarë të talentuar janë të pranishëm shpesh në orët e mësimit, për të qenë pjesë e eksperimenteve të ndryshëm. Pyetjet sokratike janë qasja kryesore si në kurrikul, ashtu edhe në pedagogjinë që përdoret. Nxënësit inkurajohen të debatojnë për vendime që kanë lidhje me jetën e përditshme në shkollë, si dhe të marrin nisma për organizimin e takimeve. Në kurrikul, shkolla përshkruhet si vend me komunitet vetëqeverisës; fëmijët inkurajohen të kërkojnë vetë-besimin intelektual dhe liri. Tagore shkruan: “Mendja do të fitojë përshtypje... nëse i japim lirinë e plotë të hulumtojë e përjetojë dhe, në të njëjtën kohë, edhe duke e stimuluar të mendojë vetë... Mendja nuk mund të jetë krejtësisht e lirë, thjesht duke lexuar materialet ku jepet dija, as edhe duke përvetësuar idetë e njerëzve të tjerë, por duke formuar standardet e saj të gjykimit dhe duke prodhuar mendime personale...”

Dëshmi të praktikave të tij na tregojnë, në mënyrë të përsëritur, se i përball nxënësit me probleme të ndryshme dhe, nëpërmjet pyetjeve, u kërkon të arsyetojnë e gjejnë përgjigjet – pra, sipas metodës sokratike.

Një tjetër metodë që Tagore përdor për të stimuluar hulumtimin sokratik është vendosja e fëmijëve në role të ndryshme. Fëmijëve u kërkohet të dalin jashtë pikëpamjeve personale dhe të arsyetojnë sipas pikëpamjeve të një personi tjetër. Kjo u jep lirinë të eksperimentojnë nga pozita të tjera intelektuale dhe të kuptojnë çfarë ndodh, nga një

vendndodhje e re. Në këtë fazë, kuptojmë çfarë bën Tagore: vendos lidhjen që mungon ndërmjet hulumtimit sokratik dhe empatisë imagjinuese. Argumentimi sipas mënyrës sokratike kërkon aftësinë për të kuptuar pozicionin e tjetrit duke e vendosur veten në vend të tij, një i kuptuar që shpesh përmban nxitjen për të sfiduar traditën në mënyrë sokratike.

7. *Valbona Nathanaïli*. Fjala e përdorur në gjuhën origjinale nga autori është “lifescape”. “Lifescape” është një koncept që është zhvilluar në fushën e antropologjisë sociale dhe referon marrëdhënien komplekse ndërmjet njeriut, mjedisit dhe sistemeve të prodhimit. Kjo marrëdhënie studiohet në disa dimensione: etike, hapësinore dhe emocionale.

Më shumë: Exploring the Lifescape, autorë Ian Convery, Maggie Mort, Josephine Baxter dhe Cathy Bailey.

Botime të tjera nga “Seria e librit shkencor”

Fondacioni “Henrietta Leavitt”

2020 *Çfarë është jeta* Autor Autor Erwin Schrödinger. Shqip Valbona Nathanaili /Parathënia: Steve Fuller, Valbona Nathanaili ISBN 978-9928-4543-4-8 /Çmimi 1300 lekë; f. 278.

2019 *Komercializimi i shkollimit* Antologji Zgjedhi dhe përgatiti për botim Valbona Nathanaili /Parathënia: Z. Mulaj /ISBN 978-9928-4543-3-1 /Çmimi 1500 lekë; f. 272. *Kontribujtë*: S. Fuller: Rreth komodifikimit dhe progresit të dijes në shoqëri; R. Curren & J. C. Blokhui: Prima Facie Case kundër shkollimit në shtëpi; C. Crouch: Komercializim apo edukim qytetar: rasti i arsimit; S. Fuller: Kapitalizmi dhe dija: Universiteti ndërmjet komodifikimit dhe sipërmarrjes; M. Akyıldız & A. Tekinay: Komercializimi i arsimit të lartë, si pjesë e procesit të globalizimit dhe zbatim i qasjes së orientuar ndaj klientit; G. Anderson & M. I. Cohen: Ripërkufizimi i identitetit të mësuesit dhe të drejtuesit: korniza për studimin e profesionalizmit dhe rezistencës së re të mësuesve; V. Nathanaili: Politika, politika arsimore dhe vlera. Analizë bazuar në literaturë; V. Nathanaili, A. Sinani: Edhe nëse është e thyer, nuk do të thotë se ka nevojë për komercializim. Rasti i Shqipërisë në paralele me Kosovën; V. Nathanaili: Universitetet private dhe publike në Shqipëri - procesi i pranimeve dhe faktorë që marrin studentët në konsideratë në zgjedhjen ndërmjet tyre; V. Nathanaili, M. Hafizi, T. Mulaj, P. Dhoqina: Letër me propozime për politika dhe aksione. Në përfundim të takimeve konsultative me pedagogë, mësues dhe drejtues të profilut fizikë (janar – maj 2019); S. Fuller: Për librin: “Shkenca në pazar. Privatizimi i shkencës amerikane”/ Autorë P. Mirowski; G. Anderson: Për librin: “Menaxhimi i ri publik dhe reforma në arsim. Leksione evropiane për politika dhe praktika”/Përpiluar nga: H. M. Gunter, E. Grimaldi, D. Hall & R. Serpieri.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Nathanaili, Valbona

Edukimi liberal : si qasje dhe praktikë / Valbona Nathanaili,
Martha Nussbaum, Steve Fuller ; parath. Konstantinos
Giakoumis ; red. Andrea Nathanaili. – Elbasan : Fondacioni
“Henrietta Leavitt”, 2021

128 f. ; 148x210 cm.

ISBN 978-9928-4543-6-2

I.Nussbaum, Martha II.Fuller, Steve

1.Edukimi 2.Shoqëria dhe shkolla 3.Arsimi dhe shteti

37 .01 (082)



Valbona Nathanaili
Fondacioni
"Henrietta Leavitt"



Martha Nussbaum
University
of Chicago



Steve Fuller
University
of Warwick

Pas një pushimi gjysmë ore, në orën 14.45, në mbarë shkollën fillon "ora e përrallave". Në "orën e përrallës" të gjithë, pa përjashtim - nxënës, mësues dhe stafi i shërbimit - lexojnë në heshtje diçka! Ora e përrallës është e konsoliduar dhe ka një traditë që shtrihet në kohë. Është mundësia më e mirë për t'u qetësuar! Dhe argëtuar ndryshe! Fëmijë, përgjithësisht, zgjedhin të lexojnë librin e preferuar në vendin e preferuar! Çdo "qoshe" e klasës është në dispozicion të tyre.

PJESË NGA PARATHËNIA
Konstantinos Giakoumis, Kolegji Universitar "Logos"

Edukimi liberal - karakteristika dhe koncepte /Valbona Nathanaili

Kultivimi i imagjinatës: Letërsia dhe artet /Martha Nussbaum

Teatri dhe edukimi /Valbona Nathanaili

Linkoln dhe Darwin. Në një bashkëbisedim, vetëm për një natë /Steve Fuller

Rrëfenjat e disa portokalleve që mund të fluturojnë /Valbona Nathanaili

Shënime /Valbona Nathanaili dhe Martha Nussbaum

Foto e ballinës: Pjesë nga shfaqja "Rrëfenjat e disa portokalleve që mund të fluturojnë", vënë në skenë në Teatrin e Metropolit: Tiranë, qershor 2019.

Seria e librit shkencor

ISBN 978-9928-4543-6-2



9 789928 454362

Çmimi 1200 lekë

